- ❖ Sipas kryerjes së gabimeve nga lodhja rezultatet e studimit ( 47 % e infermierëve kanë bërë shpesh gabime nga lodhja, 39 % kanë bërë pak gabime nga lodhja, 1 % e infermierëve kanë bërë gjithmonë gabime nga lodhja dhe 13 % e infermierëve nuk kanë bërë gabime nga lodhja ) janë më të larta krahasuar me një studim nga Kenyon et al 2007, nga ky studim u gjend se 13 % deklaruan se kishin bërë gabime për shkak të lodhjes, dhe 38 % kishin raportuar praninë e gabimeve të lidhur me lodhjen ( pak gabime nga lodhja ) .

#### Niveli i lodhjes sipas llojit të saj ( Figura 1)




49.55% kanë lodhje Psikologjike, 41.44% kanë lodhje fizike dhe Psikologjike, 9% lodhje fizike. Të lodhur Shpesh janë më tepër ata me lodhje Psikologjike me 30.6% dhe më pas ata që kanë Të dyja llojet e lodhjeve me 20.72%. dhe ata me lodhje Fizike me 5.4 %. Të lodhur Përdite më tepër janë ata me Të dyja llojet me 16.22% dhe më pas ata me lodhje psikologjike 3.6%.Të deklaruar pak të lodhur janë të tre ndarjet me 0.9%

#### Niveli i lodhjes fizike dhe Fluksi i pacientëve ( Figura 2)




102 infermierë janë shprehur se lodhen nga fluksi i pavicenteve, prej tyre: 59% janë shpesh të lodhur  
20% perdite të lodhur,19% rrallë të lodhur, 3% pak të lodhur

#### Niveli i lodhjes Psikologjike dhe Rutina ( Figura 3)




90 të intervistuar kanë deklaruar rutinën si shkak lodhjeje psikologjike.Të lodhur shpesh prej tyre janë 61%,Të lodhur Përdite janë 16%,Të lodhur Rrallë 20% ,Të lodhur pak 3%.

#### Niveli i lodhjes dhe Cilësia e punës ( Figura 4)



49% mendojne se lodhja ndikon pak në cilesinë e punes , 43% ndikon shpesh, 5% ndikon aspak aspak dhe 3% ndikon gjithmonë.

### Niveli i lodhjes dhe Gabimet në punë ( Figura 5 )



47% kanë bërë gabime në punë shpesh, 39% kanë bërë gabime në punë pak, 1% kanë bërë gabime në punë gjithmonë, 13% nuk kanë bërë gabime në punë, pra jo.

- ✓ Të lodhurit shpesh 27% kanë bere shpesh gabime, 20% pak, 9% jo dhe 1% gjithmonë.
- ✓ Të lodhur përditë 15% shpesh gabime dhe 5% pak.gabime.

## Diskutime

- Infermierët raportuan se ndihen të lodhur në punën e tyre.
- Infermierët ndjejnë më shumë lodhje psikologjike, të dyja sesa fizike.
- Infermierët janë pak të informuar në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e lodhjes .
- Lodhja ndikon shpesh dhe pak në cilësinë e punës.
- Gabimet që janë kryer më shpesh nga ndikimi i lodhjes janë:
  - Administrimi i medikamenteve jo ne dozen e duhur,
  - Aplikimi i medikamenteve të papërshekruara nga ana e mjekut në kartelë.

- Marrja e gjakut për kryerjen e analizave në pacientin e gabuar
- Dhënia e medikamenteve jo në kohën e duhur dhe infermierët që i kanë kryer këto gabime kanë qenë shpesh dhe përditë të lodhur.

## Rekomandime

- Ministria e Shëndetësisë, stafi drejtues i spitalit apo dhe bordet menaxhuese të spitalit duhet të ndihmojnë në uljen e ndikimit të lodhjes në punë.
- Realizimi i shërbimeve trajnuese, seminareve nga Ministria e shëndetësisë për infermierët në lidhje me cilësinë e praktikës infermiere, lodhjes në punë si dhe vlerësimit dhe menaxhimit të lodhjes.
- Mbështetja e duhur nga Ministria dhe punëdhënësit për të minimizuar shkaqet dhe pasojat e lodhjes në punën dhe gabimet mjeksore.
- Miratimi dhe funksionimi i protokolleve në spitale për lodhjen në punë.
- Miratimi i pagave adekuatë për infermierët që janë prapçionale me kërkesat e punës dhe punën e kryer.
- Përfshirja e infermierëve në vendimarrje lidhur me punën dhe pacientët e tyre.
- Përmirësimi i kushteve dhe ambjenteve të punës nga Ministria e Shëndetësisë në mënyrë që të ofrohet një praktikë sa më cilësore dhe një punë me sa më pak lodhje.

## Referencat

1. Glaus, 1998; North American Nursing Diagnosis Association, 1996; Stewart, Hays & Ware, 1992.
2. Bertram et al 1990., Leung et al 2004., Van der Linden et al 2003.
3. DeLuca, J (Ed.). (2005). *Fatigue as a window to the brain*. Cambridge: The MIT Press.
4. Krueger, GP. (1989). Sustained work, fatigue, sleep loss and performance: A review of the issues. *Work & Stress*, 3(2), 129-141
5. Van der Linden, D, Frese, M, & Meijman, TF. (2003a). Mental fatigue and the control of cognitive processes: Effects on perseveration and planning. *Acta Psychol (Amst)*, 113(1), 45-65.
6. Leung, AW, Chan, CC, & He, J. (2004). Structural stability and reliability of the swedish occupational fatigue inventory

- among chinese vdt workers. *Appl Ergon*, 35(3), 233-241.
7. Kenyon, T.A., Gluesing, R. E., White, K.Y., Dunkel, W. L., & Burlingame, B. L. (2007). On call: Alert or unsafe? A report of the AORN on-call electronic task force. *AORN Journal*, 86(4), 630-639.
  8. Adriaenssens, J., De Gucht, V., Van Der Doef, M. & Maes, S. (2011). Exploring the burden of emergency care: Predictors of stress health outcomes in emergency nurses. *Journal of Advanced Nursing*, 67(6), 1317-1328
  9. Flin, R., Yule, S., McKenzie, L., Paterson-Brown, S., & Maran, N. (2006). Attitudes to teamwork and safety in the operating theatre. *Surgeon*, 4(3), 145-151.
  10. Kenyon, T.A., Gluesing, R. E., White, K.Y., Dunkel, W. L., & Burlingame, B. L. (2007). On call: Alert or unsafe? A report of the AORN on-call electronic task force. *AORN Journal*, 86(4), 630-639.
  11. Lyndon, A. (2007). Agency for safety in perinatal nursing practice [PhD dissertation]. San Francisco: University of California. (UMI no. 3261236).
  12. Schaffner, M. J. (2006). Antecedents and consequences of work-related nurse fatigue: A preliminary evidence-based model [PhD dissertation]. Charleston, SC: Medical University of South Carolina. (UMI no. 3254253).
  13. Gaffney, T. (2007). Take a nap? *Virginia Nurses Today*, 15(2), 17.
  14. McClelland, L. E. (2007). Examining the effects of fatigue on decision-making in nursing: A policy capturing approach [PhD dissertation]. Clemson, SC: Clemson University. (UMI no. 3290711).
  15. Krueger, G.P. (1994). Fatigue, performance and medical error. In M. S. Bogner (Ed.), *Human error in medicine* (pp. 311-326). Hillsdale: L. Erlbaum Associates.
  16. Glaus, A. (1998). *Fatigue in patients with cancer: Analysis and assessment*. Heidelberg, Germany: Springer-Verlag Berlin.

# Kujdesjet shëndetësore tek pacientët diabetikë të bazuara në evidenca shkencore

**PhD Candidate. Emirjona Kiçaj, PhD Candidate. Rudina Çerçizaj,  
PhD Candidate Sonila Nikaj, PhD Candidate Vasilika Prifti**

emirjona.kicaj@univlora.edu.al, rudina.cercizaj@univlora.edu.al,  
sonila.nikaj@univlora.edu.al, vasilika.prifti@univlora.edu.al,

## Abstrakt

**Hyrje:** Kujdesi shëndetësor ndaj pacientëve diabetikë është një sfidë për sistemin shëndetësor.

**Qëllimi i studimit:** Identifikimi i praktikave më të mira të kujdesjeve shëndetësore ndaj pacientë diabetikë, tipi 2.

**Materiale dhe Metoda:** Ky është një studim reviuw literature. Kemi realizuar një kërkim elektronik për studime të cilat kanë vlerësuar efektivitetin e ndërhyrjeve për përmirësimin e kujdesjeve ndaj pacientëve diabetikë, tipi 2. Ky kërkim u realizua në revistat online PubMed MEDLINE, Scopus, Science Direct,

**Rezultatet:** U përzgjedhën 78 studime nga vende të ndryshme të botës të botuara gjatë periudhës 2017-2022. SHBA kontriboi me numrin më të madh të studimeve. Studimet të cilat kishin në fokus kujdesjet kompresive ndaj pacientëve diabetikë për të parandaluar dhe trajtuar komplikacionet prezente tek pacientët diabetikë përbënin grupin më të madh të studime të përfshira (n=20), edukimi dhe suporti ndaj pacientëve diabetikë (n=18), roli i dietës dhe aktivitetit fizik (13), përdorimi i teknologjisë si një metodë për të përmirësuar menaxhimin e pacientëve diabetikë (n=11), parandalimi i diabetit (n=10) dhe roli i DSMES (edukimi dhe suporti i pacienteve në menaxhimin e diabetit) (n=6). Evidencat sugjeruan se edukimi shëndetësor në drejtim të stilit të jetesës të drejtuar nga profesionistët e shërbimit shëndetësor ishin efektive.

**Konkluzione:** Puna në grup, përdorimi i teknologjisë, përdorimi i protokolleve të kujdesjeve ndihmojnë pacientin diabetikë për të menaxhuar më mirë shëndetin e tij.

**Fjalët kyçe:** Pacientët diabetikë tipi 2, kujdes shëndetësor, menaxhim

## Abstract

**Introduction:** Providing quality health care for people with diabetes continues to be a challenge to the health system.

**The aim of the study:** Identification of best practices followed in terms of care for type 2 diabetic patients.

**Materials and Methods:** We searched for studies that evaluate the effectiveness of any intervention intended to improve diabetic patient's health care. We searched PubMed MEDLINE, Scopus, Science Direct, using Medical Subject Headings terms.

**Results:** A total of 78 studies from different countries were gathered with publication dates through 2017-2022. USA contributed the largest number of studies. Provided compressive patient-centered care to prevent or delay the onset of diabetes complications and to treat diabetes and existing complications was the most common focus of the included studies (n = 20) followed by patient education and support (n = 18), the role of diet and physical activity (n = 13), use of technology as a method to improve health management in the diabetic patient (n = 11), diabetes prevention (n = 10), role of DSMES system on management of diabetes (n = 6). The evidence suggests that lifestyle education led by health professionals were as effective.

**Conclusion:** Group work, use of technology, use of care protocols would help the diabetic patient to better manage his health.

**Key words:** diabetic patients, type 2; health care, management

**Hyrje:** Sipas OBSH, në vitin 2019, Diabetes mellitus është konsideruar si shkaktari kryesor i 1.5 milionë vdekjeve, 48% e të cilave kanë ndodhur tek individët e moshës 70 vjeç [1]. Federata Internacionale e Diabetit (IDF) në vitin 2021, referon se ishin 537 milionë adultë (20-79 vjeç) diabetikë dhe ky numër mendohet se do të arrij në 643 milionë në vitin 2030 dhe në vitin 2045 në 783 milionë individë diabetikë [2]. Përcaktuesit kryesorë të cilësisë së kujdesit për pacientët diabetikë janë: (1) aftësia për të përballuar shërbim shëndetësor; (2) disponueshmëria e shërbimeve shëndetësore; (3) karakteristikat akomoduese të institucioneve shëndetësore; (4) pranimi i gjendjes dhe kujdesit ndaj pacientit; (5) përshtatja e shërbimit [3]. Matja e cilësisë së kujdesit shëndetësor, ndihmon në përmirësimin e performancës së sistemeve të kujdesit shëndetësor duke mundësuar përdorimin më të mirë të burimeve dhe përmirësimin e shëndetit të popullatës [4].

Standardet e kujdesit për pacientin diabetikë, e parandalimit të diabetit apo komplikacioneve që lidhen me të janë: depistimi i popullatës, kujdesi për individë mbipeshë dhe obezë, inkurajimi i vaksinimit dhe vlerësimi i kapaciteteve njohëse të pacientëve, përmirësimi i njohurive të pacientëve për hipogliceminë, si dhe përmirësimi i njohurive të pacientëve dhe personelit shëndetësorë në lidhje me përdorimin e teknologjisë [5], [6].

**Qëllimi i studimit:** Identifikimi i praktikave më të mira të kujdesjeve shëndetësore ndaj pacientë diabetikë, tipi 2.

#### Objektivat specifike

- Të vlerësohen ndërhyrjet e realizuara për përmirësimin e kujdesjeve ndaj pacientëve diabetikë tipi 2.

- Të vlerësohet nëse ka dëshmi shkencore të efikasitetit të këtyre ndërhyrjeve

**Materialet dhe metodat:** Gjatë periudhës Maj – Qershor 2022 është realizuar një kërkim elektronik për studime të publikuara në PubMed, MEDLINE, Scientific researches, national library of medicine, Science Direct.

Ky kërkim u fokusua në identifikimin e studimeve që vlerësonin kujdeset shëndetësore ndaj pacientëve diabetikë, tipi 2. pas u renditën manualisht duke përdorur kriteret përfshirëse dhe përjashtuese.

Fjalët kyçe të kërkimit ishin: “cilësi kujdesi” dhe “pacientë diabetikë tipi 2”.

#### Kriteret përfshirëse:

- Studime analitike (eksperimentale, pothuajse eksperimentale, RTC, Cross-seksionale, retrospektive, vleresuese, kohorte) të cilat kanë vlerësuar ndërhyrjet tek pacientët diabetikë tipi 2 ose kanë përfshirë edukimin e personelit shëndetësor që ofron shërbim ndaj tyre.
- Studime të publikuara gjatë periudhës Janar 2017 – Maj 2022

#### Kriteret përjashtuese

- Studime jo analitike të publikuara përpara vitit 2017
- Studime të cilat nuk kanë përfshirë pacientë diabetikë tipi 2

Si rezultate të matshme në studimet e përfshira ishin: HbA1c, niveli i glicemisë në gjak, indeksi i masës trupore (BMI) /obeziteti, referimi i pacientëve për ekzaminime të ndryshme, kryerja e ekzaminimeve të ndryshme për të kontrolluar pacientët, njohuritë e pacientëve diabetikë, ndryshimet e stilit të jetesës së pacientëve me diabet.




Fig 1. Flow chart i evidencave nga kërkimi origjinal në pranimin final të studimeve

Duke përdorur kriteret përfshirëse dhe përjashtuese, të përmendura më sipër, studimet u rishikuan dhe u filtruan manualisht. Bazuar në këto kritere, në total në këtë studim u përfshinë 78 studime të cilat kanë identifikuar kujdesin për pacientët me diabet të tipit 2. Figura 1 jep një referencë vizuale të metodologjisë së kërimit.

**Rezultatet:** Figura 1 prezanton statet e kërimit. Gjatë kërimit fillestar u identifikuan 231 studime dhe pas një vlerësimi të kujdesshëm, duke marrë në konsideratë kriteret përfshirëse dhe përjashtuese u përzgjedhën 78 studime.

#### ***Përshkrimi i studimeve që u përfshinë në këtë studim review literature***

Numri më i madh i studime të përfshira në këtë analizë janë realizuar në SHBA (14 studime) dhe vetëm 2 studime janë realizuar në popullatën shqiptare. Në grafikun 1 paraqiten grupet e studimeve të analizuar ku numri më i madh i studimeve ishte i fokusuar në drejtim të kujdesjeve kompresivendaj pacientëve diabetikë, tipi 2, për të parandaluar apo trajtuar komplikacionet me 20 studime.

Natyra e ndërhyrjeve dhe metodologjia e studimeve ishte e ndryshme: Numri më i madh i studimeve ishin studim RTC (Randomised control trials) konkretisht 32 studime, 10 ishin studime kros-seksionale, 14 studime ishin studime kohort & longitudinal & prospektiv, 5 studime ishin studime retrospektive, 5 studime pre dhe post test, nga 4 studime ishin përkatësisht studimet eksperimentale, studimet ndërhyrëse, studimet pothuajse eksperimentale dhe një studim ishte studim analitik sekondar.

Popullata totale e përfshirë në këto studime ishte 91304, nga të cilët vetëm 102 pjesmarës ishin personel shëndetësor, pjesa tjetër ishin pacientë diabetikë tipi 2 ose pacient në rrezik për shfaqjen e diabetit tipi 1 dytë. Numrin më të madh të pjesmarësve në studim e përbënin studimet të cilat kanë vlerësuar kujdesjet kompresivendaj pacientëve diabetikë për të parandaluar dhe trajtuar komplikacionet, 71926 pjesmarës.


#### ***Menaxhimi i diabetit: Edukimi dhe suporti i pacientëve diabetikë, tipi 2 (Tabela 1)***

Si mund të shihet dhe në Grafikun 1, u identifikuan 18 studime të cilat kanë vlerësuar edukimin shëndetësor në përmirësimin e kujdesjeve ndaj pacientëve diabetikë, tipi 2. Popullata e përfshirë në këto studime varioonte nga 14 pjesmarës [7] në 827 pacientë diabetikë [8]. 2 nga studimet eksperimentale janë realizuar në Kinë dhe një prej tyre në Shqipëri. Këto studime evidentuan efektivitetin e edukimit shëndetësor në përmirësimin e

pacientëve të hospitalizuar [9], efektivitetin e edukimit individual të realizuar nga personeli infermieror në përmirësimin e përshtatjes psikologjike [10] dhe efektivitetin e edukimit shëndetësor në uljen e nivelit të stresit [11].

10 studime janë realizuar me pjesmarjen e pacientëve në shërbimin parësor. Vetëm një studim ishte fokusuar në edukimin e personelit shëndetësor dhe ndikimin e këtij edukimi në cilësinë e kujdesjeve shëndetësore. Ky studim evidentoi rëndësinë e përfshirjes së personelit shëndetësor në realizimin e programeve edukuese [12].

**Grafiku 1.** Paraqitja grafike e studimeve të përfshira në kategorive të ndërhyrjeve. .



Të gjitha studimet evidentuan rëndësinë dhe efektivitetin e edukimit shëndetësor në përmirësimin e shëndetit të pacientëve diabetikë. 3 studime [7], [12], [13] kanë identifikuar rolin e përfshirjes në programet edukuese, ushtrimet specifike, edhe pse ndryshimet e observuara nuk ishin sinjifikante. 5 studime të tjera kanë studjuar rolin e personelit infermieror dhe kanë konkluduar se infermierët duhet të përfshihen në edukimin e pacientëve diabetikë për të përmirësuar menaxhimin e situatave shëndetësore [8], [9], [10], [13], [14].

Janë programe të ndryshme që mund të përdoren me qëllim rritjen e angazhimit të pacientëve diabetikë në vet-menaxhim dhe efektiviteti i përdorimit të këtyre programeve presantohet në 5 studime: edukim infermieror individual dhe edukim shëndetësor (INHE - Individualized nursing education and health

education) [10], Programi DCEP (Plus kujdesit të zakonshëm - plus usual care) [13], programi i tranzicionit të kujdesjeve spitalore (DiaTOHC - Diabetes Transition of Hospital Care program) [15], Programi i edukimit të vet-menaxhimit dhe suportit (DSMES - Diabetes self-management education and support) [16], [17].

Tabela 1. Menaxhimi i diabetit: *Edukimi dhe suportit i pacientëve diabetikë*

| Citimi i studimit                           | Qëllimi i studimit                                                                                                                    | Lloji i studimit           | Popullata                                 | Konkluzionet                                                                                                               |
|---------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------|-------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Li R, et al 2022<br><i>Kinë</i>             | Vlerësimi i impaktit të edukimit individual infermieror tek diabetikët me HTA                                                         | Studim Eksperimental       | GN – 34<br>GK - 34                        | Përmirësim psikologjik<br>Përmirësim i statusit të shëndetësor                                                             |
| Hale L. Et al 2022<br><i>Zelanda e Re</i>   | Vlerësimi i efektivitetit i programit DCEP në mbajtjen nën kontroll të glicemisë                                                      | RTC                        | GN – 83<br>GK - 82                        | Ushtrimet fizike janë efektive tek pacientët diabetikë me nivele të larta të HbA1c                                         |
| Milan K. Piya et al 2022<br><i>Australi</i> | Krahasimi i edukimit shëndetësor face to face, online dhe kujdesin standart                                                           | RTC                        | GN 1 – 364<br>GN 2 – 203<br>GK – 260      | Edukimi online siguroi një menaxhim më të mirë të niveleve të hypoglicemisë                                                |
| Akiboye F 2020<br><i>Angli</i>              | Vlerësimi i programit DICE në uljen e spitalizimit të pacientëve.                                                                     | Studim ndërhyrës           | Jo e qarte                                | Ky program uli ditëqëndrimet e pacientëve në spital                                                                        |
| Rubin DJ 2022<br><i>SHBA</i>                | Vlerësimi i efikasitetit të programit Dia TOHC                                                                                        | RTC                        | GN – 45<br>GK – 46                        | Ky program ul rrezikun e rihospitalizimeve për 30 ditë. Ul kostot financiare                                               |
| C. E. Mambang et al 2022<br><i>Indonesi</i> | Vlerësimi i programit IDCP në përmirësimin e vetmenaxhimit                                                                            | Pothuaj eksperimental      | GN – 30<br>GK - Jo                        | Përmirësim në vet-efikasitetin dhe sjelljet vet-menaxhuese të pacientëve diabetikë                                         |
| Jianhua Eang J. et al , 2022<br><i>Kinë</i> | Vlerësimi i edukimit shëndetësor nga infermierët                                                                                      | Studim eksperimental       | GN – 45<br>GK - 45                        | Edukimi shëndetësor ishte efektiv dhe ndihmoi në përmirësimin e shëndetit të pacientëve diabetikë                          |
| Madrigal et al 2021<br><i>SHBA</i>          | Përfshirja në kujdesin shëndetësor parësor e ushtrimeve të strukturuar                                                                | Studim pre dhe post test   | GN – 31<br>GN – 5<br>personel shëndetësor | Përmirësim i statusit shëndetësor                                                                                          |
| Yuniartika 2021<br><i>Indonesi</i>          | Vlerësimi i rritjes së njohurive të nga përdorimi i fletëpalosjeve                                                                    | Pothuaj eksperimental      | GN- 92<br>Gk - jo                         | Përmirësimi i sjelljeve sjell përmirësim të parametrave laboratorik.                                                       |
| Areevut, C., 2021<br><i>Bankok</i>          | Vlerësimi i përdorimit të programit DSMES                                                                                             | Studim Kohort Retrospektiv | GN – 92<br>GK - Jo                        | Ndjekja e këtij programi përmirëson parametrat laboratorik të pacientëve                                                   |
| Plessis, R 2022<br><i>Afrika e Jugut</i>    | Vlerësimi i efektivitetit të përdorimit të protokolleve të ushtrimeve në pacientët me neuropati periferike                            | Studim pre dhe post test   | Në total 28<br>GN - ?<br>GK - ?           | Ndryshimet e observuara nuk ishin sinjifikante megjithatë u vunë re pas javësh                                             |
| Trento M 2020<br><i>Itali</i>               | Vlerësimi i edukimit shëndetësor në drejtim të vetmenaxhimit                                                                          | RTC                        | GN- 25<br>GK- 25                          | Përqasja multidimensionale në edukim përmirëson presionin arterial si dhe cilësinë e jetës.                                |
| Eichit et al 2017<br><i>Tailandë</i>        | Vlerësimi i impaktit të ndërhyrjeve familjare në përmirësimin e teknikave vet-menaxhuese, kontrollin e glicemisë dhe cilësinë e jetës | RTC                        | GK – 70<br>GN – 70                        | Programet të cilat përfshijnë dhe familjen përmirësojnë vet-efikasitetin dhe vet-menaxhimin duke ulur dhe nivelin e HbA1c. |
| Martos-Cabrera et al 2021<br><i>Spanjë</i>  | Krahasimi i edukimit me kohëzgjatje 360 minuta me atë 90 minuta në përmirësimin e nivelit të HbA1c                                    | Pothuajse eksperimental    | GN – 78<br>GK - 171                       | Edukimi shëndetësor intesiv përmirëson nivelin e HbA1c tek pacientët diabetikë                                             |
| Khunti K, et al 2021<br><i>Angli</i>        | Vlerësimi i impaktit të programeve edukuese vet-menaxhuese në nivelin e aktivitetit fizik                                             | RTC                        | GN – 180<br>GK - 173                      | U vu re një ulje e lehtë e aktivitetit fizik tek pacientët me sëmundje bashkëshoqëruese                                    |
| Alida Rama et                               | Vlerësimi i ndikimit të                                                                                                               | RTC                        | GN – 200                                  | Edukimi shëndetësor përmirëson                                                                                             |

|                                               |                                                                                                                               |                      |                                  |                                                                                                                                     |
|-----------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|----------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| al 2029<br><i>Shqipëri</i>                    | edukimit në stilin e jetesës                                                                                                  |                      | GK – 200                         | kontrollin e diabetit.                                                                                                              |
| Alida Rama et al 2021<br><i>Shqipëri</i>      | Vlerësimi i impaktit të programeve edukuese në nivelin distresit emocional                                                    | Studim eksperimental | GN – 200<br>GK – 200             | Edukimi shëndetësor përmirëson distresin emocional, kontrollin e glicemisë dhe cilësinë e jetës të pacientëve.                      |
| Dora Ines Parra et al 2021<br><i>Kolumbia</i> | Vlerësimi i efikasitetit të ndërhyrjeve infermiore individuale në krahasim me kujdeset rutinë në aderencën ndaj medikamenteve | RTC                  | Në total 200<br>GN - ?<br>GK - ? | Ndërhyrjet edukuese individuale ishin efektive në përmirësimin e aderencës ndaj medikamenteve dhe përmirësimin e presionit arterial |

Shënim: GN- Grupi i ndërhyrjeve; GK – Grupi i kontrollit; HTA – hipertension; Programi DCEP (plus usual care-plus kujdesit të zakonshëm); Dia TOHC – Diabetes transition of Hospital Care – Tranzicioni i kujdesit spitalor; IDCP (Integrated Diabetic Care Programs – Program i integruar i kujdesit ndaj diabetikëve); DSMES (Diabetes Self management education and support – Edukimi në drejtim të vetmenaxhimit dhe suporti)

**Menaxhimi i diabetit: Aderenca ndaj dietës dhe angazhimi në aktivitete fizike si një komponent i rëndësishëm në përmirësimin e shëndetit të pacientëve diabetikë (Tabela 2)**

Në tabelën 2 paraqiten 13 studime të publikuara gjatë periudhës 2017-2022, të cilat kanë evidentuar impaktin e dietave të strukturuar (7 studime) dhe aktivitetit fizik (6 studime) në menaxhimin e diabetit. Popullata e përfshirë nën studim varioje nga 24 pjesmarës [18] në 2448 pacientë diabetikë [19]. Të gjitha studimet kanë raportuar përmirësime konkrete tek pacientët diabetikë.

Studimet e fokusuar në rolin e aktivitetit fizik kanë evidentuar efektivitetin e disa ushtrimeve specifike si: ushtrimet e strukturuar [12]; ushtrimet e rezistencës [20]; ushtrimet aerobike [21]; ecja e shëndetshme [22] në ruajtjen e qarkullimit në artikulacione. Rossen et al ka identifikuar modele të aktivitetit fizik tek

individët me prediabet ose diabet të tipit 2 [23]. Vetëm 1 studim në Spanjë përfshinte si ushtrimet e strukturuar ashtu edhe përdorimin e një smartphoni, dhe kombinimi i të dyjave nga personeli infermior në kujdesin parësor, do të sillte një përmirësim të ndjeshëm në parametrat e pacientëve me diabet [22].

Një rol të rëndësishëm në përmirësimin e vetë-menaxhimit të pacientëve diabetikë ka zbatimi korrekt i dietave të shëndetshme. Në tabelën 2 presantohen 7 studime të cilat janë fokusuar në modifikimin e dietës tek pacientët diabetikë duke rritur përdorimin e fibrave [18], [24]; dietat me pak yndyrna [19], [24], [25]; dietat ketogjenike me karbohidrate [26]; përdorimi i bishtajoreve [25], [27]; dhe dietat me pak kalori [19]. Këto studime treguan se ndjekja e dietave me bazë bimore ndihmon në mbajtjen nën kontroll të nivelit të glicemisë.

Tabela 2. Menaxhimi i diabetit: Aderenca ndaj dietës dhe angazhimi në aktivitete fizike si një komponent i rëndësishëm në përmirësimin e shëndetit të pacientëve diabetikë

| Citimi i studimit                               | Qëllimi i studimit                                                                                                     | Lloji i studimit         | Popullata                                 | Konkluzionet                                                                                                                                    |
|-------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------|-------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Aktiviteti fizik - ushtrimet</b>             |                                                                                                                        |                          |                                           |                                                                                                                                                 |
| Madrigal et al 2021 <i>SHBA</i>                 | Përfshirja në kujdesin shëndetësor parësor e ushtrimeve të strukturuar                                                 | Studim pre dhe post test | GN – 31<br>GN – 5<br>personel shëndetësor | Përmirësim i statusit shëndetësor                                                                                                               |
| Liu Y, 2019<br><i>Kinë</i>                      | Impakti i përdorimit të ushtrimeve rezistencës në nivelin e HbA1c, përdorimin e insulinës                              | RTC                      | GN – 491<br>GK - 471                      | Ushtrimet e rezistencës kanë ndikim në uljen e HbA1c dhe në përdorimin e insulinës                                                              |
| Ranasinghe C 2020<br><i>Sri Lanka</i>           | Vlerësimi i efikasitetit të ushtrimeve aerobike, të rezistencës dhe kujdesi standart                                   | RTC                      | GN1 – 28<br>GN2 – 28<br>GK - 30           | Përdorimi i ushtrimeve të rezistencës rezultuan me përmirësim të kontrollit të glicemisë.                                                       |
| Rossen J et al 2022<br><i>Suedi</i>             | Identifikimi i profilit të aktivitetit fizik tek individët me pre-diabet dhe diabet dhe vlerësimi i pjesmarjes së tyre | Kohort&RTC               | Në total 168                              | Pjesa më e madhe e pjesmarësve ruajtën aktivitetin fizik gjatë periudhës 2 vjeçare.                                                             |
| Alonso-Domínguez R, et al 2019<br><i>Spanjë</i> | Lidhja midis ecjes së shëndetshme dhe efekteve akute në qarkullimin arterial në art.                                   | RTC                      | Në total 89                               | Ushtrimet aerobike të moderuara si ecja, ka një efekt të menjëhershëm në indeksin e qarkullimit të gjakut në artikulacione sidomos tek meshkujt |

|                                              |                                                                                                                                                                                                               |                          |                      |                                                                                                                                                                                                       |
|----------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------|----------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Alonso-Domínguez R, et al 2019 <i>Spanjë</i> | Vlerësimi i efekteve afatshkurtra dhe afatgjata të aktivitetit fizik në parametrat biokimikë                                                                                                                  | RTC                      | GN - 94<br>GK - 91   | Përmirësim të stilit të jetesës<br>Përdorimi i smartphonave ndihmuan në vazhdimësinë e aktivitetit fizik.                                                                                             |
| <b>Dieta</b>                                 |                                                                                                                                                                                                               |                          |                      |                                                                                                                                                                                                       |
| Ramal E, 2018 <i>SHBA</i>                    | Përcaktimi i impaktit të përdorimit të dietave me përmbajtje të lartë të fibrave apo të ulët                                                                                                                  | RTC                      | GN - 17<br>GK - 15   | Pacientët e grupit eksperimental demonstuan përmirësim sinjifikant të niveleve të HbA1c.                                                                                                              |
| Saslow LR et al 2017 <i>SHBA</i>             | Cilat nga dietat: dietat ketogjenike apo dietat e bazuara në "Krijo pjatën tënde" përmirëson kontrollin e glicemisë                                                                                           | RTC                      | GN - 12<br>GK - 13   | Rekomandimet e programit për të ndjekur një dietë ketogjenike me shumë pak karbohidrate dhe ndryshimet në stilin e jetës sjellin rezultate tek individët mbipeshë.                                    |
| Devlin BL et al 2021 <i>Australi</i>         | Ndikimi i përgatitjes dhe konsumit të patates si pjesë e një vakti në mbrëmje në nivelin e glicemisë.                                                                                                         | RTC                      | Ne total 24          | Vaktet me bazë patate të ziera, të pjekura ose të ziera u shoqëruan me përgjigje të favorshme të glukozës.                                                                                            |
| Manios Y et al 2017 <i>Greqi</i>             | Krahasimi i efekteve të tre vakteve të përziera të gatshme për t'u ngrënë, me përmbajtje të lartë fibrash dhe indeks të ulët glicemik, në përgjigjen glicemike dhe të insulinës                               | Studim prospektiv        | Ne total 24          | Tre vaktet e përziera të gatshme nxitën uljen e glicemisë në krahasim me ngarkesën e glukozës nga goja në pacientët me diabet.                                                                        |
| Hosseinpour-Niazi, S. 2022 <i>Iran</i>       | Vlerësimi i efekteve të bishtajoreve në qasjet dietike për të ndaluar hipertensionin                                                                                                                          | RTC                      | GN - 150<br>GK - 150 | Dieta "DASH", e pasuruar me bishtajore, mund të përmirësojë presionin arterial.                                                                                                                       |
| Tayyem R et al 2022 <i>Qatar</i>             | Nxjerja në pah e lidhjes së mundshme midis ndjekjes së llojeve të ndryshme të dietës (dietë me pak yndyrë, dietë me kalori të ulët, dietë me pak kripë dhe më shumë se një dietë) dhe kontrollit të glicemisë | Studim analitik sekondar | Në total 2448        | Dieta dhe mënyra e jetesës janë faktorë jetik që mund të ndikojnë në nivelet e HbA1C.                                                                                                                 |
| Kahleova H et al 2019 <i>SHBA</i>            | Vlerësimi i rolit të sasisë së yndyrës në dietë dhe përbërjes së acideve yndyrore në përbërjen e trupit, rezistencën ndaj insulinës dhe sekretimin e insulinës                                                | RTC                      | GN - 38<br>GK - 37   | Një diete vegane me pak yndyrë, marrja e reduktuar e yndyrave të ngopura dhe rritja e përmbajtjes të ac. yndyrore të pangopura, u shoqëruan me ulje të masës yndyrore dhe rezistencës ndaj insulinës. |

Shënim: GN- Grupi i ndërhyrjeve; GK – Grupi i kontrollit;

### Menaxhimi i diabetit: Roli i sistemit DSEMS (Diabetes self management education and support - Edukimi në vetmenaxhimin e pacientëve diabetikë dhe suporti i tyre) në menaxhimin e diabetit (Tabela 3)

Në analizën e studimit tonë u përfshinë 6 studime për të paraqitur efektivitetin e ndryshimit, të rolit të profesionistëve të kujdesit shëndetësor për të përmirësuar kujdesin ndaj pacientëve diabetikë. Popullata e përfshirë në këtë grup studimesh varionte nga 105 pjesmarës [28] në 385 pjesmarës [29]. Evidencat kanë treguar se pjesmarja e pacientëve në sesionet edukuese ul ndjeshëm nivelin e HbA1c [28]. Përcaktimi i faktorëve që ndikojnë në pjesmarjen e pacientëve dhe familjarëve të tyre në programet edukuese janë komponentë të rëndësishëm që ndikojnë në

përmirësimin e mëtejshëm të kujdesjeve shëndetësore [30].

3 studime prezantojnë rolin e farmacistit në edukimin dhe suportin e pacientit diabetikë [31], [32], [33]. Këto studime evidentuan një rënie sinjifikante të HbA1c, ulje të niveleve të kolesterolit si dhe ulje të përdorimit të shërbimit shëndetësor, tek ata pacientë ku farmacistët kishin realizuar ndërhyrje edukuese në bashkëpunim me personelin shëndetësor të shërbimit parësor.

Infermieri është një anëtar i rëndësishëm i ekipit që duhet të realizoj edukimin dhe mbështetjen e pacientëve diabetikë. Efekti i ndërhyrjeve të udhëhequra nga infermieret rezulton me përmirësime të sinjifikante e të qëndrueshme në rezultatet klinike, stilin e jetës dhe ato psikosociale tek pacientët diabetikë [29].

Një studim tjetër i realizuar në Iran, konfirmoi nevojën e mbështetjes psikologjike të

pacientëve diabetikë me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës [34].

Tabela 3. Menaxhimi i diabetit: *Roli i sistemit DSEMES (Diabetes self management education and support – Edukimi në vetmenaxhimin e pacienteve diabetikë dhe suporti i tyre) në menaxhimin e diabetit*

| Citimi i studimit                         | Qëllimi i studimit                                                                                                                                                                                     | Lloji i studimit              | Popullata          | Konkluzionet                                                                                                                                                          |
|-------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|--------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Alsayed Hassan, D et al 2020 <i>Qatar</i> | Përcaktimi i shkallës në të cilën ofruesit e kujdesit parësor po ndjekin udhëzimet e referimit dhe nëse numri i orëve të DSMES të kryera nga pacientët lidhet me kontrollin më të mirë të glicemisë.   | Studim retrospektiv           | Në total 105       | Numri i pacientëve me diabet tip 2 të referuar në programin DSMES është i vogël. Rënie në nivelet e HbA1c patën dhe pacientët që kishin ndjekur një seancë edukative. |
| Abdulrhim S, 2022 <i>Qatar</i>            | Vlerësimi i ndikimit të kujdesit bashkëveprues me farmacistin kujdesin ndaj pacientit diabetik                                                                                                         | Studim kohort retrospektiv    | Jo e qartë         | Përfshirja e farmacistit në kujdeset shëndetësore parësore përmirësoi statusin shëndetësor.                                                                           |
| Korcegez EL, 2017 <i>Qipro</i>            | Vlerësimi i efektit të një programi kujdesi të udhëhequr nga farmacisti në kontrollin e glicemisë, presionin e gjakut, profilin e lipideve, indeksin e masës trupore, dhe aktivitetet e vetë-kujdesit. | RTC                           | GN – 75<br>GK - 77 | Përfshirja e farmacistëve në programet edukuese u shoqërua me përmirësime të rëndësishme në uljen e HbA1c dhe rezultate të tjera dytësore.                            |
| Norton M C, 2020 <i>SHBA</i>              | Vlerësimi i ndikimit të bashkëpunimit mjek-farmacist në menaxhimin e diabetit në kujdesin parësor duke e krahasuar rezultatet midis kujdesit të menaxhuar nga mjeku                                    | Studim retrospektiv observues | Në total 385       | Bashkëpunimi i farmacistëve me mjekët e kujdesit parësor ka sjellë ulje të nivelit të HbA1c, kolesterolit dhe ka ulur përdorimin e kujdesit shëndetësor.              |
| Azami G, 2018 <i>Malajzi</i>              | Vlerësimi i efektivitetit të edukimit të udhëhequr nga infermierët                                                                                                                                     | RTC                           | GN – 71<br>GK - 71 | Përmirësim në nivelin e HbA1c, presionit të gjakut, peshën trupore, sjelljet vetë-menaxhuese.                                                                         |
| Saeideh Bazzazian 2017 <i>Iran</i>        | Vlerësimi i parashikuesve biopsikosocialë (HbA1c, vetë-efikasiteti dhe mbështetja sociale) të vetë-menaxhimit dhe cilësisë së jetës në lidhje me shëndetin e pacientëve.                               | Studim cros-seksional         | Ne total 160       | Rezultatet konfirmuan modelin teorik dhe provat shkencore për ofrimin e zgjidhjeve psikologjike për promovimin e cilësisë së jetës në pacientët me Diabet të tipit 2. |

Shënim: GN- Grupi i ndërhyrjeve; GK – Grupi i kontrollit;

### **Menaxhimi i diabetit: Kujdesjet kompresive për parandalimin e komplikacioneve apo trajtimin e tyre (Tabela 4)**

Në këtë pjesë të studimit janë analizuar 20 studime, nga të cilat 9 studime kanë vlerësuar rëndësinë e identifikimit të hershëm dhe edukimin e pacientëve në drejtim të këmbës diabetike, 7 studime kanë fokusuar në drejtim të kujdesit ndaj syve dhe 4 të tjera për neuropatitë. Numri i pacientëve të përfshirë varionte nga 44 pacientë [35] në 10688 pacientë diabetikë tipi 2 [36].

Në kujdesin ndaj këmbës diabetike rol të rëndësishëm mer identifikimi i hershëm i faktorëve riskantë [36], [37], përdorimi i programeve edukuese për këta pacientë si NCës` foot care programe"& "3STEPFUN" [38], [39], [40] dhe ofrimi i kujdesjeve shëndetësore nga personel infermior i trajnuar [39].

Edukimi individual në rastet me risk të madh për këmbën diabetike ndihmon në përmirësimin e njohurive dhe vetkujdesjet e pacientëve diabetikë [41].

3 studime kanë prezantuar rëndësinë e aplikimit të programeve në drejtim të kujdesit të syve tek pacientët diabetikë duke përmirësuar sjelljet shëndetësore të pacientëve [42], rritur njohuritë e pacientëve në drejtim të shëndetit të syve dhe kontrollit të herëpashershëm të tyre [43], [44]. Diagnostikimi i vonë i retinopative diabetike shihet si një faktor sinjifikant riskant për verbërinë e pacientëve diabetikë[45]. Por vihet re se vetëm një numër i vogël pacientësh referohet për kontrole tek mjeku okulist [46]. Ofrimi i ndërhyrjeve edukuese dhe mbështetëse në shërbimin ambulator mund të ndihmojë dhe në uljen e simptomave dhe ashpërsinë e neuropatisë periferike diabetike [47]. Rritja e

niveleve të HbA1c dhe prezenca e eventeve makro-vaskulare lidhet me rritjen e incidencës së neuropatisë diabetike [48], [49].

Tabela 4. Menaxhimi i diabetit: *Kujdesjet kompresive për parandalimin e komplikacioneve apo trajtimin e tyre.*

| Citimi i studimit                           | Qëllimi i studimit                                                                                                                                                                                 | Lloji i studimit                 | Popullata e përfshirë                     | Konkluzionet                                                                                                                                                                                                                                              |
|---------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------|-------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b><i>Kujdesi ndaj këmbës diabetike</i></b> |                                                                                                                                                                                                    |                                  |                                           |                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Rossboth S, 2021<br><i>Austri</i>           | Identifikimi i faktorëve të riskut për identifikimin e hershëm të pacientëve me risk të lartë                                                                                                      | Studim retrospektiv              | Në total 10688                            | Gjinia (pacientët meshkuj) dhe prania e sëmundjeve shoqëruese u identifikuan si faktorë rreziku në studim.                                                                                                                                                |
| Rossboth S, 2021<br><i>Austri</i>           | Identifikimi i faktorëve të rrezikut që lidhen me ndërlikimet e këmbës diabetike në grupe pacientësh.                                                                                              | Studim kohort retrospektiv       | Në total 3002                             | Faktorët e rrezikut të modifikueshëm (HTA, nivelet e larta të glukozës në gjak) mund të trajtohen për të reduktuar rrezikun për ndërlikimet e këmbës diabetike                                                                                            |
| Scain SF, 2018<br><i>Brazil</i>             | Cilat janë ndryshimet në këmbën e pacientëve diabetikë në varësi të të dhënave demografike, klinike dhe biokimike                                                                                  | Studim longitudinal retrospektiv | Në total 918                              | Konsultimi me infermierët ul rrezikun e vdekjes tek këta pacientë.                                                                                                                                                                                        |
| Fujii K., 2020<br><i>Japoni</i>             | Vlerësimi i programeve edukative të kujdesit për këmbët                                                                                                                                            | Studim jo-RTC                    | Në total 87 infermierë                    | Përmirësimi i praktikave të kujdesjeve                                                                                                                                                                                                                    |
| Fujii K, 2021<br><i>Japoni</i>              | Vlerësimi i efektit të programit NCE gjatë kujdesit                                                                                                                                                | Studim pre dhe post test         | Në total 23                               | Programi ishte efektiv në ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të këmbës tek pacientët në moshë të madhe.                                                                                                                                                |
| Nguyen TPL, 2019<br><i>Australi</i>         | Vlerësimi i efektit të programit 3-STEPFUND                                                                                                                                                        | Studim pre dhe post test         | GN – 59<br>GK - 60                        | Programi përmirësoi sjelljet vetkujdesëse duke parandaluar problemet minore.                                                                                                                                                                              |
| Moradi A, et al 2019<br><i>Iran</i>         | Vlerësimi i efektivitetit të një ndërhyrjeje edukative nëpërmjet celularit mbi njohuritë e kujdesit për këmbët dhe praktikën e kujdesit për këmbët.                                                | Studim pothuajse eksperimental   | GN – 80<br>GK - 80                        | Këto ndërhyrjet edukative përmirësuan njohuritë dhe praktikën e kujdesit për këmbët dhe kontrollin metabolik.                                                                                                                                             |
| Fu, X. J., 2021<br><i>Kinë</i>              | Vlerësimi i efektivitetit të edukimit një për një tek pacientët me rrezik të lartë të këmbës diabetike                                                                                             | Studim ndërhyrës                 | GN – 49<br>GK - 49                        | Edukimi "një për një" tek pacientët me rrezik të lartë për këmbën diabetike përmirëson aftësitë njohëse dhe vetë-kujdesjet tek këta pacientë.                                                                                                             |
| Liu J, 2020<br><i>Kinë</i>                  | Vlerësimi i njohurive dhe sjelljeve kujdesëse për këmbën diabetike për të përcaktuar efektin dhe sfidat aktuale të edukimit për kujdesin ndaj këmbëve.                                             | Studim kros-seksional            | Në total 200                              | Njohuritë dhe sjelljet kujdesëse ndaj këmbës diabetike të pacientëve ishin të ulëta.                                                                                                                                                                      |
| <b><i>Kujdesi ndaj syve</i></b>             |                                                                                                                                                                                                    |                                  |                                           |                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Ahmed TM, 2021<br><i>Etiopi</i>             | Përcaktimi i përdorimit të shërbimeve të kujdesit ndaj syve dhe përcaktimi i faktorëve që ndikojnë                                                                                                 | Studim kros-seksional            | Në total 531                              | Përdorimi i shërbimit të kujdesit okular ishte e ulët.                                                                                                                                                                                                    |
| Srinivasan NK, 2021<br><i>Indi</i>          | Dokumentimi i njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të pacientëve diabetikë në lidhje me diabetin dhe retinopatinë diabetike, për të identifikuar barrierat e ndjekjes dhe trajtimit                | Studim kros-seksional            | Në total 288                              | Njohuritë rreth retinopatisë diabetike ishin të ulëta. Pengesa kryesore për mos vlerësimeve ishte mungesa e orientimit për të kryer kontrollin e syve.                                                                                                    |
| Valpuesta Martin Y, 2020<br><i>Spanjë</i>   | - Përcaktimi i prevalencës e retinopatisë diabetike<br>- Vlerësimi i shkallës së kënaqësisë së pacientëve diabetikë dhe të profesionistët me programin e depistimit të bazuar në teleoftalmologji. | Studim kros-seksional            | Në total 114 paciente<br>10 profesionistë | Teleoftalmologjia rrit aksesin e pacientit në sistemin e kujdesit shëndetësor, duke e bërë më të lehtë diagnostikimin e hershëm të retinopatisë diabetike, me një shkallë të lartë kënaqësie midis pacientëve dhe profesionistëve të kujdesit shëndetësor |
| Ëykoff CC, 2021<br><i>SHBA</i>              | Vlerësimi i lidhjes midis ashpërsisë së retinopatisë fillestare diabetike / rrezikut të verbërisë në pacientët.                                                                                    | Studim kohort retrospektiv       | Në total 53535                            | Diagnoza e vonë e retinopatisë diabetike ishte një faktor rreziku i rëndësishëm për zhvillimin e verbërisë së qëndrueshme.                                                                                                                                |
| Hosseini SS,                                | Vlerësimi i efektit të programit                                                                                                                                                                   | RTC                              | GN – 47                                   | Zbatimi i modelit të Teorisë së Sjelljes                                                                                                                                                                                                                  |

|                                     |                                                                                                                                                                                              |                       |                      |                                                                                                                                                                                                         |
|-------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|----------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 2021<br><i>Iran</i>                 | edukativ të bazuar në Teorinë e Sjelljes së Planifikuar në promovimin e sjelljeve parandaluese të retinopatisë në pacientët me diabet të tipit 2.                                            |                       | GK – 47              | së Planifikuar ishte shumë efektiv në zhvillimin e një programi edukativ për pacientët me diabet, për të kontrolluar nivelin e glicemisë për të përmirësuar sjelljet parandaluese të retinopatisë.      |
| Lake AJ, 2020<br><i>Australi</i>    | Vlerësimi i efektit të ndërhyrjeve të shkurtra të përshtatura, të bazuar në prova për ndryshimin e sjelljes shëndetësore (fletëpalosje).                                                     | RTC                   | Në total 129         | Fletëpalosjet promovuese dhe depistimi të retinës mund të rrisë njohuritë për retinopatinë diabetike.                                                                                                   |
| Khair Z, M<br>2020<br><i>Japoni</i> | Vlerësimi i efikasitetit të edukimit shëndetësor 5-mujor.                                                                                                                                    | RTC                   | GN – 143<br>GK – 156 | Edukimi intensiv shëndetësor mbi retinopatinë diabetike duhet të integrohet me edukimin për diabetin pasi rezulton me përmirësim të pajtueshmërisë së referimit.                                        |
| <b>Neuropatitë</b>                  |                                                                                                                                                                                              |                       |                      |                                                                                                                                                                                                         |
| Ahrary Z, 2020<br><i>Iran</i>       | Përcaktimi i efektit të ndërhyrjeve edukative mbështetëse bazuar në modelin e vetë-kujdesit Orem tek gratë me diabet tip 2 dhe neuropati periferike diabetike                                | RTC                   | GN – 60<br>GK – 60   | Ofrimi i ndërhyrjeve mbështetëse edukative bazuar në modelin e vetë-kujdesit ul simptomat dhe ashpërsinë e neuropatisë periferike diabetike.                                                            |
| Cicek SC, 2021<br><i>Turqi</i>      | Përcaktimi i efektit të refleksologjisë së këmbës në indeksin brachial të kyticit të këmbës, neuropatinë periferike diabetike dhe kontrollin e glicemisë.                                    | RTC                   | GN – 24<br>GK – 24   | Një praktikë e refleksologjisë e këmbëve mund të jetë e dobishme për përmirësimin e kontrollit të glicemisë dhe neuropatisë periferike diabetike tek të rriturit e moshuar me diabet.                   |
| Su JB, 2018<br><i>Kinë</i>          | Hetimi i lidhjes së ndryshueshmërisë së HbA1c me neuropatinë periferike diabetike në pacientët me diabet të tipit 2.                                                                         | Studim kros-seksional | Në total 563         | Rritja e ndryshueshmërisë së HbA1c është e lidhur ngushtë me DPN dhe mund të konsiderohet si një tregues i fuqishëm.                                                                                    |
| Teliti M, 2018<br><i>Itali</i>      | Përcaktimi i rolit të ndryshueshmërisë së HbA1c dhe faktorëve të tjerë të rrezikut në zhvillimin e komplikimeve kryesore mikro-vaskulare: neuropatia periferike, nefropatia dhe retinopatia. | Studim kros-seksional | Në total 900         | Ndryshueshmëria e HbA1c u shoqërua me rritjen e incidencës së nefropatisë, ndërsa hemoglobina e glukozuar u shfaq si faktor rreziku i pavarur për zhvillimin e retinopatisë dhe neuropatisë periferike. |

Shënim: GN- Grupi i ndërhyrjeve; GK – Grupi i kontrollit; DPN – Nefropatia diabetike

### Menaxhimi i diabetit: Përdorimi i teknologjisë si një metodë për të përmirësuar menaxhimin e pacientëve diabetikë (tabela 5)

Për të vlerësuar përdorimin e teknologjisë apo aplikacioneve të ndryshme në menaxhimin e pacientëve diabetikë janë analizuar 11 studime të realizuara në: Francë, SHBA, Iran, Hong Kong, Arabinë Saudite, Indi, Itali dhe Tailandë. Popullata e përfshirë në këto studime varion nga 98 pacientë [50] në 506 pacientë [51].

Për edukimin e pacientëve diabetikë mund të përdoren metoda dhe aplikacione të ndryshme të cilat kanë filluar të përdoren dhe përpara periudhës së pandemisë së COVID-19.

Web – based ANODE ishte një program i përdorur me qëllim përmirësimin e cilësisë së dietës dhe eliminimit të faktorëve riskatë tek pacientët diabetikë [52]. Weblog ishte një aplikacion tjetër që ka gjetur përdorim në edukimin e pacientëve diabetikë i cili ka përmirësuar ndjeshëm praktikën vetmenaxhuese tek pacientët diabetikë [53].

Konsultimet online dhe monitorimi i pacientëve diabetikë mund të sjellin të njëjtin rezultat që mund të merej dhe nga konsultimet e drejtpërdrejta [54].

6 studime kanë vlerësuar përdorimin e telemedicinës gjatë periudhës së pandemisë së COVID-19. Kjo metodë është vlerësuar si një metodë e sigurt, efektive dhe me kostoeftektivitet për edukimin dhe këshillimin e pacientëve diabetikë gjatë periudhës së pandemisë [55], [56]. Sipas Dutta et al, Telemedicina është një metodë konsultuese efektive e cila ndihmon në ruajtjen e niveleve të glicemisë tek pacientët diabetikë pa i vendosur ata përballë rrezikut të infektimit ndaj COVID-19 [57], [58]. Telemedicina mund të integrohet në kujdeset ndaj pacientit diabetikë duke zëvendësuar disa nga vizitat in-person [56]. Tele-edukimi është një metodë tjetër e testuar gjatë 2022 në Iran. Edhe kjo metodë mund të përdoret si një mënyrë e mirë online për

mbështetjen dhe edukimin e pacientëve diabetikë [59].

Tabela 5. Menaxhimi i diabetit: *Përdorimi i teknologjisë si një metodë në menaxhimin e pacientëve diabetikë*

| Citimi i studimit                                     | Qëllimi i studimit                                                                                                                                                                                    | Lloji i studimit           | Popullata                          | Konkluzionet                                                                                                                                         |
|-------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------|------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Lindsay S 2021<br><i>SHBA</i>                         | Përcaktimi nëse simptomat e depresionit u reduktuan nga ndërhyrja                                                                                                                                     | Studim ndërhyrës           | Në total 506                       | Simptomat depresive mund të jenë një rezultat, dhe jo një faktor modifikues, i ndërhyrjeve mbështetëse                                               |
| Or CK 2020<br><i>Hong Kong</i>                        | Testimi dhe demonstrimi i efektivitetit dhe sigurisë së prototipit TSN                                                                                                                                | RTC                        | GN – 151<br>GK - 148               | TSN do të përmirësonte vetë-kujdesin e pacientit duke përmbyshur gjendjen e vetë-sigurisë së pacientit.                                              |
| H. Tasma et al 2022<br><i>Tajlandë</i>                | Vlerësimi i përdorimit të edukimit dhe mbështetjes për vetë-menaxhimin e diabetit (DSMES) dhe menaxhimit të glicemisë nëpërmjet telemjekësisë, në pacientët e izoluar në shtëpi me infeksion COVID-19 | Studim retrospektiv        | Në total 119                       | Përdorimi i telemedicinës gjatë karantinimit të COVID-19 ishte i sigurt dhe efektiv                                                                  |
| Faleh AlMutairi M et al 2021<br><i>Arabia Saudite</i> | Vlerësimi i kosto-efektivitetit të telemjekësisë për pacientët me diabet mellitus të pakontrolluar të tipit 2 (gjatë Covid-19)                                                                        | Studim retrospektiv        | GN – 100<br>GK - 100               | Kujdesi i telemjekësisë është me kosto efektive në menaxhimin e pacientëve të tipit 2 me diabet të kontrolluar dobët.                                |
| Molavynejad, S et al 2022<br><i>Iran</i>              | Krahasimi i efektit të edukimit ballë për ballë kundrejt edukimit nëpërmjet telekujdesit në pacientët me T2DM                                                                                         | RTC                        | GN - 126<br>GK – 126<br>Gk-1 - 126 | Tele-edukimi ishte po aq efektiv sa metoda e edukimit personal për pajtueshmërinë e regjimit dietik në një periudhë tre mujore.                      |
| M Tourkmani 2021<br><i>Arabia Saudite</i>             | Vlerësimi i ndikimit të klinikave virtuale në kontrollin e glicemisë                                                                                                                                  | Studim prospektiv          | Ne total 130                       | Telemjekësia ndikon në kontrollin e glicemisë.                                                                                                       |
| Dutta A, 2021<br><i>Indi</i>                          | Krahasimi i efikasitetit të konsultimit me video për kontrollin e mundshëm të glicemisë kundrejt atij të vizitës klinike personale                                                                    | Studim kohort retrospektiv | GN – 48<br>GK - 48                 | Telemjekësia ishte një mënyrë efektive konsultimi për arritjen e kontrollit të glicemisë gjatë pandemisë COVID-19.                                   |
| Sood A 2018<br><i>SHBA</i>                            | Vlerësimi i përdorimit të konsultimeve të telemjekësisë në menaxhimin e pacientëve me diabet mellitus                                                                                                 | RTC                        | GN – 199<br>GK - 83                | Konsultimi i telemjekësisë u shoqërua me nivele të mira të HbA1c dhe gjithashtu me kënaqësi më të mirë të pacientit dhe ofruesit të kujdesit parësor |
| Rasoul, A.M., 2019<br><i>Iran</i>                     | Përcaktimi i efektit të edukimit të vetë-menaxhimit përmes ëeblogs në cilësinë e jetës së pacientëve                                                                                                  | Studim ndërhyrës           | GN – 49<br>GK – 49                 | Efekti pozitiv i vetë-menaxhimit të bazuar në blog në cilësinë e jetës së pacientëve me diabet pas ndërhyrjes.                                       |
| Maietti E 2021<br><i>Itali</i>                        | Identifikimi i përcaktuesëve individualë të cilësisë së perceptuar të shërbimeve të telemjekësisë dhe teleasistencës dhe gatishmërinë për të vazhduar me to                                           | Studim krossekstional      | Ne total 596                       | Telemjekësia dhe ndihma në distancë do të luajnë një rol të madh në ndihmën e pacientëve me diabet, edhe pas pandemisë COVID-19                      |
| Hansel B 2017<br><i>Francë</i>                        | Vlerësimi i një ndërhyrje të bazuar në ëeb, për të ndihmuar përdoruesit të përmirësojnë zakonet e tyre dietike dhe të rrisin aktivitetin e tyre fizik.                                                | RTC                        | GN – 60<br>GK – 60                 | Përmirësim i ndjeshëm në cilësinë e dietës dhe disa faktorë të rëndësishëm rreziku kardiometabolik.                                                  |

Shënim: GN- Grupi i ndërhyrjeve; GK – Grupi i kontrollit;

**Menaxhimi i diabetit: Parandalimi i diabetit**  
(Tabela 6)

Ishin 10 studime të cilat u klasifikuan si studime që kanë vlerësuar metodat e parandalimit të diabetit. Popullata e përfshirë në studim varion nga 3684 pjesmarës [66] në 77 pjesmarës [69]. Kohëzgjatja e nderhyrjeve gjithashtu ishte e ndryshme nga 12-30 jave [65] në 5 vjet [62]. Këto studime janë realizuar në shtete të ndryshme si SHBA, Indi, Azinë e Jugut, Angli, Singapor, Finlandë dhe Norvegji.

Tabela 6. Menaxhimi i diabetit: *Parandalimi i diabetit*

| Citimi i studimit                          | Qëllimi i studimit                                                                                                                                                                              | Lloji i studimit      | Popullata e përfshirë              | Konkluzionet                                                                                                                                                                                                                        |
|--------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Dagogo-Jack S et al 2021<br><i>SHBA</i>    | Efektet e stilit të jetës tek individët pre-diabetik me kohëzgjatje të njohur për të përcaktuar nëse rezultatet janë të lidhura me kohëzgjatjen e para-diabetit.                                | Studim kohort         | GN – 72<br>GK – 151                | Individet që patën ndërhyrje në stidlin e jetesës brenda 3 muajve deri në 8 vjet (mesatarisht 4 vjet) nuk përparuan në T2D gjatë 5 viteve të ndjekjes.                                                                              |
| Oëei I. Et al 2019<br><i>SHBA</i>          | Vlerësimi i ndërgjegjësimit për statusin e prediabetit dhe sjelljen pasuese shëndetësore, peshën trupore dhe nivelet e glukozës në gjak                                                         | Studim kohort         | GN – 73<br>GK – 73                 | Komunikimi i statusit të prediabetit shoqërohet me përmirësime në tolerancën ndaj glukozës, gliceminë                                                                                                                               |
| Dagogo-Jack S et al 2020<br><i>SHBA</i>    | Përcaktimi i historisë natyrore dhe rikthimit të prediabetit.                                                                                                                                   | Studim kohort         | GN – 158<br>GK – 65                | Programi i përdorur kishte fizibilitet për të testuar rikthimin e prediabetit.                                                                                                                                                      |
| Tandon N et al 2022<br><i>Azia e Jugut</i> | Vlerësimi nëse një ndërhyrje e përshtatshme për burimet dhe kontekstin e stilit të jetesës mund të parandalojë përkeqësimin e glicemisë tek gratë me diabet gestacional                         | RTC                   | GN – 800<br>GK – 801               | Gjate periudhës së pandemisë së COVID-19 ndërhyrjet në drejtim të stilit të jetesës tek gratë me diabet gestacional nuk parandaluan përkeqësimin e niveleve të glicemisë.                                                           |
| Sampson M, et al 2021<br><i>Angli</i>      | Përcaktimi nëse një ndërhyrje e bazuar në stilin e jetesës në grup reduktoi rrezikun e përparimit në diabetin e tipit 2.                                                                        | RTC                   | GN1 – 142<br>GN2 – 141<br>GK – 149 | Ndërhyrja e stilit të jetesës përmirësoi ndjeshëm kontrollin e glicemisë pas 12 muajsh kur mbështetej nga mentorë të trajnuar                                                                                                       |
| Yeë TË et al 2020<br><i>Singapor</i>       | SMART-GDM ekzaminoi nëse Habits-GDM, një program trajnimi i aplikacioneve për smartphone, mund të parandalojë shtimin e tepërt të peshës gestacionale dhe të përmirësojë kontrollin e glicemisë | RTC                   | GN – 170<br>GK – 170               | Kur i shtohet kujdesit të zakonshëm, Habits-GDM rezultoi në kontroll më të mirë të glicemisë së nënës por nuk uli EGËG tek gratë me GDM.                                                                                            |
| Huvinen E et al 2020<br><i>Finlandë</i>    | Vlerësimi nëse stili i jetesës është i lidhur me shëndetin glicemik të grave me rrezik të lartë 5 vjet pas lindjes, duke marrë parasysh BMI-në para shtatzënisë.                                | Studim kros seksional | GN – 223<br>GK – 125               | Mënyra e jetesës 5 vjet pas lindjes u shoqërua me një shëndet më të mirë glicemik vetëm në mesin e grave obeze me rrezik të lartë. Aktiviteti fizik është thelbësor për shëndetin metabolik të të gjitha femrave me rrezik të lartë |
| Følling IS et al 2022<br><i>Norvegji</i>   | A është e mundur të parandalohej diabeti i tipit 2 për individët me rrezik të lartë?                                                                                                            | Studim longitudinal   | Në total 189                       | Angazhimi afatgjatë për pjesëmarrësit në ndërhyrjet e kujdesit parësor shëndetësor mund të jetë i dobishëm për reduktimin e rrezikut të diabetit dhe përmirësimin e antropometrisë.                                                 |
| Sevilla-Gonzalez MDR 2022<br><i>SHBA</i>   | Identifikimi i pengesave, fizibilitetit, përdorshmërinë dhe efektivitetin e Vida Sana për të regjistruar zakonet e                                                                              | Studim prospektiv     | Në total 77                        | Përdorimi i platformës së internetit ishte efektiv për përmirësimin e parametrave glicemikë dhe antropometrikë në një popullatë në                                                                                                  |

Në këto 10 studime, 7 prej tyre prezantonin rëndësinë dhe efektivitetin e përdorimit të programit DPP (The Diabetes Prevention Program).

Këto studime kanë raportuar përmirësim në parandalimin e diabetit [60], [61], modifikime në stilin e jetesës [62], përmirësim në parametrat antropometrik dhe në kontrollin e glicemisë [64], [65], [66], [67], [69].

|                                                                  |                                                                                                                                                                                                                  |                       |                        |                                                                                                                                 |
|------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                                  | stilit të jetesës në subjektet në rrezik të zhvillimit të T2D                                                                                                                                                    |                       |                        | rrezik të zhvillimit të diabetit.                                                                                               |
| Muileijk M et al 2021<br><i>Indi, Pakistan, Sri Lanka, Angli</i> | Vlerësimi nëse ndërhyrjet intensive në stilit të jetesës me bazë familjare çon në humbje të konsiderueshme në peshë, përmirësim të glicemisë dhe presionit të gjakut tek të rriturit me rrezik të lartë për T2D. | Studim krossekstional | Ne total 596           | Telemjekësia dhe ndihma në distancë do të luajnë një rol të madh në ndihmën e pacientëve me diabet, edhe pas pandemisë COVID-19 |
| Hansel B 2017<br><i>Francë</i>                                   | Vlerësimi i një ndërhyrje të bazuar në ëeb, për të ndihmuar përdoruesit të përmirësojnë zakonet e tyre dietike dhe të rrisin aktivitetin e tyre fizik.                                                           | RTC                   | GN – 1846<br>GK – 1838 | Këto ndërhyrje çuan në reduktim efektiv të peshës dhe perimetrit të belit në 12 muaj.                                           |

Shënim: GN- Grupi i ndërhyrjeve; GK – Grupi i kontrollit;

**Diskutimi:** Ky punim dhe këto 78 studime të analizuar tregojnë se ekzistojnë strategji lehtësisht të zbatueshme për të promovuar dhe mbrojtur shëndetin e pacientit diabetik.

Edukimi në drejtim të vet-menaxhimit është një proces i lehtësimit të njohurive dhe aftësive për vetëkujdes ndaj diabetit. Kjo përfshin aktivitete që ndihmojnë një person të përmirësojë sjelljet për të menaxhuar shëndetin e tyre [70]. Studime të shumta kanë treguar se edukimi dhe mbështetja e pacientëve me diabet është shumë më efektive nëse ofrohet nga një ekip multidisiplinar i përbërë nga infermierë dietologë, farmacistë mjek specialitë etj. Bashkëpunimi ndërmjet anëtarëve të këtij ekipi përmirëson partneritetin midis kujdesit parësor dhe edukatorëve shëndetësorë [70].

Edukimi shëndetësor i pacientit diabetik dhe përdorimi i programeve të ndryshme në këtë kontekst është shumë efektiv dhe mbështetë nga një numër i konsiderueshëm studimesh. Edukimi shëndetësor mund të përmirësojë cilësinë e jetës së pacientëve diabetikë duke parandaluar gjithashtu kostot e komplikacioneve afatgjata. Shumica e studimeve të përfshira në këtë analizë nxjerrin në pah rëndësinë e edukimit shëndetësor të pacientëve me diabet, i cili përmirëson vet-menaxhimin dhe ndikon në ndryshimin e stilit të jetesës së pacientëve diabetikë. Ky edukim shëndetësor i realizuar veçanërisht nga shërbimi shëndetësor parësor mund të jetë shumë më tepër efikas.

Pas një analize të kujdesshme të studimeve të përfshira në këtë analizë, themi se edukimi shëndetësor ndikon pozitivisht në stilin e jetesës dhe gjendjen shëndetësore të pacientit diabetik. Megjithatë, zbatimi i programeve të ndryshme edukuese dhe efektiviteti i tyre mund të ndikohet nga faktorë të ndryshëm si kohëzgjatja e edukimit, burimet në dispozicion, statusi socio-ekonomik i pacientëve ose aksesit ndaj shërbimeve shëndetësore.

Në 15 nga studimet e analizuar janë paraqitur dëshmi të qarta të ndikimit të edukimit të pacientit në uljen e niveleve të HbA1c, ku shumica e këtyre studimeve janë kryer në popullata të vendeve të zhvilluara si SHBA, Spanja, Italia dhe Zelanda e Re. Por pothuajse të gjitha studimet e tjera kanë raportuar se zbatimi i ndërhyrjeve për të përmirësuar njohuritë e pacientëve dhe për të ndjekur një mënyrë jetese të shëndetshme ka një ndikim të madh në përmirësimin e vetë-menaxhimit të pacientit diabetik.

Përfshirja e stafit infermior dhe farmacistëve në programet edukative dhe mbështetëse për pacientin diabetik ka një rol të rëndësishëm në përmirësimin e vetë-menaxhimit të pacientit diabetik. Infermierët shihen si personel që ofron shërbim shëndetësor me kosto-efektivitet, personel më i aksesueshëm të cilët mund të ofrojnë edukim, mbështetje dhe këshillim shëndetësor.

Në Shqipëri u gjetën 2 studime në formë elektronike të cilat evidentuan rolin e edukimit shëndetësor në përmirësimin e stilit të jetesës së pacientit diabetik ose në lehtësimin e përshtatjes psikologjike të pacientit diabetik me patologjinë e tij [11], [72].

Studimi ynë gjithashtu theksoi qasjet e ndryshme për angazhimin ndaj dietave të strukturuar dhe aktivitetit fizik dhe rolin e tyre në menaxhimin e diabetit me dëshmi të efikasitetit në përmirësimin e rezultateve të tilla si HbA1c [20], [24], [73].

**Konkluzione:** Diabeti është një sëmundje kronike, komplekse dhe nëse nuk menaxhohet mirë mund të sjellë rezultate të pakënaqshme për pacientin apo sistemin shëndetësor. Përmirësimi i kapaciteteve organizative në sistemet shëndetësore do të bënte të mundur që ne të përdorim praktikatat më të mira të kujdesit. Puna në grup, përdorimi i teknologjisë, përdorimi i protokolleve të kujdesit do të

ndihmonte pacientin diabetik për të menaxhuar

më mirë shëndetin e tij.

### Referencat

- [1] WHO. (2022). *Diabetes Key facts Access 06 June 202 Available online* <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/diabetes>.
- [2] IDF. (2021). *Diabetes Atlas. Online version ISBN 978 2 930229 98 0*.
- [3] Ligairi, Josua; Wilson, Donald, Patel, Mahomed (2020). Barriers to Supporting Patient Access for Quality Diabetes Care: the Care Givers Perspective .DOI – 10.13140/RG.2.2.22279.42404
- [4] Somanawat, J., Saramunee, K. and Chanasopon, S. (2020). Process, quality and challenges of diabetes care in primary care: a study of district health network in Thailand," . *Primary Health Care Research & Development, Cambridge University Press, 21, p. e46* .
- [5] NIH. (2022). Retrieved from The ADA's 2022 Standards of Medical Care in Diabetes Update accessed 07 June 2022 Available online <https://www.niddk.nih.gov/health-information/professionals/diabetes-discoveries-practice/ada-2022-standards-of-medical-care-in-diabetes-update>.
- [6] Kesavadev, J. M. (2012). Suggested use of vaccines in diabetes. *Indian journal of endocrinology and metabolism*, 16(6), 886–893. <https://doi.org/10.4103/2230-8210.102982>.
- [7] Plessis, R. D. (2022). Effects of an isometric exercise training program on muscular strength, ankle mobility, and balance in patients with diabetic peripheral neuropathy in the lower legs in South Africa. *Int J Diabetes Dev Ctries* (<https://doi.org/10.1007/s13410-022-01068-1> ).
- [8] Piya, M. K. (2022). ). The impact of nursing staff education on diabetes inpatient glucose management: a pilot cluster randomised controlled trial. *BMC endocrine disorders* , 61 (<https://doi.org/10.1186/s12902-022-00975-y>), 22(1),.
- [9] Jianhua Wang, Y. Z. (2022). Study on the Nursing Effect of Diabetes Health Education Nursing Methods Applied to Diabetes Patients in the Endocrinology Department. *Journal of Healthcare Engineering* (<https://doi.org/10.1155/2022/3363096>), 5 pages.
- [10] Li R, Xu W, Yang P, Tan L, Ling Z and Gan X (2022). The Nursing Effect of Individualized Management on Patients With Diabetes Mellitus Type 2 and Hypertension. *Front. Endocrinol* (846419. doi: 10.3389/fendo.2022.846419), 13.
- [11] Ramaj, A , Kamberi F, Behrens, J. (2019). Effects of Diabetes Education on Emotional Distress in Patients with Type 2 Diabetes—An Experimental Study. . *Open Journal of Endocrine and Metabolic Diseases*, 9, 9-20. doi: 10.4236/ojemd.2019.92002 , Numri 4 Volumi 2.
- [12] Madrigal V, Courtney M. (2021). Implementing an Exercise Evidence-Based Guideline for Type 2 Diabetes Mellitus. *J Family Med Prim Care* (Open Acc 5: 158. DOI: 10.29011/2688-7460.100058).
- [13] Hale L, H. C. (2022). The diabetes community exercise programme plus usual care versus usual care in patients with type 2 diabetes: A randomised, two-arm, parallel, open-label trial. *EClinicalMedicine* (doi: 10.1016/j.eclinm.2022.101361. PMID: 35360148; PMCID: PMC8961191.), Mar 25;46:101361.
- [14] Parra DI, Guevara SLR, Rojas LZ. 'Teaching: individual' to improve adherence in hypertension and type 2 diabetes. *Br J Community Nurs*. 2021 Feb 2;26(2):84-91. doi: 10.12968/bjcn.2021.26.2.84. PMID: 33539242.
- [15] Rubin DJ, G. P. (2022). The Diabetes Transition of Hospital Care (DiaTOHC) Pilot Study: A Randomized Controlled Trial of an Intervention Designed to Reduce Readmission Risk of Adults with Diabetes. . *J Clin Med* (doi: 10.3390/jcm11061471. PMID: 35329797; PMCID: PMC8949063), Mar 8;11(6):1471.
- [16] Yuniartika, W. H. (2021). Improving knowledge of diabetes mellitus patients using booklet'. *Journal of Medicinal and Chemical SciencesOpen Access* (ISSN 26514702 DOI 10.26655/JMCHEMSCI.2021.3.4), AccessVolume 4, Issue 3, Pages 238 - 245.
- [17] Areevut, C. R. (2021). Factors predicting adequate glycemic control after participation in diabetes self-management education and support program: The role of behavioral change. *Journal of the Medical Association of Thailand , Volume 104 ( Issue 3), Pages 410 - 417*.
- [18] Manios Y, M. G. (2017). Postprandial glucose and insulin levels in type 2 diabetes mellitus patients after consumption of ready-to-eat mixed meals. *Eur J Nutr* , 56:1359-67.
- [19] Tayyem R, H. A. (2022). Association of Glycemic Control With Different Diets Followed by Patients With Type 2 Diabetes: Findings From Qatar Biobank Data. *Front Nutr.* , 9:813880.
- [20] Liu Y, Y. W. (2019). Resistance exercise intensity is correlated with attenuation of HbA1c and insulin in patients diabetes. *Int J Environ res Public Health* , 16(1):140.
- [21] Ranasinghe C, D. S. (2021). Glycemic and cardiometabolic effects of exercise in South Asian Sri Lankans with type 2 diabetes mellitus: A randomized controlled trial Sri Lanka diabetes

aerobic and resistance training study (SL-DARTS). *Diabetes Metab Syndr*, 15(1), 77-85.

[22] Alonso-Domínguez R, P.-A. M. (2019). Effect of a multifactorial intervention on the increase in physical activity in subjects with type 2 diabetes mellitus: a randomized clinical trial (EMID Study). *Eur J Cardiovasc Nurs*, 18(5), 399-409.

[23] Rossen J, H. M. (2022). Physical Activity Patterns among Individuals with Prediabetes or Type 2 Diabetes across Two Years-A Longitudinal Latent Class Analysis. *Int J Environ Res Public Health*, 19(6), 3667.

[24] Ramal E, C. A. (2018). Impact of a Plant-Based Diet and Support on Mitigating Type 2 Diabetes Mellitus in Latinos Living in Medically Underserved Areas. *Am J Health Promot*, 32(3), 753-762.

[25] Kahleova H, H. A. (2019). Fat Quantity and Quality, as Part of a Low-Fat, Vegan Diet, Are Associated with Changes in Body Composition, Insulin Resistance, and Insulin Secretion. A 16-Week Randomized Controlled Trial. *Nutrients*, 11(3):615.

[26] Saslow LR, M. A.-S. (2017). An Online Intervention Comparing a Very Low-Carbohydrate Ketogenic Diet and Lifestyle Recommendations Versus a Plate Method Diet in Overweight Individuals With Type 2 Diabetes: A Randomized Controlled Trial. *J Med Internet Res*, 19(2):e36.

[27] Devlin BL, P. E. (2021). Lower nocturnal blood glucose response to a potato-based mixed evening meal compared to rice in individuals with type 2 diabetes. *Clin Nutr*, 40(4), 2200-2209.

[28] Alsayed Hassan, D., Curtis, A., Kerver, J., & Vangsnes, E. (2020) Diabetes Self-Management Education and Support: Referral and Attendance at a Patient-Centered Medical Home Journal of primary care & community health

[29] Azami G, S. K. (2018, Jul 8). Effect of a Nurse-Led Diabetes Self-Management Education Program on Glycosylated Hemoglobin among Adults with Type 2 Diabetes. *J Diabetes Res*.

[30] Kashani F, A. P. (2021). The components of diabetes educator's competence in diabetes self-management education in Iran: A qualitative study. *J Educ Health Promot*, 10:111.

[31] Abdulrhim S, A. A. (2022). Impact of pharmacist-involved collaborative care on diabetes management in a primary healthcare setting using real-world data. *Int J Clin Pharm*, 44(1):, 153-162.

[32] Korcegez EI, S. M. (2017). Effect of a Pharmacist-Led Program on Improving Outcomes in Patients with Type 2 Diabetes Mellitus from Northern Cyprus: A Randomized

Controlled Trial. *J Manag Care Spec Pharm*, 23(5), 573-582.

[33] Norton MC, H. M. (2020). Impact of Physician-Pharmacist Collaboration on Diabetes Outcomes and Health Care Use. *J Am Board Fam Med*, 33(5):, 745-753.

[34] Bazzazian, S. (2017). Biopsychosocial Path Model of Self-Management and Quality of Life in Patients with type 2 Diabetes. *Journal Of Bioinformatics And Diabetes*, 1(3):, 35-44.

[35] Cicek SC, D. S. (2021). Effect of reflexology on ankle brachial index, diabetic peripheral neuropathy, and glycemic control in older adults with diabetes: A randomized controlled trial. *Complement Ther Clin Pract*. Aug;44:101437. doi: 10.1016/j.ctcp.2021.101437. Epub 2021 Jul 4. PMID: 34237668.

[36] Rossboth S, R. B. (2021). Risk factors for diabetic foot complications among patients with type 2 diabetes in Austria-A registry-based retrospective cohort study. *Endocrinol Diabetes Metab*, 4(4):e00286.

[37] Rossboth S, R. B. (2022). Diabetic foot complications-lessons learned from real-world data derived from a specialized Austrian hospital. *Wien Klin Wochenschr*, 134(1-2):, 7-17.

[38] Scain SF, F. E. (2018). Effects of nursing care on patients in an educational program for prevention of diabetic foot. *Rev Gaucha Enferm*, 29:39:e20170230.

[39] Fujii K, S. M. (2021). Effects of Nurse and Care Worker-led Foot-Care Program on Older People's Foot Conditions: Before and After Intervention Study. *SAGE Open Nurs*, 7: (23779608211058492).

[40] Nguyen TPL, E. H. (2019). Effectiveness of a theory-based foot care education program (3STEPFUN) in improving foot self-care behaviours and foot risk factors for ulceration in people with type 2 diabetes. *Diabetes Res Clin Pract*, 152, 29-38.

[41] Fu, X. J. (2021). Observation of the effect of one-to-one education on high-risk cases of diabetic foot. *World journal of clinical cases*, 9(14), 3265-3272.

[42] Hosseini SS, S. M. (2021). The effect of educational program based on theory of planned behavior on promoting retinopathy preventive behaviors in patients with type 2 diabetes. *RCT. BMC Endocr Disord*, 21(1):17.

[43] Lake AJ, H.-B. J. (2020). Effect of a tailored leaflet to promote diabetic retinopathy screening among young adults with type 2 diabetes: a randomised controlled trial. *BMC Ophthalmol*, 20(1):80.

[44] Khair Z, R. M. (2020). Health education improves referral compliance of persons with probable Diabetic Retinopathy: A randomized controlled trial. *PLoS One*, 15(11):e0242047.

- [45] Wykoff CC, K. R. (2021). Risk of Blindness Among Patients With Diabetes and Newly Diagnosed Diabetic Retinopathy. *Diabetes Care*, 44(3); 748-756.
- [46] Ahmed TM, D. K. (2021). Use of Eye Care Service and Associated Factors Among Adult Diabetic Patients Attending at Diabetic Clinics in Two Referral Hospitals, Northeast Ethiopia. *Diabetes Metab Syndr Obes*, 14, 2325-2333.
- [47] Ahrary Z, K. S. (2020). The effects of a supportive-educational intervention on women with type 2 diabetes and diabetic peripheral neuropathy: a randomized controlled trial. *Clin Rehabil*, 34(6); 794-802.
- [48] Su JB, Z. L. (2018). A1c variability and diabetic peripheral neuropathy in type 2 diabetic patients. *Cardiovasc Diabetol*, 17(1):47.
- [49] Teliti M, C. G. (2018). Risk factors for the development of micro-vascular complications of type 2 diabetes in a single-centre cohort of patients. *Diab Vasc Dis Res*, 15(5), 424-432.
- [50] Dutta A, M. S. (2021). Video Consultation Versus In-Person Clinic Visit for Glycemic Control in Type 2 Diabetes during COVID-19 Pandemic (VIP-CD Study). *Indian J Endocrinol Metab*, 25(5), 427-431.
- [51] Lindsay S. Mayberry, L. A. (2021). Adults with type 2 diabetes benefit from self-management support intervention regardless of depressive symptoms. *Journal of Diabetes and its Complications*, Volume 35, Issue 11, 108024, ISSN 1056-8727, <https://doi.org/10.1016/j.jdiacomp.2021.108024>.
- [52] Hansel B, G. P. (2017). Fully Automated Web-Based Program Improves Lifestyle Habits and HbA1c in Patients With Type 2 Diabetes and Abdominal Obesity: Randomized Trial of Patient E-Coaching Nutritional Support (The ANODE Study). *J Med Internet Res*, 19(11):e360.
- [53] Rasoul, A. J. (2019). The effect of self-management education through weblogs on the quality of life of diabetic patients. *BMC Med Inform Decis Mak*, 19, 205.
- [54] Sood A, W. S. (2018). Telemedicine consultation for patients with diabetes mellitus: a cluster randomised controlled trial. *J Telemed Telecare*, 24(6); 385-391.
- [55] Faleh AlMutairi M, Tourkmani AM, Alrasheedy AA, ALHarbi TJ, Bin Rsheed AM, ALjehani M, AlRuthia Y. (2021). Cost-effectiveness of telemedicine care for patients with uncontrolled type 2 diabetes mellitus during the COVID-19 pandemic in Saudi Arabia. *Ther Adv Chronic Dis*, 12:204062232111042542.
- [56] M Tourkmani A, J ALHarbi T, Rsheed AMB, Alrasheedy AA, ALMadani W, ALJuraisi F, ALOtaibi AF, ALHarbi M, AlAbood AF, Alshaikh AA. (2021, Feb 1). The impact of telemedicine on patients with uncontrolled type 2 diabetes mellitus during the COVID-19 pandemic in Saudi Arabia: Findings and implications. *J Telemed Telecare*.
- [57] Dutta A, Mahendru S, Sharma R, Singh A, Jain A, Jevalikar G, Mithal A (2021). Video Consultation Versus In-Person Clinic Visit for Glycemic Control in Type 2 Diabetes during COVID-19 Pandemic (VIP-CD Study). *Indian J Endocrinol Metab*, 25(5), 427-431.
- [58] Maietti E, Sanmarchi F, Palestini L, Golinelli D, Esposito F, Boccaforno N, Pia Fantini M, Di Bartolo P (2021, Oct). The experience of patients with diabetes with the use of telemedicine and teleassistance services during the COVID-19 pandemic in Italy: Factors associated with perceived quality and willingness to continue. *Diabetes Res Clin Pract*.
- [59] Molavynejad, S., Miladinia, M. & Jahangiri, M. (2022). A randomized trial of comparing video telecare education vs. in-person education on dietary regimen compliance in patients with type 2 diabetes mellitus: a support for clinical telehealth Providers. *BMC Endocr Disord*, 22, 116.
- [60] Dagogo-Jack S, B. A. (2020). Pathobiology and Reversibility of Prediabetes in a Biracial Cohort (PROP-ABC) Study: design of lifestyle intervention. *BMJ Open Diabetes Res Care*, 8(1):e000899.
- [61] Dagogo-Jack S, U. N. (2022). Outcome of lifestyle intervention in relation to duration of pre-diabetes: the Pathobiology and Reversibility of Prediabetes in a Biracial Cohort (PROP-ABC) study. *BMJ Open Diabetes Res Care*, 10(2):e002748.
- [62] Owei I, U. N.-J. (2019). Awareness of Prediabetes Status and Subsequent Health Behavior, Body Weight, and Blood Glucose Levels. *J Am Board Fam Med*, 32(1); 20-27.
- [63] Tandon N, G. Y. (2022). LIVING Collaborative Group. Effects of a Lifestyle Intervention to Prevent Deterioration in Glycemic Status Among South Asian Women With Recent Gestational Diabetes: A Randomized Clinical Trial. *JAMA Netw Open*, 1;5(3):e220773.
- [64] Sampson M, C. A. (2021). Norfolk Diabetes Prevention Study (NDPS) Group. Lifestyle Intervention With or Without Lay Volunteers to Prevent Type 2 Diabetes in People With Impaired Fasting Glucose and/or Nondiabetic Hyperglycemia: A Randomized Clinical Trial. *JAMA Intern Med*, 181(2); 168-178.
- [65] Yew TW, C. C.-L. (2020). A Randomized Controlled Trial to Evaluate the Effects of a Smartphone Application-Based Lifestyle Coaching Program on Gestational Weight Gain, Glycemic Control, and Maternal and Neonatal

Outcomes in Women With Gestational Diabetes Mellitus: The SMART-GDM. *Diabetes Care* , 44(2), 456-463.

[66] Muilwijk M, L. M.-E. (2021). Effects of a lifestyle intervention programme after 1 year of follow-up among South Asians at high risk of type 2 diabetes: a cluster randomised controlled trial. *BMJ Glob Health* , 6(11):e006479.

[67] Huvinen E, E. E.-L. (2020). Lifestyle and glycemic health 5 years postpartum in obese and non-obese high diabetes risk women. *Acta Diabetol* , 57(12), 1453-1462.

[68] Følling IS, K. C. (2022). Preventing type 2 diabetes, overweight and obesity in the Norwegian primary healthcare: a longitudinal design with 60 months follow-up results and a cross-sectional design with comparison of dropouts versus completers. *BMJ Open* , 12(3):e054841.

[69] Sevilla-Gonzalez MDR, B.-R. B.-C.-R.-V.-R. (2022). Evaluation of a Web Platform to Record Lifestyle Habits in Subjects at Risk of Developing Type 2 Diabetes in a Middle-Income Population:

Prospective Interventional Study. *JMIR Diabetes* , 7(1):e25105.

[70] Joni Beck, D. A. (2017). *American Diabetes Association*. Gjetur July 12, 2022, nga American Diabetes Association: <https://diabetesjournals.org/care/article/40/10/1409/29569/2017-National-Standards-for-Diabetes-Self>

[71] Funnell MM, B. T. (2011). National standards for diabetes self-management education. *Diabetes Care* , 33 Suppl 1: (34 Suppl 1(Suppl 1):S89-96).

[72] Alida Rama, Fatjona Kamberi (2019 ). Influence of education training in type 2 diabetes patients in the improvement of lifestyle and biochemical characteristics: a randomized controlled trial. . *Front Nurs*. 2019; 4: 293-300.

[73] Ranasinghe C, D. S. (2021). Glycemic and cardiometabolic effects of exercise in South Asian Sri Lankans with type 2 diabetes mellitus: A randomized controlled trial Sri Lanka diabetes aerobic and resistance training study (SL-DARTS). *Diabetes Metab Syndr* , 15(1), 77-85

# Lodhja, efekti i formave të ndryshme të rehabilitimit, në lehtësimin e saj në pacientët me Sklerozë Multiple

**Dr. Evis Allushi**

**Phd candidate Vasilika Prifti**

**Phd candidate Sonila Nika**

evis.allushi@univlora.edu.al

## Abstrakt

Skleroza e shumëfishtë është një sëmundje degenerative e sistemit nervor që prek trurin dhe palcën kurrizore. Referuar "Fatigue National Multiple Sclerosis Society", lodhja është një nga shenjat më të shpeshta në pacientët me SM, e cila prek rreth 80% të tyre. Ajo interferon në jetën e pacientëve si në shtëpi ashtu edhe në punë, dhe është një shkaktarët e parë të largimit të pacientëve nga jeta e tyre aktive.

Objektivi i këtij artikulli është shqyrtimi i literaturës për të parë lidhjen midis lodhjes dhe rehabilitimit fizik, në pacientët me SM, dhe ndikimit të tyre tek njëri tjetri. Kërkimi përfshiu të dhënat bazë elektronike të: Ovid PubMed, Cochrane Library, NLM Tools. Më shumë se tridhjetë artikuj potencialë u identifikuan, por në shqyrtim u përfshin rezultatet origjinale të nëntë studimeve që kishin lidhje me tematikën e interesit përfshirë dhe rishikime të literaturës. Studimet e analizuara theksuan se rehabilitimi është një terapi mjaft e rëndësishme në menaxhimin e lodhjes, përmirësoi nivelin e lodhjes në pacientët me SM, pavarësisht nga niveli i aftësisë së kufizuar, edhe pse përmirësimi mund të jetë i shkurtër në kohë, ç'ka kërkon përfshirjen e një rehabilitimi gjithëpërfshirës ambulator për të gjithë pacientët me MS.

U identifikuan gjetje kontradiktore në literaturën e botuar në lidhje me ndikimin e lodhjes në aftësinë e pacientëve për të realizuar rehabilitimin.

Është e nevojshme të bëhen studime me metodologji më të rreptë, për të sqaruar se cila formë e rehabilitimit mund të çojë në mirëmenaxhim të lodhjes, përmirësime më të mëdha klinike.

**Fjalët kyç:** sklerozë multiple, lodhje, rehabilitim fizik

## Abstract

Multiple sclerosis is a degenerative disease of the nervous system that affects the brain and spinal cord. According to "Fatigue National Multiple Sclerosis Society", fatigue is one of the most common symptoms in patients with MS, which affects about 80% of them. It interferes with patients' lives, and is one of the first causes of patients' ability.

| Longitudinal studies  | Journal of Criminal Justice, (2021)                                       | 2567 | The risk of infection and poor communication were as major stressors.                                                  | Austria, Germany, Switzerland, Holland, Spain |
| Cross-sectional study | Psicothema, (2021)                                                        | 640  | The perception of the lack of personal protective equipment and the risk of infection were the main sources of stress. | Spain                                         |
| Cross-sectional study | J Nepal Health Res Counc (2021)                                           | 1526 | 24% reported having stress due to xenophobia, 20% from fear of infection and 19% from compulsive control.              | Nepal                                         |

## 8. Discussions

According to the reviewed studies, two main stress factors have been identified, respectively, operational factors and organizational factors. Operational factors are related to stress at work, which includes: fatigue, workload, family support, risk of infection, incidents and traumas during work. Organizational factors are related to mental health in which are included: lack of knowledge about the disease, inadequate management by managers, inadequate safety equipment, inadequate logistics, lack of pre-disaster training, understaffing and constantly changing policies. The duties of the police changed significantly during the pandemic compared to the daily roles and tasks they performed before it.

In a study conducted in Austria, Germany, Switzerland, the Netherlands and Spain in 2020, the results presented showed that the risk of infection in the near future, and the lack of professional information were the main stressors in police work. Another study of Malaysian police officers concluded that most police officers had average levels of anxiety, stress and depression. A study conducted in China showed that 12% of police officers, engaged during the COVID-19 pandemic reported moderate to high depression. In New York, in 2020, approximately 13% of police officers have experienced mental health deterioration, of which 60 officers died by suicide caused by the COVID-19 pandemic.

## 9. Conclusions

During the COVID-19 pandemic, police officers provided an essential contribution to ensuring public order and slowing the spread of the virus. The crisis caused by the COVID-19 pandemic has affected the police organization as well as the police officers. The impacts are visible to every police officer both at the organizational and individual level. In addition to the traditionally performed work, new tasks have also been assigned to them, related to the implementation of state measures in the prevention of the SARS-CoV-2 virus. Police officers faced many difficulties during the COVID-19 pandemic such as: fear of infection, rapid implementation of government measures, frequent change of roles, addition of new duties and numerous changes in work protocols. All these factors affected the psychological well-being of law enforcement officers. In the future, it is vital that police officers are provided with the tools and support through ongoing training so that, they can successfully manage and cope with crises, emergency situations or natural disasters.

Identifying the characteristics and behaviors of police officers related to coping with emergency situations, after the COVID-19 pandemic, is very important. The specification of features, psychological skills or stressors is very useful in the future for the design of training programs for existing police officers and for the recruitment of new police officers.

## Referenca

- Adams, T.M., Anderson, R.L. (2019). Policing in Natural Disasters Stress, Resilience, and the Challenges of Emergency Management, *Temple University*, 10-20.
- Afrin, Sh. (2020). Police Stress in Bangladesh during COVID-19 Pandemic, *Department of Criminology University of Dhaka*, 9-11. [https://www.researchgate.net/publication/347491462\\_Police\\_Stress\\_during\\_COVID-19](https://www.researchgate.net/publication/347491462_Police_Stress_during_COVID-19)
- Adamczyk, K., Walecka, I., Dmochowska, A., Rogula-K.W. (2022). The Level of Fear in the Polish Police Population during the COVID-19 Pandemic with the Impact of Sociodemographic Variables, *Int. J. Environ. Res. Public Health*, 19(15), 6, 8. <https://DOI: 10.3390/ijerph19159679>.
- Adams T, & Turner M (2014). Professional responsibilities versus familial responsibilities: an examination of role conflict among first responders during the Hurricane Katrina disaster. *Journal of Emergency Management*, 12(1), 45-54. doi: 10.5055/jem.2014.0161
- Borovec, K., Delac, F.S., Rosic-J, A. (2021). Impact of Stress Caused by the COVID-19 Pandemic Work and Conduct of Police Officers in Stressful Emergency Situations, *CEPOL, Online Research & Science Conference*, 105-107. <https://doi.org/10.7725/eulerb.v0iSCE%205>.
- Bapna, Dh, Jain, A., Pawar, N., Mital, K.A., Choudhary, P., Jain, R.B., Gupta, R. (2021). Depression, Anxiety and Stress among Police Personnel during COVID-19 Pandemic: A Cross-sectional Study in North India, *Epidemiology International Vol. 6 No. 2*, 10. <https://doi.org/10.24321/2455.7048.202106>.
- Blau, T.H. (1994). Psychological services for law enforcement. *New York: Wiley*, 80-92
- Carlson-J.O., Grant, H., Lavery, F.C. (2020). Caring for the Guardians—Exploring Needed Directions and Best Practices for Police Resilience Practice and Research, *Front. Psychol.* 1-2. <https://doi:10.3389/fpsyg.2020.01874>.
- Drew, M.J., Martin, Sh. (2021). Policing during a global health pandemic: Exploring the stress and well-being of police and their families, *Journal of Community Safety and Well-Being*, Vol 6(3), 106-107. <https://doi.org/10.35502/jcswb.195>.
- De Camargo, C. 'Wait! Don't touch me!'. (2022). Police uniforms, family anxiety, and rituals of purification in the COVID-19 pandemic Camilla De Camargo, Police Practice and Research, *An International Journal*, 139-141 <https://doi.org/10.1080/15614263.2022.2125389>.
- Edwards, A-M., Kotera, Y. (2021). Policing in a Pandemic: a Commentary on Officer Well-being During COVID-19, *J Police Crim Psychol*, 36(3): 360-364. <https://doi: 10.1007/s11896-021-09469-4>.
- Frenkel, M.O., Giessing, L., Egger-L.S., Hutter, V., Oudejans, R.D., Kleygrewe, L., Jaspaert, E., Plessner, H. The impact of the COVID-19 pandemic on European police officers: Stress, demands, and coping resources, *Journal of Criminal Justice*, 5-7. <https://doi: 10.1016/j.jcrimjus.2020.101756>.
- Flavin, J. (1998). Police and HIV/AIDS: The risk, the reality, the response. *American Journal of Criminal Justice*, 23(1), 33-58.
- Huang, W., Bodla, A.A., Chen, Ch. (2021). An Exploratory Study of Police Officers' Perceptions of Health Risk, Work Stress, and Psychological Distress During the COVID-19 Outbreak in China, *Front. Psychol*, 3-4. <https://doi:10.3389/fpsyg.2021.632970>.
- Heyman M., Dill J., Douglas R. (2018). *The Ruderman White Paper on Mental Health and First Responders*. [https://issuu.com/rudermanfoundation/docs/first\\_responder\\_white\\_paper\\_final\\_ac270d530f8bfb](https://issuu.com/rudermanfoundation/docs/first_responder_white_paper_final_ac270d530f8bfb)
- Ismail, Z.S., Rasdi, Zainal, A.E., Mohamed, N. (2022). The Impact of COVID-19 Pandemic On Malaysian Police Officers Mental Health: Depression, Anxiety and Stress, *International Journal of Infectious Diseases* 116, 545. <https://doi.org/10.1016/j.ijid.2021.12.108>.
- Janković, B. (2021). The Role of the Police in Disasters Caused by Pandemic Infectious Diseases, *IJDRM* 4. <https://doi.org/10.18485/ijdr.2021.3.1.4>
- Knabb R.D, Rhome JR, & Brown DP (2011). *Hurricane Katrina: August 23 - 30, 2005 (Tropical Cyclone Report)*. Retrieved from [http://www.nhc.noaa.gov/data/tcr/AL122005\\_Katrina.pdf](http://www.nhc.noaa.gov/data/tcr/AL122005_Katrina.pdf)
- Lazarus, R. S., Folkman, S. (1984). Coping and adaptation, *Encyclopedia of Behavioral Medicine*, 1913-1915.
- Lieberman, H. R., Farina, E. K., Caldwell, J., Williams, K. W., Thompson, L. A., Niro, P.

- J., McClung, J. P. (2016). Cognitive function, stress hormones, heart rate and nutritional status during simulated captivity in military survival training. *Physiology & Behavior*, 165, 86–97. <https://doi.org/10.1016/j.physbeh.2016.06.037>.
- Mohamed, N., Zainal, E.Z, Abidin., Rasdi, I., Ismail, Z.S., Ismail, N.H (2021). Occupational Stressors Experienced by Police Officers During Coronavirus Disease (Covid-19) Outbreak – A Systematic Literature Review, *Malaysian Journal of Medicine and Health Sciences*, 169. <https://doi.org/10.1016/j.ijid.2021.12.108>.
- PRISMA (2021). Prisma Statement. PRISMA Statement. Access in: systematic reviews. *BMC Health Serv Res* 14(1):1–10. <http://www.prisma-statement.org/>
- Rooney, L., McNicholas, F. (2020). Policing' a pandemic: Garda wellbeing and COVID-19, *Ir J Psychol Med*. 2,3. <https://doi.org/10.1017/ipm.2020.70>.
- Rajbhandari, B., Tiwar, B., Gurung, M., Poudel, L., Adhikari, A., Shilpakar, O., Raj Puri, R., Singh, S. (2021). COVID Stress among Nepal Police Officers, *J Nepal Health Res Counc* 19(2), 390-395. <https://DOI:10.33314/jnhrc.v19i2.3672>
- Syed, Sh., Ashwick, R., Schlosser, M., Jones, R., Rowe, S., Billings, J. (2020). Global prevalence and risk factors for mental health problems in police personnel: a systematic review and meta-analysis, 1, *BMJ Journals*, Volume 77, Issue 11. <http://dx.doi.org/10.1136/oemed-2020-106498>
- Szykuła-Piec, B., Piec, R., Zaczyński, A., Wójtowicz, R., Butkiewicz, S., Rusyan, E., Talavera-V.B., Luceño-M.L., García-A.G., Martín-G.J. (2021). Perception of Health, Resilience, and Engagement in Spanish Police Officers During the COVID-19 Pandemic, *Psicothema* Vol. 33, No. 4, 558. <https://DOI:10.7334/psicothema2021.153>.
- Stogner, J., Miller, B. L., & McLean, K. (2020). Police stress, mental health, and resiliency during the COVID-19 pandemic. *American Journal of Criminal Justice*, 1–13. <https://doi.org/10.1007/s12103-020-09548-y>.
- Taubenberger, J.K., Morens, D.M. (2006). 1918 Influenza: the Mother of All Pandemics, *Emerg Infect Dis*, 12(1), 15–16. <https://doi.org/10.3201/eid1201.050979>
- West, Ch., Bernard, B., Mueller, Ch., Kitt, M., Driscoll, R., Tak, S. (2008). Mental Health Outcomes in Police Personnel After Hurricane Katrina, *Volume 50, JOEM, Number 669*. <http://DOI:10.1097/JOM.0b013e3181638685>
- Wollman, D. (1993). Critical incident stress debriefing and crisis groups: A review of the literature. *Group*, 17(2), 70–83. <https://doi.org/10.1007/BF01427816>

**SHKENCAT POLITIKE-JURIDIKE DHE EKONOMIKE**

# The impact of inflation on the economy with a focus on Kosovo

**Prof.ass.dr. Agim Berisha**

Business College, Faculty of Economics, Kosovo  
email: agim.berisha74@hotmail.com

## Abstract

Within the framework of the paper, inflation is treated, including the impact on the consumption of family economies in Kosovo. An important indicator in the economy of a country is inflation. The Covid19 pandemic, among other things, has also affected the economic processes in different countries of the world, as well as having an impact and effects on the economic processes in Kosovo. In addition to inflation or the indicator that measures the cost of living, in this context the consumer price index is used to monitor changes in the cost of living over time. The main goal consists in the analysis of the progress of inflation in Kosovo in recent years. So the purpose of the consumer price index is to measure changes in the cost of living. In the framework of this study, to achieve the objectives, the analysis method, tabular and graphic separately, comparative methods are used, analyzing the dynamics of the issue related to inflation and the impact on the cost of living. Through this study, we consider the results and recommendations given to be taken into consideration by the relevant institutions.

**Key words:** *Inflation, consumer price index, consumption, economic processes*

## Abstrakt

Në kuadër të punimit trajtohet inflacioni përfshirë ndikimin në konsumin e ekonomive familjare në Kosovë. Tregues i rëndësishëm në ekonominë e një vendi është inflacioni. Pandemia Covid19 përveç tjerash ka ndikuar edhe në proceset ekonomike në vende të ndryshme të botës, si dhe duke pasur ndikim dhe efekte edhe në proceset ekonomike në Kosovë. Përveç tjerash inflacioni apo treguesi i cili mat koston e jetesës, në këtë kuadër indeksi i çmimeve të konsumit përdoret për të monitoruar ndryshimet në koston e jetesës me

kalimin e kohës. Qëllimi kryesor konsiston në analizën e ecurisë së inflacionit në Kosovë viteve të fundit. Pra, qëllimi i indeksit të çmimeve të konsumit është të masë ndryshimet në koston e jetesës. Në kuadër të këtij studimi për arritjen e objektivave përdoren kryesisht metoda e analizës, tabelore dhe grafike veçmas, metoda krahasuese, duke analizuar në dinamikë çështjen që lidhen me inflacionin dhe ndikimin në koston e jetesës. Përmes këtij studimi rezultatet dhe rekomandimet e dhëna konsiderojmë të merren në konsideratë nga institucionet përkatëse.

**Fjalët kyçe:** *Inflacioni, indeksi i çmimeve të konsumit, konsumi, proceset ekonomike*

## 1.Hyrje

Inflacioni përbën një sëmundje makroekonomike dhe konsiderohet si një problem shqetësues për ekonominë në tërësi dhe për firmat dhe konsumatorët në veçanti. Një nga treguesit më të njohur dhe që ndiqet me interes nga të gjitha njësitë ekonomike është inflacioni. Inflacioni është një problem serioz që ndikon negativisht si në procesin e riprodhimit ashtu edhe në stabilitetin shoqëror të vendit.

Në literaturën bashkëkohore ekonomike, me inflacion kuptojmë rritjen e çmimeve apo deflatorin e bruto produktit vendor (GDP), apo thënë më mirë zhvlerësimin e vlerës së parasë vendore. Inflacioni përgjithësisht përkufizohet si një rritje e vazhdueshme e nivelit mesatar të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve.(1) Inflacioni është rritja e nivelit të përgjithshëm të çmimeve.(2) Inflacioni paraqet ngritjen e vazhdueshme të nivelit të përgjithshëm të çmimeve.(3) Inflacioni më së shumti godet shtresën e varfër dhe me të ardhura të ulëta të popullsisë. Kjo për

arsye se inflacioni paraqet proces kontinuel të rritjes së çmimeve, përkatësisht rënie permanente të vlerës së parasë dhe të fuqisë blerëse të popullatës. Një definim tjetër thotë: "Inflacioni është rritje permanente e nivelit të përgjithshëm të çmimeve dhe atë në nivelin proporcional të rritjes së nivelit të përgjithshëm të çmimeve në njësi të caktuara të kohës".(4)

Në këtë punim objektivat kryesore konsistojnë në:

- Analizën e ecurisë së inflacionit në Republikën e Kosovës viteve të fundit.
- Të analizojë ecurinë e inflacionit në koston e jetesës viteve të fundit.

## 2. Metodologjia e përdorur

Për finalizimin e këtij punimi, materiali i paraqitur ka mbështetje përfshirë literaturën shkencore, si dhe raporte e publikime nga Banka Qendrore e Kosovës, ku trajtohen çështje të lidhura me inflacionin, përkatësisht ndikimin e inflacionit në ekonomi në Kosovë. Po ashtu është përdorur burimi statistikor vendas, metoda e analizës dhe sintezës, tabelore dhe grafike veçmas, metoda krahasuese, etj.

## 3. Rishikimi i literaturës

Konsumi përbën totalin e shpenzimeve që kryejnë ekonomitë familjare dhe individët për mallra dhe shërbime të vendit. Për çdo vend, konsumi është komponenti më i madh i GDP. Statistikat tregojnë se familjet e varfëra shpenzojnë pjesën më të madhe të të ardhurave të tyre për të mirat me rëndësi jetike, si ushqim dhe strehim.(5) Konsumi përfaqëson shpenzimet e konsumatorëve për mallra dhe shërbime, prej të cilave nxirret dobi në periudhën aktuale.(6) Konsumi është shpenzimi për mallra dhe shërbime nga familjet.(7)

Indeksi i çmimeve të konsumatorit (CPI) është treguesi që përdoret më gjerësisht për matjen e inflacionit. Indeksi i çmimeve të konsumatorit është indeksi më i nohur i çmimeve. Ai mat ndryshimin në kohë të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përfshira në shportën e tregut.(8) CPI mat koston e një shporte tregu mallrash dhe shërbimesh që konsumohen nga një familje tipike qytetare gjatë një periudhe të caktuar kohore. Indeksi i çmimeve të konsumit (CPI) është një tregues i koston së përgjithshme të mallrave dhe shërbimeve të blera nga një konsumator tipik. Indeksi i çmimeve të konsumit (CPI) një tregues i koston së përgjithshme të mallrave dhe shërbimeve të blera nga një konsumator tipik.(9) Në përlllogaritjen e CPI mbahen parasysh edhe

peshat specifike të çdo malli apo shërbimi në buxhetin e shpenzimeve të konsumatorit. Qëllimi i indeksit të çmimeve të konsumit është të masë ndryshimet në koston e jetesës. Me fjalë të tjera, indeksi i çmimeve të konsumit përpiket të njehsojë sesa shumë të ardhura duhet të rriten në mënyrë që të ruhet një standard i pandryshuar i jetesës.

## 4. Rezultate dhe diskutime

### Indeksi i çmimeve të konsumit në Kosovë

Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK) është indeksi më i njohur i çmimeve. Ai mat ndryshimin në kohë të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përfshira në shportën e tregut.(10) Qëllimi i indeksit të çmimeve të konsumit është të masë ndryshimet në koston e jetesës.(11) Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK) mat koston gjithsej të shportes së tregut. Eurostat-i e ka definuar IHÇK si standard Evropian për indekset e çmimeve të konsumit.(12) Në Kosovë, Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK), përkatësisht indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit (IHÇK) përdoret si matës zyrtar i inflacionit. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), përkatësisht Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) është publikuar si indeks mesatar vjetor duke filluar nga viti 2002. Indeksi i çmimeve të konsumit, dhe indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit llogariten në bazë të një strukture të klasifikimit COICOP (Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit), i përputhshëm plotësisht me strukturën e shpenzimeve që përdor Eurostat-i.(13) Bazuar në këtë klasifikim, shpenzimet janë klasifikuar në 12 grupe kryesore si:(14)

- Ushqimi dhe pije joalkoolike;
- Pije alkoolike dhe duhan;
- Veshje dhe këpucë;
- Strehimi, ujë, rryma, gazi dhe lëndë djegëse, të tjera;
- Orenditë, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë;
- Shëndetësia;
- Transporti;
- Mjetet e komunikimit;
- Rekracioni dhe kultura;
- Arsimi;
- Hotele, kafe dhe restorante;
- Mallrat dhe shërbimet e ndryshme.

Eurostat-i e ka definuar IHÇK-në si standard evropian për indekset e çmimeve të konsumit. Të dhënat për çmimet e mallrave dhe shërbimeve më reprezentuese grumbullohen përmes pyetësorit të Indeksit të çmimeve të konsumit, dhe indeksit të harmonizuar të

çmimeve të konsumit nga stafi i zyrave rajonale në qendrat kryesore të vendit: Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë dhe Ferizaj.

Monitorohen 415 produkte mbi 6800 çmime në supermarkete, ndërmarrje shërbyese, dyqane, tregje dhe pika të tjera të shitjes me pakicë.(15)

Tabela 1: Indeksi i çmimeve të konsumit në periudhën 2015-2022

| Vitet       | Indeksi mesatar vjetor i çmimeve (2015=100) | Ndryshimi vjetor në % |
|-------------|---------------------------------------------|-----------------------|
| 2015        | 100.0                                       | -0.5                  |
| 2016        | 100.3                                       | 0.3                   |
| 2017        | 101.8                                       | 1.5                   |
| 2018        | 102.8                                       | 1.1                   |
| 2019        | 105.6                                       | 2.7                   |
| 2020        | 105.8                                       | 0.2                   |
| 2021        | 109.3                                       | 3.4                   |
| Nëntor 2022 | 125.8                                       | 11.6                  |

Burimi:Agjencia e Statistikave e Kosovës, Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit, Prishtinë, Dhjetor, 2022, fq,5-7.




Figura 1: Indeksi i harmonizuar vjetor i çmimeve të konsumit sipas viteve 2015-2022




Figura 2: Normat mesatare vjetore të inflacionit të matura nga IHÇK-it për periudhën 2015-2022

Nga tabela dhe grafiku shihet se, norma mesatare vjetore e inflacionit gjatë periudhës 2015-2022 kishte ecuri të rritjes veqmas trendi i rritjes më të theksuar vërehet në vitin 2022. Kështu që norma e inflacionit në vitin 2015 ishte -0.5% krahasuar me vitin paraprak, ndërsa në vitin 2016 norma e inflacionit ishte 0.3%, në vitin 2017 ishte 1.5%, në vitin 2018 ishte 1.1%, në vitin 2019 ishte 2.7%, duke pasur ecuri të

rënies në vitin 2020 në kohë të pandemisë Covid19, ku norma e inflacionit ishte 0.2%, ndërsa duke pasur ecuri të rritjes në vitin 2021 në 3.4%, ndërsa në Nëntor 2022 norma e inflacionit arrin në 11.6%.

Në tabelën në vijim paraqiten ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve për grupe dhe nëngrupe të mallrave dhe shërbimeve të konsumit.

Tabela 2: Peshat, IHÇK-it për muajin Nëntor 2022 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve për grupe dhe nëngrupe sipas COICOP-it

-në përqindje

| Grupet                                                            | XI-2022<br>2015=100 | XI-2022<br>X-2022 | XI-2022<br>XI-2021 |
|-------------------------------------------------------------------|---------------------|-------------------|--------------------|
| Gjithsej IHÇK                                                     | 125.8               | 0.3               | 11.6               |
| Ushqimi dhe pije joalkoolike                                      | 137.9               | 0.6               | 17.9               |
| -Ushqimi                                                          | 141.2               | 0.6               | 19.5               |
| -Pijet joalkoolike                                                | 121.3               | 0.8               | 8.5                |
| Pije alkoolike dhe duhani                                         | 129.4               | -0.4              | 6.1                |
| Veshje dhe këpucë                                                 | 101.6               | -2.6              | 0.6                |
| Strehimi, uji, energji elektrike, gazi dhe lëndë djegëse të tjera | 119.2               | 0.7               | 13.5               |
| Energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera                 | 122.5               | 0.7               | 16.8               |
| Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë               | 114.8               | 0.5               | 9.1                |
| Shëndetësia                                                       | 112.6               | 0.2               | 2.2                |
| Transporti                                                        | 140.2               | 0.0               | 17.4               |
| Mjetet e komunikimit                                              | 115.1               | 0.1               | 0.1                |
| Rekracioni dhe kultura                                            | 100.9               | 0.3               | 3.1                |
| Arsimi                                                            | 102.4               | 0.0               | 0.7                |
| Restorantet dhe hotelet                                           | 124.3               | 0.1               | 10.9               |
| Mallrat dhe shërbimet e ndryshme                                  | 115.2               | 0.5               | 5.1                |

Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit, Prishtinë, Dhjetor, 2022, fq. 9-10.




Figura 3: Peshat, IHÇK-it për muajin Nëntor 2022 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve për grupe dhe nëngrupe sipas COICOP-it.

Nga tabela dhe grafiku shihet ecuria e ngritjes së çmimeve të konsumit ku vërehet se

ka një ecuri të ngritjes së çmimeve të konsumit në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021.

Tabela 3: Çmimet mesatare për disa artikujt dhe shërbime të konsumit

-në euro

| Kodi | Artikujt                | Njësia matëse | XI 2021 | X 2022 | XI 2022 |
|------|-------------------------|---------------|---------|--------|---------|
| 101  | Oriz                    | 1 kg          | 1.44    | 1.54   | 1.57    |
| 102  | Miell gruri             | 1 kg          | 0.64    | 0.82   | 0.82    |
| 103  | Bukë e bardhë           | 500 gr        | 0.42    | 0.51   | 0.51    |
| 111  | Mish gjedhi pa eshtra   | 1 kg          | 6.91    | 8.63   | 8.84    |
| 112  | Mish viçi               | 1 kg          | 7.94    | 9.69   | 9.77    |
| 114  | Mish pule               | 1 kg          | 2.86    | 4.04   | 4.13    |
| 131  | Qumësht (tetrapak)      | 1 lit         | 0.93    | 1.20   | 1.23    |
| 133  | Jogurt                  | 1 lit         | 0.93    | 1.15   | 1.19    |
| 137  | Vezë                    | 30 copë       | 3.09    | 3.84   | 3.92    |
| 141  | Vaj ushqimor luledielli | 1 lit         | 1.64    | 2.41   | 2.30    |
| 151  | Mollë                   | 1 kg          | 0.67    | 0.81   | 0.72    |
| 152  | Dardhë                  | 1 kg          | 1.42    | 1.51   | 1.51    |
| 153  | Banane                  | 1 kg          | 1.15    | 1.57   | 1.61    |
| 155  | Limon                   | 1 kg          | 1.05    | 1.74   | 1.53    |
| 161  | Patate                  | 1 kg          | 0.62    | 0.63   | 0.64    |
| 162  | Domate                  | 1 kg          | 0.92    | 1.18   | 1.25    |
| 163  | Fasule                  | 1 kg          | 2.65    | 2.97   | 3.08    |

|       |                                     |                  |       |       |       |
|-------|-------------------------------------|------------------|-------|-------|-------|
| 167   | Speca të pa djegës                  | 1 kg             | 1.16  | 1.51  | 1.63  |
| 175   | Sheqer                              | 1 kg             | 0.86  | 1.16  | 1.18  |
| 192   | Kafe e bluar                        | 1 kg             | 10.66 | 11.78 | 11.78 |
| 193   | Çaj                                 | 1 kg             | 7.86  | 8.89  | 9.25  |
| 195/1 | Uji natyral pa gaz                  | 1.5 lit          | 0.30  | 0.33  | 0.33  |
| 196   | Coca cola                           | 2 lit            | 1.30  | 1.35  | 1.37  |
| 197   | Lëng pemësh                         | 1 lit            | 0.90  | 0.98  | 1.02  |
| 204   | Birrë                               | 0.5 lit          | 0.66  | 0.74  | 0.73  |
| 216   | Cigare-Ronson                       | 1 pako           | 1.78  | 1.94  | 1.94  |
| 217   | Cigare-Malboro                      | 1 pako           | 2.80  | 2.89  | 2.89  |
| 416   | Energjia elektrike (pa kosto fikse) | 1 këh            | 0.06  | 0.06  | 0.06  |
| 418   | Dru zjarri                          | 1 m <sup>3</sup> | 45.67 | 63.25 | 61.10 |
| 701   | Benzin                              | 1 lit            | 1.28  | 1.39  | 1.45  |
| 702   | Dizel                               | 1 lit            | 1.25  | 1.72  | 1.65  |

Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit, Prishtinë, Dhjetor, 2022, fq, 11.




Figura 4: Çmimet mesatare për disa artikuj dhe shërbime të konsumit

Nga tabela pasqyrohet ecuria e çmimeve mesatare për disa artikuj dhe shërbime të përfshira në indeksin e çmimeve të konsumit për periudhën Nëntor 2021 dhe krahasuar me Nëntor 2022, shprehur në euro, ku vërehet një ecuri në rritje të çmimeve të konsumit në Kosovë.

Rritja ekonomike konsiderohet një nga objektivat kryesore makroekonomike. Kjo për faktin se rritja ekonomike lidhet ngushtë me standardin e jetesës së popullësisë së një vendi. Rritja e standardit të jetesës së popullësisë vjen si rezultat i rritjes së prodhimit të mallrave dhe shërbimeve. Tregues i rëndësishëm i standardit të jetesës së popullësisë merret prodhimi për frymë i popullësisë.

Përmirësimi i standardit të jetesës së popullësisë së një vendi vjen atëherë kur çdo

individë me kalimin e kohës ka në dispozicion të tij më shumë mallra dhe shërbime për të konsumuar se më parë. Një nga treguesit më të njohur dhe që ndiqet me interes nga të gjitha njësitet ekonomike është inflacioni. Inflacioni është një problem serioz që ndikon negativisht si në procesin e riprodhimit ashtu edhe në stabilitetin shoqëror të vendit. Inflacioni si dukuri makroekonomike prek pothuajse të gjitha shtresat e popullësisë, domethënë këdo që blen ose shet mallra dhe shërbime. Shporta e konsumatorit kosovar karakterizohet me pjesëmarrje mjaft të lartë të produkteve të cilat kanë lëvizje sezonale të çmimeve. Këtu përfshihen ushqimi, energjia, pijet alkoolike dhe duhani të cilat përbëjnë rreth gjysmën e shportës së konsumatorit. Çmimet e këtyre produkteve kanë determinuar lëvizjen e indeksit të përgjithshëm të çmimeve gjatë viteve të kaluara jo vetëm për shkak të pjesëmarrjes së

lartë që e kanë në shportën e konsumit por edhe për shkak se lëvizja e këtyre çmimeve ka qenë më e theksuar. Inflacioni bazë, i cili përjashton kategoritë të cilat karakterizohen me ndryshim më të theksuar të çmimeve, paraqet një pasqyrë më të qartë lidhur me inflacionin në Kosovë.

Me qenë se ekonomia e Kosovës është ekonomi e vogël dhe e varur nga importi, është e natyrshme që komponentët e tregtueshëm të mallrave dhe shërbimeve të kenë një pjesëmarrje të lartë në IÇK dhe, rrjedhimisht, të përcaktojnë lëvizjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Komponentët e tregtueshëm përbëjnë rreth 81.9 përqind të shportës së konsumatorit kosovar, ndërsa komponentët e pa tregtueshëm (kryesisht shërbimet) përbëjnë rreth 18.1 përqind të shportës së konsumatorit. Çmimet e mallrave dhe shërbimeve të patregtueshme historikisht kanë qenë më stabile krahasuar me çmimet e mallrave të tregtueshme, me përjashtim të dy viteve të fundit ku rënia e çmimeve të mallrave të patregtueshme ishte më e theksuar.

Çdo inflacion i cili kalon shkallen e rritjes më shumë se 3%, atëherë kalon në nivele ku duhet të mbikqyret situata e krijuar për shkak se mund të kalojë në nivele të frikshme të cilat mund ta rrënojnë ekonominë e vendit. Zakonisht për të llogaritur nivelin e çmimeve ekonomistët fillojnë me konceptin e shportës së konsumatorit (që ka disa produkte të zakonshme). Në koston e jetës drejtpërsëdrejti ndikon rritja e çmimeve dhe lidhur me këtë konsumatori ka tendencë që të blejë më pak dhe gjithnjë mundohet që të gjejë produkte zëvendësuese.

### 5.Konkluzione dhe rekomandime

Pra, madhësit globale makroekonomike janë madhësi shumë të rëndësishme, që japin pasqyrime mbi zhvillimet ekonomike të një vendi. Këto madhësi përdoren për të gjetur statistika ekonomike për të analizuar edhe zhvillimet ekonomike brenda disa vendeve në regjion, apo edhe më tej. Inflacioni paraqet rritjen e vazhdueshme të çmimeve të përgjithshme, ku me një sasi të caktuar të parave mund të blihen më pak prodhime se para zhvlefësimit. Inflacioni tregon një rënie të fuqisë blerëse të një ekonomie nacionale, një reduktim të prodhimit të brendshëm dhe një dominim të indikatorëve të jashtëm makroekonomik, që në rastin e Kosovës që nga periudha e pasluftës së vitit 1999, indikator kryesor është importi që godet pamëshirshëm ekonominë e Kosovës në mungesë të kapaciteteve prodhuese vendore. Inflacioni

godet të gjitha shtresat, por më së shumti ato familje ku të ardhurat mujore janë të pakta apo jetojnë me ndihmë sociale. Për inflacionin thuhet se e favorizon në përgjithësi konsumin por në të kundërtën e këtij favorizimi e zvogëlon kursimin e madje shfrytëzon dhe shpenzon edhe kursimet e mëhershme. Arsye e kësaj është sepse humbet besimi në para (stabilitetin e saj) dhe çdo kush dëshiron të lirohet nga paratë për të blerë edhe ato mallra për të cilat ndoshta nuk ka nevojë.

Në përgjithësi inflacioni në Kosovë viteve të mëparshme ishte në suaza normale, që do të thotë nën 2 për qind në baza vjetore, ndërsa në vitin 2021 me tendencë të rritjes më të theksuar, veçmas në vitin 2022 duke arritur inflacionin me normë dy shifrore. Duhet pasur parasysh lidhur me një qeverisje të kujdesshme makroekonomike sa i përket inflacionit, në të kundërtën situata mund të del jashtë kontrollit. Lidhur me këtë, duhet ndërmerren veprime dhe masa të politikës fiskale (ulja e normave tatimore (TVSH), lehtësi tatimore) në mallrat dhe shërbimet e domosdoshme për jetë duke ndikuar në uljen e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të shportës së konsumit.

### References

- (1) Dr.Drini Salko dhe Dr.Ofrea Dhuci, *Paraja dhe institucionet financiare, Tiranë 2005, fq. 22.*
- (2) Dr.Mimoza Koka, *Makroekonomia, Tiranë, 2014, fq. 198.*
- (3) Dr. Musa Limani, *Makroekonomia, Prishtinë, 2013, fq. 145.*
- (4) David Begg, Stanley Fischer and Rodiger Dornbasch, *Economics, 2000, fq. 70.*
- (5) Dr.Ahmet Manqellari, Dr.Sulo Haderi, Dr.Dhori Kule, Dr.Stefan Qirici, *Hyrje në Ekonomi, Tiranë, 2007, fq. 282.*
- (6) Dr. Mimoza Koka, *Makroekonomia, Tiranë, 2014, fq. 11.*
- (7) N.Gregory Mankiw dhe Mark P. Taylor, *Ekonomiksi/Makroekonomia, Përktheu: Artan Meci, Jorgji Qirjako, Tiranë, 2012, fq. 43.*
- (8) Dr.Drini Salko dhe Dr.Ofrea Dhuci, *Paraja dhe institucionet financiare, Tiranë, 2005, fq. 19.*
- (9) N. Gregory Mankiw dhe Mark P. Taylor, *Economics/ Makroekonomia, Përktheu: Artan Meci dhe Jorgji Qirjako, Tiranë, 2012, fq. 62.*
- (10) Dr.Drini Salko, Dr.Ofrea Dhuci, *Paraja dhe institucionet financiare, Tiranë, 2005, fq. 19.*
- (11) Dr.Agim Berisha, *Financa, Prishtinë, 2022, fq.66.*

- (12) *Agjencia e Statistikave e Kosovës, Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit, Prishtinë, 2022, fq,12.*
- (13) *Agjencia e Statistikave të Kosovës, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2021, Prishtinë, 2021, fq, 270.*
- (14) *Agjencia e Statistikave të Kosovës, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2021, Prishtinë, 2021, fq, 270.*
- (15) *Agjencia e Statistikave të Kosovës, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2021, Prishtinë, 2021, fq, 270.*

# Mbrojtja juridiko penale e gruas në marrdhënien familjare

## Phd. Linert Lirëza

Head of Law Department, Lecturer, "Aleksandër Moisiu" University, Durrës, Albania  
Nr.14,2001, Rruga Currila, Durrës, Albania  
linert\_lireza@yahoo.com

## Prof.Asoc. Gentina Kraja

Lecturer, Faculty of Political Sciences and Law, "Aleksandër Moisiu" University, Durrës, Albania  
Nr. 14,2001, Rruga Currila, Durrës, Albania  
gentianakraja@yahoo.com

### Abstrakt

Ne kulturën e patriarkise, vepronte supozimi teologjik që burri dhe gruaja ishin "një trup" përpara Zotit. Në këtë kuptim, ata ishin "një person" dhe se ai "një person" ishte bashkëshorti, duke i përcaktuar si "një unitet juridik". Artikulli synon të paraqes, fazat e zhvillimit normativ të mbrojtjes të gruas në konkestin e marrdhënies familjare. Standartet ndërkombëtare të adopuar nga legjislacioni i brëndshëm shqipëtar dhe rezultatete e përfutur në mbrojtjen e këtij grupi social. Nga ana tjetër, zhvillohet një analizë kritike, për dhunën mbi bazë gjinore dhe impakti që ka në marrdhënien familjare. Në

### 1. Stadet e zhvillimit të mendimit juridik mbi gjëndjen juridike të gruas në marrdhënien bashkëshortore

Në shekullin e 11-të dhe 12-të në Angli, konfirmohej fakti sipas të cilit, ligji është ndërthurje e teologjisë me shkencën. Kultura diktonte patriarkinë ndërsa patriarkia nënshtronte gratë. Bashkëshortet trajtoheshin shpesh si pronë në varësi prirjeve të bashkëshortit. Ky fakt analizohej gjerësisht nga eksperti juridik i shekullit të 18-të Eëlliam Blackstone në Doktrinën e 'mburojës' e të Drejtës Zakonore. Në doktrinën e tij reflektonte supozimin teologjik që burri dhe gruaja ishin "një trup" përpara Zotit. Nga ky supozim derivonte

interpretimin që i është bërë veprës penale të dhunës në marrdhëniet familjare, punimi ka si qëllim të të nxjerr në pah trajtimin e posacëm që i bën ligji penal gruas (bashkëshortes apo bashkëjetueses) dhe klauzolat penale përjashtuese e rënduese, në ndryshim nga veprat e tjera penale. Sikundër, analizohen aspekte procedurale penale për garantimin e të dhunuarës për të ndjekur e qetë procedurën për lëshimin e urdhërit të mbrojtjes.

**Fjalë kyce:** *dhuna, marrdhënie bashkëshortore, familja, mbrojtja penale, gruaja, bazë gjinore*

fakti se këta subjekte ishin "një person" dhe se ai "person" ishte bashkëshorti. Duke u përcaktuar si "një unitet juridik" e duke u identifikuar me bashkëshortin, e Drejta Zakonore kërkonte që një grua e martuar të atashohej pranë bashkëshortit në të gjitha veprimet juridike apo në pozitën procedurale në një proces gjyqësor.

Gjithashtu, patriarkia proklamonte të drejtën për të ndëshkuar bashkëshorten fizikisht ose verbalisht, në kushtet kur bashkëshorti vlerësonte se ishte e nevojshme. Nga ana tjetër, bashkëshortja nuk mundej që të kundërshtonte vullnetin e bashkëshortit. Në rastet që shprehte një vullnet të ndryshëm nga i bashkëshortit, do të konsiderohej si "vërejtje apo fyerje ndaj tij" dhe për pasojë do të ndëshkohej. Madje disa teoricien shkonin edhe më tej, në analizat e tyre citonin

proverbën e vjetër angleze, sipas të cilës: "Një spaniel (qen), një grua dhe një dru arre, sa më shumë të rrihen, aq më të mirë do të bëhen."<sup>1</sup>

Në këtë kontekst, roli i burrit në shoqëri ishte të sundonte në sferën publike. Rrjedhimisht i jepte të drejtën të ishte sundues i banesës bashkëshortore, dhe të kishte fuqinë të mbizotëronte. Ndëshkimi fizik i bashkëshortes, konsiderohej si një detyrë e domosdoshme, e pranuar shoqërisht në rrethet e meshkujve.<sup>2</sup> Ky arsyetim lidhej me ndëshkimin e Evës, për mosbindjen ndaj Jehua, duke ngrënë frutin dhe "Joshur" Adamin për ta bërë pjesë të mëkatit të saj. Shtresat që ndiqnin moralin nga *Predikimet* besonin se "nga një grua ishte fillimi i mëkatit, për shkak të saj ne të gjithë vdiqëm." Ndëshkimi i Evës nga Zoti, synonte edukimin që ti bindej bashkëshortit të saj.

Nga shekujt 16-18, Gjykata Mbikëqyrëse e Londrës, në vendimarrjet e saj, pasqyron se e drejta për të ndëshkuar bashkëshorten shpesh transformohej në rrahjen e bashkëshortes. Ruajtja e rregullit në familje, ishte e përshkuar nga një marrëdhënie me karakteristike dominuese dhe nënshtruese aq sa brutaliteti ishte i zakonshëm. Shumë gra vuanin në heshtje, të frikësuara se do të ndëshkoheshin si p.sh. me vënien e një kapistre në kokë. Kapistra ishte një kafaz i hekurt, e cila vendosej në kokë, shpesh me një ushtë, ose një rrotull me gjemba që vendosej në gojën e "fajtores", kështu që gjuha do të gozhdohej. Gratë që nuk i bindeshin bashkëshortëve të tyre do të ndëshkoheshin me kapistër, do të parakalonin përgjatë fshatit dhe nuk do të liroheshin derisa të pendoheshin. Në disa raste, një bashkëshort mund të kërkonte që roja i burgut të sillte kapistrën në shtëpi, të cilën e varte në një çengel, duke e kërcënuar bashkëshorten të rrinte e nënshtruar. Ky është një shembull i mënyrës sesi shteti bashkëpunonte për mbizotërimin patriarkal të bashkëshortit.<sup>3</sup>

Nga ana tjetër, në kulturën patriarkale, ishte më e lehtë për një burrë të fitonte pafajësinë nëse ai argumentonte se kapja e bashkëshortes në akt tradhtie kishte dëmtuar nderin e tij. Burri do të

pretendonte se vrasja e bashkëshortes së tij ishte pasojë e një reagimi të natyrshëm. Megjithatë, edhe nëse krimi ishte i paramenduar, burrat mund të liroheshin. Arsyetimi qëndronte në faktin se përderisa natyra e tij është e nxehtë, dhuna do të mund të pasonte qoftë edhe në paramendim. Ndërkohë që, për gruan zbatohej një standard i ndryshëm. Autoritetet nuk e konsideronin tradhtinë e një mashkulli, shkak të justifikuar për gruan, për të vrarë bashkëshortin e saj. Gratë ishin të ftohta dhe kësaj nuk pritej të vepronin me pasion. Vetëm në kushte specifike, gruaja përjashtohej nga përgjegjësia juridiko penale sic është rasti i vrasjes në kushtet e mbrojtjes së nevojshme. Sërish, edhe në këtë rast, gruaja duhej të ishte e kujdesshme me mënyrën se si i tregonte rrethanat e ngjarjes. Së pari, pamja e saj duhej të ngjallë simpati. Gruaja duhej të shfaqte një qëndrim përulës, si lutëse.<sup>4</sup> Në deklarinimin përpara gjykatës, gruaja duhej të siguronte një shpjegim bindës mbi mizorinë që kishte pësuar gjatë jetesës bashkëshortore. Më tej, i duhej të përshkruante momentin e humbjes së arsyes, kur, për shkak të kushteve të vetëmbrojtjes, kishte konsumuar vrasjen.

Një tjetër element përbërës i marrëdhënies burrë-grua, ishte dakordësia kulturore mes njerëzve të mjekësisë dhe atyre të fesë që martesë sillte "një borxh (detyrim) martesor, dhe marrëdhënia seksuale bashkëshortore qëndronte në thelb, me dhunë apo pa dhunë. Në këto kushte, 'përdhunimi në martesë' nuk ishte pjesë e fjalorit të krishterë."<sup>5</sup>

Studiuesit juristë të shekullit të 20-të, kanë ngritur një pretendim që: "Shumica e grave në një farë pike bluajnë në mendje fantazi kalimtare të përdhunimit."

Të tjerë studjues përgjatë viteve 1950-të dhe 1960-të pretendonin se ishte një praktikë e pranuar për një grua që të mohonte që ajo dëshironte marrëdhënie, kur ajo me të vërtetë e dëshironte atë. Sondazhet mbi përdhunimin të kryera në vitet 1970-të dhe 1980-të, raportonin që dy të tretat e atyre që u nënshtruan sondimit, u përgjigjën se, besonin se gratë e inkurajonin përdhunuesin me pamjen e tyre, dhe ato që ishin

<sup>1</sup> Anthony Fletcher, *Gender, Sex and Subordination*, Yale University Press, 1995, fq.192. Kjo ishte gjithashtu e vërtetë dhe për jehudët. "Gjerësisht mbështetej që nuset – të cilat mund të ishin shumë të reja – duhej të ndëshkoheshin nga bashkëshortët e tyre; rabinjtë dhe statujat publike mund të jenë kundër dhunës, por jo kundër një rrahjeje të mirë, që do të risillte në vend rendin familjar."

<sup>2</sup> Carol Meyers, *Discovering Eve*, (Duke Zbuluar Evën), Oxford University Press, 1988, fq. 72.

<sup>3</sup> Fletcher, fq.197

<sup>4</sup> Natalie Zemon Davis, *Fiction in the Archives, Pardon Tales and their Tellers in Sixteenth-century France* (Trillimi në Arkiva, Rrëfimet e Faljes dhe Rrëfyesit e tyre në Francën e Shekullit të 16-të. (Stanford U. Press, 1987), faqe 93-95

<sup>5</sup> Rachel Biale, *Women and Jewish Law, An Exploration of Women's Issues in Halakhic Sources*, New York, 1984, fq. 6-8).

viktima ose ishin të shthurura ose kishin reputacion 'të keq'.<sup>6</sup>

Në vitin 1978, Shteti i Nju Jorkut sanksionoi me mënyrë taksative dënueshmërinë e marrëdhënies seksuale me dhunë, pavarësisht se dhunuesi dhe viktima gëzojnë njëkohësisht statusin e bashkëshortëve. Kjo dispozitë nuk buroi ekskluzivisht nga shteti i Nju Jorkut por ishte një paradigmë të re kulturore që filloi të zhvillohej gjatë shekullit të 18-të.

## 2. Standardet juridike ndërkombëtare në mbrojtjen juridike të gruas

Standardet ligjore ndërkombëtare e përcaktojnë qartë dhunën ndaj gruas në marrëdhënien familjare, si dhunim i të drejtave dhe lirive themelore, të garantuara nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut<sup>7</sup>, respektivisht:

"Çdo individ gëzon të drejtën e rendit shoqëror dhe ndërkombëtar, në të cilin të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë deklaratë mund të realizohen plotësisht."<sup>8</sup> Shumica e dispozitave të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut janë bërë detyruese, si pjesë e së drejtës. Shumë vende kanë integruar të drejtat njerëzore të sipërpërmendura në dispozitat e tyre kushtetuese, duke garantuar kështu lirinë e individëve pavarësisht nga gjinia apo mosha e tyre.

Normat dhe direktivat ndërkombëtare në lidhje me dhunën në familje, ekzistojnë në tri nivele të ndryshme:

- Kombet e Bashkuara (KB),
- Këshilli i Evropës (KE)
- Bashkimi Evropian (BE).

### a) Standardet e përcaktuara nga Kombet e Bashkuara.

Dokumentet e Kombeve të Bashkuara e konsiderojnë dhunën në familje, si dhunim i të drejtave njerëzore sipas së drejtës ndërkombëtare dhe formë e diskriminimit kundër grave, por edhe si përgjegjësi enjë shteti për aktet të dhunës kundër tyre. Këto dokumente janë të natyrave të ndryshëm dhe për pasojë edhe fuqia e tyre ndryshon nga detyruese në jo detyruese.<sup>9</sup> Megjithatë, pavarësisht nivelit

të tyre detyrues, koleksioni i dokumenteve të Kombeve të Bashkuara, ka ndikuar fuqishëm në zgjerimin e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e grave.

Ndër normat detyruese ligjore të Kombeve të Bashkuara janë:

- a) Konventa e OKB-së për të Drejtat Civile dhe Politike (ratifikuar më 4 tetor 1991);
- b) Konventa e OKB-së kundër Torturës dhe Dënimeve ose Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose --- Degraduese (ratifikuar më 11 maj 1994);
- c) Konventa e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, CEDAË (e ratifikuar më 11 maj 1994); Ndërkohë që Konventa hyri në fuqi më shpejt se çdo konventë tjetër e miratuar nga Kombet e Bashkuara, kjo konventë është njëkohësisht edhe konventa së cilës iu shtuan më shumë rezerva; do të thotë që shtetet palë kanë rezervuar të drejtën të mos respektojnë një ose më shumë dispozita të konventës. disa shtete vendosën rezerva për nenin 2 (i cili dënon diskriminimin), megjithëse kushtetutat apo ligjet e tyre vendase e ndalojnë diskriminimin.

Një nga normat e politikës së Kombeve të Bashkuara: Deklarata "Për eliminimin e dhunës kundër grave" është *Deklarata "Për eliminimin e dhunës kundër grave" (DVAW), miratuar në vitin 1993*, e përcakton kështu dhunën ndaj gruas: "Dhunë ndaj grave është dhuna me bazë gjinore që sjell ose mund të sjellë si pasojë dëmtimin ose vuajtjen fizike, seksuale apo psikologjike të gruas, përfshi edhe kërcënimet për kryerjen e veprave të tilla, shtrëngimin ose privimin arbitrar të lirive, që ndodhin si në jetën publike ashtu dhe në jetën private". Megjithëse deklarata nuk ka statusin e një konvente dhe si e tillë nuk është e detyrueshme për shtetet, është një akt promovues që paraqet pikëpamjet e të gjithë shteteve anëtarë të Kombeve të Bashkuara. Gjithashtu vlerësohet si një mjet i dobishëm për cilindo shtet, i cili kërkon të trajtojë çështjen e dhunës ndaj gruas në marrëdhënien familjare.

<sup>6</sup> Daphne Merkin, "The Last Taboo" (Tabuja e Fundit) *N.Y. Times Magazine*, Dhjetor 3, 2000, fq.117-8

<sup>7</sup> Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (UDHR), miratuar dhe shpallur nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 217A(III) e 10 dhjetorit 1948 neni 26

<sup>8</sup> Po aty neni 28

<sup>9</sup> Vesna Nikolić-Ristanović Mirjana Dokmanović International Standards on Domestic Violence and Their Implementation in the Western Balkans, Belgrade, 2006, faqe 54

Deklarata pranon se dhuna me bazë gjinore mund të ndodhë në familje. DVAW specifikon veprimet që duhet të ndërmerren një shtet për të eliminuar dhunën në familje, duke filluar nga nevoja: të hartojë legjislacionin e duhur penal; të zhvillojë plane kombëtare të veprimit për të eliminuar dhunën kundër grave, në bazë të burimeve që disponon; të sigurojë shërbime sociale për gratë-viktima të dhunës; të marrë masa për të siguruar trajnimin e zyrtarëve publikë të cilëve u është besuar zbatimi i ligjeve, për t'i bërë ata të ndjeshëm ndaj nevojave të grave; të sigurojë që në buxhetin e qeverisë të caktohen burime të mjaftueshme për të luftuar dhunën në familje. DVAË bën të qartë se veprimi i shteteve palë duhet të matet kundrejt standardeve ndërkombëtare që artikulojnë qartë një strategji për eliminimin e dhunës kundër grave në familje.

*Strategjitë tip* – Në vitin 1997, Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe për drejtësinë Penale, në sesionin e tij të gjashtë në Vjenë, mori masa për të zbatuar Programin e Veprimit të Pekinit brenda fushës së vet të kompetencës dhe miratoi *Strategjitë tip dhe masat praktike për eliminimin e dhunës ndaj grave në fushën e parandalimit të krimit dhe në fushën e drejtësisë penale* (Strategjitë tip). Më vonë këto strategji u miratuan nga Asambleja e Përgjithshme si "Rezoluta mbi masat për parandalimin e krimit dhe për drejtësinë penale për të eliminuar dhunën ndaj grave".<sup>10</sup> Strategjitë tip janë një sërë strategjish dhe masash të njohura ndërkombëtarisht në fushën e drejtësisë penale për të trajtuar dhunën ndaj grave në të gjitha format e saj.<sup>11</sup> Në bazë të këtyre strategjive, një numër organizmash ndërkombëtare në fushën e drejtësisë penale kanë hartuar Manualin e Burimeve, i cili ofron informacion të përmbledhur mbi përvojën e disa vendeve që kanë zbatuar me sukses Strategjitë tip.<sup>12</sup> Në shkurt të vitit 2006, Parlamenti Evropian miratoi gjithashtu edhe rezolutën mbi *Situatën aktuale në luftën kundër dhunës ndaj grave dhe veprimet në të ardhmen*.<sup>13</sup> Ndër të tjera, rezoluta rekomandon që shtetet të aplikojnë një politikë represive ndaj të gjitha formave të dhunës ndaj grave, të mbledhin të dhëna që janë të krahasueshme dhe që përputhen me njëra-tjetrën lidhur me dhunën që ushtrojnë burrat ndaj grave, të garantojnë të drejtat e viktimës për mundësinë për t'u

drejtuar organeve të drejtësisë dhe për zbatim efektiv të tyre

## B) Standardet e përcaktuar nga BE dhe Këshilli i Evropës

BE-ja e adreson barazinë gjinore përmes një numri direktivash, rezolutash, rekomandimesh dhe aktesh, të nxjerra nga Këshilli i Bashkimit Evropian, Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian

Në vitin 1986, Parlamenti Evropian miratoi rezolutën "*Për dhunën kundër grave*". Rezoluta bënte thirrje për normimin e përdhunimit martesor, për organizimin e trajnimeve për ata që mund të jenë në kontakt me viktimat e dhunës në familje, dhe rekomandoi që grave t'u sigurohet asistencë ligjore.

Në vitin 1997, Parlamenti Evropian miratoi rezolutën për nevojën për të ndërmerren një fushatë të gjerë të BE-së për tolerancë "zero" ndaj dhunës kundër grave. Presidenca e BE-së, çështjen e dhunës në familje e ka vendosur në axhendën politike që prej vitit 1998 dhe ka miratuar një numër rekomandimesh që trajtojnë kryesisht dhunën në familje. Në konferencën e BE-së për dhunën kundër grave, të mbajtur me 1999, u krijuan pesë forume ekspertesh për të shqyrtuar aspekte të caktuara të dhunës në familje: përmbajtjen, shkaqet e fshehura dhe pasojat, mundësitë ligjore për të luftuar dhunën në familje, parandalimin, ndihmën për organizatat dhe bashkëpunimin me institucionet dhe rrjetet evropiane dhe punën me dhunuesit. Konferenca miratoi rekomandimin e forumeve të eksperteve për shtetet anëtare. Mbledhja e ekspertëve të BE-së për dhunën kundër grave, e mbajtur në vitin 1999, dha rekomandoj për modele të përbashkëta veprimi në ndihmë të luftës kundër dhunës. Ndër të tjetra, rekomandimi paraqiste rëndësi të veçantë, pasi ndër të tjera theksohej se, lufta ndaj dhunës në familje të jetë kriter për anëtarësim në të ardhmen.<sup>14</sup>

Këshilli i Evropës (KE), si organizatë ndërqeveritare rajonale, ka drejtuar vëmendjen nga mbrojtja e të drejtave njerëzore, që nga themelimi, në vitin 1948. Sistemi i të drejtave të njeriut të Këshillit të Evropës është bazuar në traktatet, të cilat përcaktojnë detyrimet për

e Parandalimit të Krimit dhe drejtësisë-  
Manuali i Burimeve, mars 1999

<sup>13</sup> Rezoluta e Parlamentit Evropian A6-0404/2005,

<sup>14</sup> Prof. Dr. Ilirjan Mandro dhe Z. Fredi Agastra, Manuali "Dhuna në familje", Mars, Viti 2008, faqe 11

<sup>10</sup> Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 52/86, 12 dhjetor 1997,

<sup>11</sup> Shih [www.icclr.laë.ubc.ca](http://www.icclr.laë.ubc.ca) [vizituar më 24 maj 2006].

<sup>12</sup> Strategjitë tip dhe Masa Praktike për Eliminimin e dhunës kundër Grave në fushën

shtetet anëtare dhe dokumente jodetyruese, si: direktiva, rekomandime dhe rezoluta.

Traktatet kryesore e të drejtave të njeriut të Këshillit të Evropës janë:

- a) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolli përkatës i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, (ratifikuar më 31 korrik 1996);
- b) Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe të Dënimeve ose Trajtimeve të tjera Çnjerëzore ose Degraduese (e ratifikuar më 31 korrik 1996);
- c) Konventa për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual. (ratifikuar më datë 09.02.2009)
- d) Konventa Evropiane për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (ratifikuar më 11 shtator 2012).

Këto akte ndërkombëtare kanë efekt të drejtpërdrejtë në legjislacionin kombëtar dhe në këtë mënyrë, gjyqësori, në nivel kombëtar, mund dhe duhet të marrë në konsideratë dispozitat e kësaj Konvente.

### 3. Gruaja si subjekt pasiv i veprës penale në marrdhëniet familjare

Me qëllim mbrojtjen e shëndetit të anëtarëve të familjes, lidhjes së afërt për shkak të gjinisë apo krushqisë legjislatori ka parashikua nenin 130/a<sup>15</sup> të Kodit Penal të Republikës të Shqipërisë. Pavrësisht, se me të drejtë, legjislatori ka përcaktuar në dispozitë një rreth të gjerë subjektesh për tu mbrojtur nga veprimet e paligjshme, në praktikë, pothuajse të gjitha rastet e dhunës në marrdhëniet familjare, janë veprimet kriminale ndaj gruas.

---

*"Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort/e, ish bashkëshort/e, bashkëjetues/e apo ish bashkëjetues/e, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fi zik, psikosocial dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në 2 vjet.*

*Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort/e, ish bashkëshort/e, bashkëjetues/e apo ish bashkëjetues/e, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e*

Në mënyrë që të cilësohet si vepër penale 'dhuna në familje' sipas nenit 130/a të KP, duhet të përmbushë kushtet për përgjegjësi penale të mirënjohura nga teoria dhe legjislacioni penal të tilla si: *objekti; ana objektive; subjekti; ana subjektive*. Përgjegjësia penale është detyrim ligjor i çdokujt, që shkel një rregullim normativeme karakter penal, për t'iu nënshtruar pasojave ligjore me karakter ndëshkues e parandalues. Nisur nga rëndësia që kanë organet proceduese penale përgjatë të gjithë veprimtarisë që përbën procedimin penal, nga intensiteti i madh i kufi zimit të të drejtave dhe lirive themelore të subjekteve të nënshtruara dhe nga nevoja për zhvillimin e një procedimi të ndershëm, të rregullt dhe tërësisht në përputhje me ligjin, Kodi Penal ka parashikuar disa kushte kumulative që duhet të përmbushen në çdo procedim penal.

Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme rezulton se, në nenin 130/a të K.P ligjvënës ka parashikuar një mbrojtje të posaçme juridike njëkohësisht dy objekteve: të sigurojë mbrojtje të marrëdhënieve familjare dhe të mbrojë shëndetin, paprekshmërinë e personit nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive, dhuna në familje, realizohet, kryesisht përmes veprimeve aktive si goditje me grusht, shkelma, kapje nga flokët, mbyllja në shtëpi,,etj] të tilla që cenojnë integritetin fizik, psikologjik dhe ekonomik të tij. Në këto kushte legjislatori është treguar i kujdesshëm për ardhjen e pasojës, duke përfshirë të treja format e dhunës së aplikuar për aq kohë sa e lidh veprimin e paligjshëm me cënimin e integritetit fizik, psikologjik dhe ekonomik .

Subjekti i kësaj vepre penale veç moshës për përgjegjësi penale dhe qenies i përgjegjshëm ka marrëdhënie martesore ose bashkejetese me viktimën. Nga ana subjektive vepra penale kryhet me dashje direkte ose indirekte. Pas miratimit të ligjit "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", këto dispozita penale fuqizojnë gamën

*integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në 3 vjet.*

*Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort/e, ish bashkëshort/e, bashkëjetues/e apo ishbashkëjetues/e, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë, dënohet me burgim gjer në 5 vjet.*

*Po këto vepra të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen me burgim nga 1 vit gjer në 5 vjet".*

e mjeteve ligjore për të luftuar me efi kasitet dhunën në marrëdhëniet familjare duke e adresuar mbrojtjen në një dispozitë penale dedikuar këtyre situatave. Për më tepër, ky ndryshim forcon mbrojtjen e grave dhe të fëmijëve, të cilët rezultojnë si subjektet më të dhunuara brenda marrëdhënieve familjare.

Në paragrafin e fundit të dispozitës është përcaktuar si rrethanë cilësuese, prania e fëmijës në konsumimin e veprës penale duke rënduar pozitën e subjektit aktiv. Në këtë rast, legjislatori jo vetëm ka mbrojtur anëtarin e dhunuar nga vepra penale por edhe integritetin psikologjik të të miturit i cili ka qënë i pranishëm në ushtrimin e veprimit të paligjshëm. Megjithatë, duhet të sjellim në vëmendje se për ekzistencën e kësaj veprë penale sipas kësaj dispozite kërkohet që i mituri të ketë parë ushtrimin e dhunës, ta ketë dëgjuar element të saj apo të pasojave.

Sakaq, prania e të miturit në banesën familjare nuk do të thotë dosmosdoshmërisht, cilësimin e faktit sipas neni 130/a parag 4 i Kodit Penal.

Kodi penal duke synuar mbrojtje të veçantë për familjen dhe anëtarët e saj, parashikon se "nuk do të merret si rrethanë lehtësuese normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet personit që ka kryer veprën penale dhe të dëmtuarit nëse personi ka kryer një vepër penale ndaj fëmijëve apo një vepër penale të dhunës në familje"<sup>16</sup>.

Nga ana tjetër, nenin 50/e/1 i Kodit penal, parashikon një rrethanë të re "rënduese". Përbën rrethanë rënduese "kryerja e veprës penale gjatë ose pas dhënies së urdhrave gjyqësorë të mbrojtjes nga dhuna në familje;" Me këtë dispozitë, ndër të tjera, legjislatori ka synuar të grantoj të dhunuarën për të ndjekur e qetë procedurën për lëshimin e urdhërit të mbrojtjes. Nga ana tjetër, me miratimin e ligjit Nr. 23/2012, datë 1.3.2012, neni 30 pika 10 e Kodit Penal, është parashikuar si dënim plotësues humbja e përgjegjësisë prindërore<sup>17</sup>. Megjithatë, duhet theksuar se ky përcaktim, ka qënë dhe mbetet i vlefshëm si sanksion kufizues i parashikuar edhe nga neni 223 i Kodit të Familjes<sup>18</sup>.

Në vazhden e ashpërsimit të veprave penale kundër familjes, si rrethanë rënduese është parashikuar edhe kur vepra është kryer duke

përfutur nga marrëdhëniet familjare, të bashkëjetesës, të miqësisë, të mikpritjes"<sup>19</sup>.

Gjithashtu, megjithëse në nenin 59/a parashikohet "Qëndrim në shtëpi" si dënim nga ana e gjykatës në rrethana të posaçme<sup>20</sup>, sërish ka parashikuar klauzol përjashtuese për ata të dënuar që kanë kryer një krim ndaj bashkëshortit, bashkëjetuesit apo fëmijës së tij."

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i dimensionit të ri gjinor të këtij Kodi, vjen edhe me shtojcën 65/a të tij, i cili garanton periudhën e sigurisë në kuadrin e alternativave të dënimit me burgim. Kështu, autorizohet gjykata që në dhënien e vendimit penal, të mund të caktojë edhe një periudhë sigurie gjatë se cilës *nuk lejohet* aplikimi i nenit 64 të Kodit Penal (lirimi para kohe me kusht), kur vepra penale është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen; është kryer duke përfutur nga marrëdhëniet familjare ose të bashkëjetesës, si dhe kur kryerja e veprës penale është shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike, fetare ose sociale.

Tërësia e këtyre ndërhyrjeve ligjore jo vetëm ka ashpërsuar masën e dënimit të autorëve të dhunës në familje por i ka përjashtuar ata nga përfitimet që ligji penal u jep subjekteve të përgjithshme për konsumimin e veprave penale të tjera. Mosmarrja në konsideratë si rrethanë lehtësuese e normalizimit të marrëdhënieve mes autorit dhe të dëmtuarit, pamundësia e vuajtjes së dënimit në shtëpi dhe moszbatimi i lirimit përpara kohe me kusht, janë një sërë masash radikale me qëllim garantimin e familjes. Në të njëjtën politikë penale është trajtuar edhe vepra penale e përndjekjes parashikuar nga neni 121/a paragrafi 2<sup>21</sup>.

#### 4. Rekomandime

Nga pikëpamja kriminologjike, këto vepra penale konsiderohen të një natyre të veçantë dhe që nëqoftëse nuk "kurohen", kthehen në krime me efekt "zinxhirë". Ky lloj krimi karakterizohet nga element social dhe psikologjik. Abuzuesit gjithnjë e më shpesh vinë me profil kriminal si përsëritës

<sup>16</sup> Neni 48 shtuar me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013

<sup>17</sup> *Humbja e përgjegjësisë prindërore jepet nga gjykata ndaj personit që e ushtron përgjegjësinë prindërore, kur ai dënohet si autor ose bashkëpunëtor në një vepër penale ndaj fëmijës ose si bashkëpunëtor me fëmijën në kryerjen e një veprë penale."*

<sup>18</sup> Ligji Nr. 9062, datë 8.5.2003

<sup>19</sup> Neni 50/g i shtuar me me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013

<sup>20</sup> Shih nenin 59/a/a dhe 59/a/b të Kodit Penal

<sup>21</sup> *Kur kjo vepër kryhet nga ish-bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi apo personi që ka pasur lidhje shpirtërore me të dëmtuarin, dënimi rritet me një të tretat e dënimit të dhënë.*

me karrierë të gjatë viktimizimesh. Në këtë kontest rekomandohet modelimi eficient i trajtimit shkencor kësaj veprë penale. Të dhënat duhet të përmbajnë profilin e autorit dhe natyrën e veprimeve të tij, për të dëshmuar qartë rrezikshmërinë dhe prirjet e subjektit. Nga ana tjetër, vlerësohet nevoja e krijimit të programeve të rehabilitimit dhe izolimit sipas shkallës së rrezikshmërisë.

Për parandalim të fenomenit dhe rehabilitim të viktimave të këtyre veprave penale rëndësi të veçantë duhet të marrin Evidenca. Çka do të thotë se, duhet të krijohet një rrjet i përsosur i të dhënave. Evidenca e viktimizimit të anëtarëve të familjes duhet të përmbajnë evidentim statistikorë dhe evidentim të profilizuar. Sakaq, do të përfitohen njohuri të qarta mbi vëllimin, dinamikën, shtrirjen territoriale, nivelin dhe tipologjinë e viktimizimit. Nga ana tjetër, të dhënat duhet të jenë kofidenciale sa i takon viktimës. Në këtë mënyrë, mundësohet trajtim i diferencuar i viktimave sipas natyrës dhe shkallës së problematikës. Në rastin e viktimizimit seksual, autorët mund të jenë ish

viktima dhe efekti zinxhir i krimeve ka nevojë për hetim të zgjeruar. Marrëdhëniet seksuale pa dëshirën e bashkëshortëve nuk ndalohen shprehimisht por nuk e përjashtojnë specifikisht bashkëshortin nga ndjekja penale. Për pasojë, vlerësohet si domosdoshmeri rregullimi në një vepër penale të posaçme, të kësaj situatë fakti. Pavarësisht të qenit bashkëshortë, mundet që shfaqja e vullnetit për marrëdhënie seksuale të jetë e dyshimtë dhe mungesa e pëlqimit duhet të jetë determinante dhe nuk është e nevojshme të shoqërohet me rezistencë apo kundër reagim të dhunshëm. Së fundmi, zhvillimi i gjykimit "Një familje një trup gjykues" duhet të konsiderohet një zgjidhje e mundshme efektive. Shqyrtimi gjyqësor nëpërmjet këtij organizimi, ofron lehtësi nga pikëpamja e administrimit të provave pasi anëtarët e familjes nuk kanë asrsye të rifillojnë dhe të japin shpjegime të përsëritura. Në këtë mënyrë, dhunuesi dekurajohet që në mënyrë të vazhdueshme të shprehi keq ardhje, ndjesë apo angazhim për rregullimin e marrëdhënieve në familje<sup>22</sup>.

## LITERATURA

1. Anthony Fletcher, *Gender, Sex and Subordination*, Yale University Press, 1995
2. Carol Meyers, *Discovering Eve*, (Duke Zbuluar Evën), Oxford University Press, 1988
3. Natalie Zemon Davis, *Fiction in the Archives, Pardon Tales and their Tellers in Sixteenth-century France*
4. Rachel Biale, *Women and Jewish Law, An Exploration of Women's Issues in Halakhic Sources*
5. Vesna Nikolić-Ristanović Mirjana Dokmanović *International Standards on Domestic Violence and Their Implementation in the Eastern Balkans*, Belgrade, 2006
6. Prof. Dr. Ilirjan Mandro dhe Z. Fredi Agastra, *Manuali "Dhuna në familje"*, Mars, Viti 2008
7. Z. dhe Të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar, vendim i Dhomës së Madhe i 10 majit 2001, nr. 29392/95.
8. Natalie Nanasi, *Domestic Violence Asylum and the Perpetuation of the Victimization Narrative*, , Febrary 2016
9. Astrida Neimans, *Gender mainstreaming in practice; a handbook*, UNDP 2002
10. Portune, Gatoëski, & Dobbin, *Permanency Planning for Children Department National Council of Juvenile and Family Court Judges, Winter 2009*
11. *Violence against women: an EU-wide survey. Main results, Luxembourg, Publications Office of the European Union (Publications Office), p. 52, <http://fra.europa.eu/en/publication/2014/vaew-survey-main-results>*
12. Zoran Stojanovic, *Komentar Krivicog Zakonika, Viti 2009, Beograd*

<sup>22</sup> Portune, Gatowski, & Dobbin, *Permanency Planning for Children Department National Council*

*of Juvenile and Family Court Judges Winter 2009, p. 37*

# Diplomacia e Skënderbeut

**Dr. Blerina Xhelaj**

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë  
Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë  
Departamenti i Edukimit  
blerina.xhelaj@univlora.edu.al

## Abstrakt

Në fillim të shekullit të XV-të tokat shqiptare përfshihen nën pushtimin e Perandorisë Osmane. Shqipëria paraqitet si një vend i prapambetur, ku mbizotëronin marrëdhëniet e vjetra feudale. Gjatë kësaj periudhe, Gjergj Kastriot Skënderbeu ka patur një ndikim të rëndësishëm në mbrojtjen e tokave shqiptare dhe të identitetit kulturor në vend. Ai konsiderohet si "arkitekti" i parë në ndërtimin embrional të shtetit shqiptar, të cilin e përqëndroi në duart e tij dhe të institucioneve që ai krijoi në vend. E parë në këndvështrimin e politikës ballkanike, Skënderbeu ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm si element sigurie për Evropën nga sulmet Osmane, por edhe si mbrojtës i krishtërit. Këtë gjë, ai e ka krijuar nëpërmjet marrëdhënieve diplomatike të ndërtuara që ai diti shumë mirë t'i përdorte me shtetet italiane, por edhe me institucionin papal. Diplomacia e Skënderbeut është shumë e gjerë. Ai zhvilloi marrëdhënie diplomatike me Papa Piun e II-të, shtetin e Raguzës, mbretërinë e Napolit, republikën e Venedikut, me Hungarinë etj. Skënderbeu vlerësohet si një nga personalitetet kryesore në Evropë që shërbeu si element sigurie për një periudhë çerek shekullore.

**Fjalë kyçe:** *Diplomaci, identitet kulturor, krishtërim, përqëndrim i pushtetit, pushtim*

At the beginning of the 15 th century the Albanian territory was included under the rule of the Ottoman Empire. Albania appears as a backward country, where old feudal relations prevailed. During this period, Gjergj Kastriot Skanderbeg has had a significant impact on the protection of Albanian lands and the cultural identity of Albanians. He is considered to be the

## Abstract

first" architect" in the embryonic building of the Albanian state, which he focused on his hands and the institutions he created in the country. From the point of view of Balkan politics, Skanderbeg has played a very important role as a security element for Evropa from Ottoman attacks, but also as a protector of christinity. This, he created through diplomatic relations built, that he know very well to use with italic states, but also with the papal institution. Skanderbeg's diplomacy is very wide. He held diplomatic relations with Pope Piu II, the state of Ragusa, the kingdom of Naples, the republic of Venice, Hungary etc. Skanderbeg is rated as one of the leading figures in Europe that served as a security element for a quarter of a century.

**Key word:** *diplomacy, cultural identity, christianity, concentration of power, ottoman invasion*

## 1. Rikthimi i Gjergj Kastriot Skënderbeut dhe fillesat e politikës së jashtme të tij

Shekulli i XV-të e gjeti Evropën të kërcënuar nga sulmet e perandorisë osmane dhe kryesisht rajonin e Ballkanit. Një nga vendet që po kërcënohej seriozisht nga kjo perandori ishte Shqipëria, e cila paraqitet në arenën ndërkombëtare si një vend i vogël, me një zhvillim të dobët ekonomik dhe e papërfillur në sytë e ndërkombëtarëve. Shqipëria përmendet më tepër në kancelaritë evropiane pas kthimit të Gjergj Kastriot Skënderbeut në Krujë. Ai edhe pse i rritur dhe stërvitur në ambjentin dhe kulturën osmane, nuk e harroi atdheun e vet. Pas kthimit të tij në nëntor të vitit 1443, ai i hapi luftë perandorisë për mbrojtjen e tokave

shqiptare, të cilat kërcënoheshin vazhdimisht nga invazioni osman. Skënderbeu nisi një kryengritje të papritur kundër osmanëve, gjë e cila fillimisht nuk u mor seriozisht nga faktori ndërkombëtar, duke mos i dhënë asnjë rëndësi asaj. Por, kur perandoria osmane po rrezikonte interesat e shteteve italike dhe më gjerë, këto të fundit do t'i jepnin më tepër rëndësi përpjekjeve të tij për të sprapsur trupat osmane. Fillimisht, Republika e Venedikut ishte e shqetësuar nga synimet nacionaliste të Skënderbeut, e cila arriti deri në atë pike, sa kërkoi të likujdonte fizikisht atë, në vitin 1448. Qëndrimi i Venedikut ndryshon kur sulltan Murati i II, në vitin 1450 ndërmori një invazion kundër Shqipërisë. Perandoria osmane rrezikonte shtetet italike, si dhe vendet e Evropës Qendrore, kryesisht Hungarinë katolike. Tashmë, ishte krijuar bindja brenda qarqeve evropiane, *"se në luftën që po zhvillonte Skënderbeu në Shqipëri luhej edhe fati i Italisë"*. Kryekapedanit shqiptar i duhej siguruar një përkrahje morale, politike, por edhe financiare nga arena ndërkombëtare. Në një letër që Skënderbeu i dërgoi princit të Tarantit, G.A. Orsinit më 30 tetor të vitit 1460 shkruante: *"tashmë të gjithë e dinin se po të binte Kruja, radhën do ta kishte Italia"*. Një vend tjetër që rrezikonte nga invazioni osman ishte edhe Hungaria, e cila e përkrahu ndër të parat Skënderbeun. Pas largimit të forcave osmane, Skënderbeu u kthye në frontin e luftës kundër perandorisë. Gjatë kësaj periudhe nisën përgatitjet ushtarake anti-osmane, të përfaqësuara nga ushtria hungareze e Janosh Huniadit dhe e ushtrisë së besëlidhjes së Lezhës. Kuvendi vendosi për bashkëpunimin e tyre kundër koalicionit osman. Për realizimin e këtij projekti *"ushtria e Janosh Huniadit do të marshonte drejt viseve verilindore shqiptare, ku do të bashkohej me rreth 20 mijë luftëtarë shqiptarë që do t'i komandonte vet Skënderbeu"*. Në lidhje me qëndrimin e Skënderbeut ndaj perandorisë osmane, e rëndësishme për atë, ishte dhe diplomacia që do të ndiqte me vendet e tjera, si dhe reagimi i faktorit ndërkombëtar. Skënderbeu ndërtoi marrëdhënie shumë të mira me Janosh Huniadin, kreun hungarez, por që nuk u shoqëruan asnjëherë me akte të nënshkruara protokollare, pra ishte një aleancë që mbështetej secili në sektorine vet. Gjatë kësaj kohe, vëmendja e Skënderbeut u orientua drejt Republikës së Venedikut, të cilës i kërkoi ndihmë financiare, ushtarake, pse jo dhe morale, për vazhdimin e luftës kundër osmanëve. Bisedimet me përfaqësuesit e Venedikut u zhvilluan në Lezhë nëpërmjet Besëlidhjes Shqiptare, e cila përfaqësohej nga Skënderbeu dhe Nikollë Dukagjini, *"ndërsa Republikën e*

*Venedikut e përfaqësonte qeveritari i Shkodrës, Paolo Loredani, dhe i dërguari i posaçëm i saj, Andrea Venerio"*.

### 1.1 Marrëdhëniet e Skënderbeut me Venedikun dhe Raguzën

Republika e Venedikut ishte një nga vendet më të fuqishme në aspektin detar e tregtar në pellgun e mesdheut, si dhe zotëronte disa qendra e porte të rëndësishme në Ballkan. Ajo zotëronte edhe disa qytet- porte të rëndësishme në Shqipëri. *Rëndësia ekonomike, politike dhe strategjike e zotërimeve që kishte në tokat shqiptare, bënte që Republika e Venedikut t'i kushtonte në çdo kohë vëmendje të veçantë ruajtjes së këtyre zotërimeve dhe forcimit të pozitave të veta në to"*.

Venediku ishte skeptik lidhur me qëndrimin e Skënderbeut, për të krijuar një shtet të pavarur dhe të drejtuar nga ai, sepse kërcënonte interesat e Venedikut në Shqipëri. Në 4 tetor 1448, ndërmjet dy vendeve u nënshkrua një traktat paqe që do të ratifikohej me vështirësi nga pala venedikase. Sipas përmbajtjes së këtij traktati, Skënderbeu do t'i lëshonte Venedikut territorin e Danjës dhe krahinat në krahun e djathtë të lumit Drin, kurse vetë Skënderbeu do të përfitonte të drejtën e strehimit në territoret e saj, si dhe do të siguronte një shpërbllim prej 1400 dukatesh, shifër kjo e papërfillshme për një shtet aq nevojtar, *por Skënderbeu nuk iu nuk dhanë 1400 dukatet e vitit të parë, që sipas traktatit do t'i merrte brenda 15 ditëve që të përgatitej për fushatën ushtarake të pëbashkët me J. Huniadin"*.

Me Venedikun, Skënderbeu nuk siguroi as ndihmë morale dhe as financiare, përkundrazi, Venediku kishte nënshkruar një traktat paqe me perandorinë osmane, duke siguruar kështu marrëdhënie të mira tregtare. Gjithashtu, *Venediku ushtronte presion brenda besëlidhjes së Lezhës me qëllim që kapiteni shqiptar të bëhej sa më pak i rrezikshëm për të*. Gjatë kësaj periudhe, Skënderbeu i hodhi sytë drejt republikës dalmate, Raguzës. Ai ndërtoi marrëdhënie shumë të mira me të, e cila e ndihmoi më tepër moralisht dhe me disa shuma të hollash, por të pamjaftueshme për të vazhduar luftën. Ragusa nuk nënshkroi asnjë aleancë mbrojtëse dhe ushtarake me Skënderbeun. Republika dalmatine *"nuk shkoi më tepër se përgëzimet për fitoret e arritura"*. Megjithatë, Skënderbeu nuk u ankua asnjëherë nga ajo, siç ndodhi me republikën venedikase. Skënderbeu i mbajti marrëdhëniet me Raguzën duke siguruar kontaktet me Evropën Perëndimore. Gjithashtu, kreu shqiptar siguroi edhe veprimet financiare

të shtetit shqiptar nëpërmjet bankave që operonin në Raguzë.

## 1.2 Politika e jashtme e Skënderbeut me Romën

Një nga vendet me të cilat Skënderbeu pati marrëdhënie më të vazhdueshme dhe më të qëndrueshme ishte Roma, e cila përfaqësonte jo vetëm qëndrën universale të krishtërimit, por edhe kryeqytetin e një shteti të fuqishëm, atë të shtetit papal. Si seli e shenjtë, juridiksioni i saj shtrihej edhe në territorin shqiptar. Përparimi i osmanëve në Ballkan, afrimi i tyre në kufijtë e Hungarisë katolike, pretendimet e tyre për një dalje në Adriatik, natyrisht që kërcënonin edhe kufijtë e shtetit papal. Kontaktet e para mes Skënderbeut dhe Romës ndodhën në pragu e kryengritjes çlirimtare të vitit 1443.

Marrëdhëniet diplomatike u zgjeruan në kohën e papa Nikolla V, i cili emëroi Antonio di Oliveton si nunc apostolik në Shqipëri që më vonë zëvendësohet nga Eugjen Suma. Pavarsisht diplomacisë që këto dy vende ndoqën, ato kishin qëllime të ndryshme rreth mënyrës se si e shikonin luftën kundër invazorëve osmanë. Më 12 korrik të vitit 1447, papa Nikolla V e porositi të deleguarin e vet, *"që të përpiqej për të bindur besnikët e krishterë që t'i japin të birit të dashur, burrit fisnik Gjergj Kastriotit, zot në Shqipëri përkrahje dhe ndihmë kundër turqve"*. Ndërsa, sipas Nolit në veprën "Skënderbeu" e përmend atë duke e quajtur *"luftëtar të devotshëm, tepër të fuqishëm të fesë së vërtetë dhe goditës sypatrembur"*.

Skënderbeu luftën e shikonte si një përpjekje për të çliruar territoret shqiptare nga sundimi osman dhe sigurimin e pavarësisë, kurse Roma shikonte më larg, duke larguar jo vetëm osmanët nga Evropa, por kërkonte të përfshinte nën autoritetin e saj edhe juridiksionin e Patrikanës së Konstandinopojës në lindje. Roma kërkonte të anashkalonte edhe procesin e lindjes së shteteve nacionaliste në Evropë, të cilat përpiqeshin të çliroheshin nga tutela e Romës. Nisur nga këto rrethana, Roma arriti t'i siguronte Skënderbeut një shifër afro 5000 dukatesh për luftën kundër osmanëve, shifër e papërfillshme krahasuar me ndihmat që Roma u kishte siguruar vendeve të tjera. Edhe Roma i'u përgjigj kërkesave të Skënderbeut më shumë në formën e përgëzimeve të fitoreve të arrituara sesa të ndihmave të pakta që ajo dha. Këto të dhëna jepen edhe nga kardinali Karvajali. Historiani Kristo Frashëri përmend në veprën e tij mbi jetën dhe veprën e Skënderbeut, korrespondencën e Karvajalit, i cili shkruante ndër të tjera:

*"Deri sot nuk ka patur njeri që të ketë qënë aq tepër i përkushtuar për të mirën e përbashkët sa Nikolla V. Ai i ka dhënë 5000 dukate Skënderbeut dhe i ka premtuar ndihma të tjera me qëllim që ai të mbrohet nga turqit; ai i dërgoi 60.000 dukate ishullit të Rodit; ai ka shpenzuar 40.000 dukate për ndërtimin e flotës luftarake për ta dëguar kundër turqve; ai u përpoq ta bindte princin e Karamanisë me një shumë të madhe të hollash që të ndërmerre një sulm kundër osmanëve".* Skënderbeut i ishin kufizuar të hollat edhe nga Roma dhe duke patur mospërputhje interesash mes tyre, ai detyrohet t'i kërkojë ndihmë një shteti tjetër.

## 1.3 Marrëdhëniet diplomatike me Alfonsine V-të dhe traktati i Gaetës

Skënderbeu do të hynte në rrugën e diplomacisë me Mbretërinë e Napolit e drejtuar nga mbreti Alfonsi V-të. Marrëdhëniet e tyre diplomatike janë karakterizuar nga tone ulëse dhe ngritëse. Fillimisht, këto marrëdhënie kanë qënë të mira, por mbreti i Napolit ishte në luftë me Venedikun, me të cilën Skënderbeu kishte lidhur edhe një aleancë me këtë të fundit. Alfonsi V u zemërua më shumë, kur i kërkoj Skënderbeut që të lidhte një aleancë kundër Venedikut në bashkëpunim edhe me princin serb, Gjergj Brankovicin, për çështjen e qyteteve bregdetare, të cilën Skënderbeu hezitoi ta pranonte. Vetëm pas vitit 1450, marrëdhëniet diplomatike të Mbretërisë së Napolit me Republikën e Venedikut u përmirësuan, ndërsa gjendja ekonomike në Shqipëri po vështirësohej gjithnjë e më shumë. Skënderbeu i ndodhur në këto kushte dhe pa aleatë, u detyrua t'i rikthehej politikës së vjetër me Venedikun, duke i premtuar asaj edhe territorin e Krujës, por Venediku nuk pranoi, sepse ishte në aleancë me sultanin. I pashpresë, Skënderbeu i rikthen sërish sytë drejt mbretit të Napolit, Alfonsit të V-të. Ky i fundit e shikonte me interes Shqipërinë sepse kërkonte të krijonte një perandori mesdhetare, duke siguruar rrugën përmes brigjeve shqiptare të Adriatikut dhe Jonit. Afrimi shqiptaro-napoletan do të acaronte marrëdhëniet diplomatike mes Napolit dhe Venedikut, por edhe me perandorinë osmane. Këto marrëdhënie do të acaroheshin akoma më shumë, kur nënshkruhet traktati politiko-ushtarak ndërmjet Shqipërisë dhe Napolit, që ka hyrë në histori me emrin traktati i Gaetës. Ky traktat nuk u nënshkrua nga krerët e dy vendeve, ku u dërguan nga pala napoletane, pronoteri Arnaldo Fonolleda, kurse nga pala shqiptare dy peshkopë, si at Stefani që përfaqësonte peshkopatën ortodokse të Krujës dhe Nikollë de Berguci, peshkop i kishës

katolike. Në traktatin e Gaetës Skënderbeu kishte pozitë inferiore. Kjo gjë vihet re në shumicën e pikave të traktatit. Në nenin 1 thuhej: se mbreti i Napolit do të dërgojë ushtri për të mbrojtur kreun e shqiptarëve, ndërsa ky i fundit duhet t'i jepte qytetin e Krujës atij personi që do të dërgonte mbreti Alfons, por edhe çdo qytet që ai ka në zotërim.

Gjithashtu, të gjitha qytetet, fshatrat, kështjellat do të mbeteshin nën urdhrat e Alfonsit të V, sipas nenit 2.

Sipas nenit 3, Skënderbeu duhet të betohej për besnikëri, duke e njohur Alfonsin V si sovran dhe veten si vasal të tij.

Sipas nenit 4, pasi të çliroheshin të gjitha tokat shqiptare, ato duhet të paguanin një haraç ose tribut vjetor mbretit napoletan.

Sipas nenit 5, Skënderbeu dhe farefisi i tij duhet të blinin kripë vetëm në magazinat e Alfonsit, me po atë çmim që e blinin nga magazinat e sulltanit. Vetëm pika 6 ishte në favor të interesave shqiptare, pasi Alfonsi V duhet të respektonte venomet dhe zakonet e Krujës, si dhe nuk do të ndërhynte në administrimin e brendshëm të saj. Traktati i Gaetës përcaktoi marrëdhëniet diplomatike të Skënderbeut, të cilat morën trajtën e një katërkëndëshi, të përbërë nga katër shtete që ishin të interesuar, për vazhdimin e luftës së shqiptarëve kundër invazorëve osmanë, si Republika e Venedikut, shteti papal, Republika Raguziane, Mbretëria e Napolit, si dhe aleanca me Hungarinë e cila kjo e fundit nuk u shoqërua asnjëherë me letra kredenciale. Gjithashtu, në politikën e jashtme të Skënderbeut përfshihen edhe vende të tjera si: Dukati i Milanit, Mbretëria e Burgundisë etj. Diplomacia e Skënderbeut lëkundej midis Napolit, Romës, Raguzës dhe në fund nga Venediku. Dinamika e marrëdhënieve diplomatike të Skënderbeut që ai kishte ndërtuar me Venedikun ndryshon pas viteve 1460. Pas përfundimit të trazirave në mbretërinë e Napolit, papa Piu II fillon projektin e kryqëzatës antiosmane, ku rolin kryesor do ta kishin Venediku dhe kreu i shqiptarëve, Skënderbeu. Por, Venediku druhej të përfshihej në këtë kryqëzatë, sepse rrezikonte të prishte paqen me sulltan Muratin e II-të. Gjatë kësaj periudhe, u rivendosën sërish marrëdhëniet diplomatike midis Skënderbeut dhe Republikës së Venedikut, e cila lejoi që ushtria shqiptare të kalonte në krahinën e Shkodrës për në Bosnjë. Më 1463 mbaroi edhe aleanca e paqes me Venedikun, e cila dukej se do ta detyronte Skënderbeun, që të mos rreshtohet si pjesë e koalicionit antiosman. Skënderbeu dërgoi në Romë të deleguarin e vet Karl Topinë, i cili e njoftoi Papën e Romës, se ishte i detyruar të bënte paqe me sulltanin dhe se një gjë e tillë

ishte e mirë e përbashkët edhe për Romën. Fillimisht, Republika e Venedikut nuk u shqetësua nga ky pakt, por gjendja politike dhe ushtarake do të ndryshojë, kur Papa do të bindi Venedikun që t'i shpallte luftë Turqisë, më 29 korrik të vitit 1463. Tashmë as Venediku nuk kishte më interes nga paqja shqiptaro-turke, përkundrazi, i kërkoi Skënderbeut që të hynte në luftë me sulltanin. Në vitet në vazhdim, Skënderbeu do të nënshkruante edhe një aleancë me Venedikun për vazhdimin e kryqëzatës osmane që u inicua dhe u financua nga Papa Piu II-të. Por, Papa nuk arriti ta realizonte projektin e vet dhe ta çonte deri në fund para vdekjes së tij, ku sipas të dhënave që na japin: Marin Barleti, Dhimitër Frëngu dhe Pal Ëngjëlli thuhej se: *"Papa Piu II do ta kurorëzonte në Durrës Skënderbenë si mbret dhe Pal Ëngjëllin si kardinal të Kishës Romane"*.

### Përfundime

Gjergj Kastriot Skënderbeu është personaliteti që ngriti lart emrin e shqiptarëve nëpërmjet fitoreve të njëpasnjëshme, jo vetëm në planin e brendshëm, por edhe në faktorin e jashtëm. Ai përshkruhet nga historiografia shqiptare, por edhe ajo botërore, si një personalitet i guximshëm, strateg, diplomat i aftë dhe inteligjent. Ai përqëndroi pushtetin në duart e tij, duke bashkuar krerët shqiptarë nëpërmjet Lidhjes së Lezhës, e cila sanksionoi për herë të parë përqëndrimin e shtetit të "pavarur" shqiptar. Gjergj Kastriot Skënderbeu ishte shumë i suksesshëm edhe në politikën e jashtme. Ai krijoi një sistem të gjerë aleancash jo vetëm brenda, por dhe jashtë vendit, si Republika e Venedikut, shteti papal, Republika Raguziane, Mbretëria e Napolit, si dhe aleanca me Hungarinë, e cila kjo e fundit, nuk u shoqërua asnjëherë me letra kredenciale. Gjithashtu, në politikën e jashtme të Skënderbeut u përfshinë edhe vende të tjera si Dukati i Milanit, Mbretëria e Burgundisë etj. Diplomacia e Skënderbeut lëkundej midis Napolit, Romës, Raguzës dhe në fund nga Venediku. Në shtetin e përqëndruar të Skënderbeut nuk kishte institucione të veçanta që merreshin me veprimtarinë diplomatike, por kishte funksionarë të lartë si konsuj, ambasadorë, oratorë etj, të cilët u pajisën me letra kredenciale për realizim e një diplomacie aktive. Diplomatët që spikatën më shumë ishin: Gjergj Pellini, Karl Topia, Pal Ëngjëlli, Stefan dhe Nikolla de Berguci, Martin Muzaka, Andrea Suma etj. Skënderbeu diti shumë mirë që ta bënte diplomacinë vetëm në emër të interesit të Shqipërisë dhe shqiptarëve. Ai dallohet edhe në aspektin e të qenit një strateg dhe komandant i

shquar, që diti t'i sprapste trupat osmane, jo vetëm nga tokat shqiptare, por edhe nga Evropa për një perudhë çerek shekullore. Emri i tij përmendet në literaturat e huaja, si një nga personalitetet më të rëndësishme që kanë bërë histori gjatë shekullit të XV-të dhe që ka lënë

gjurmë deri në ditët e sotme. Ai vlerësohet si mbrojtës i vlerave të identitetit shqiptar, mbrojtës i krishtërit, i rendit dhe sigurisë evropiane. Ai konsiderohet si "arkitekti i parë i themelimit të shtetit shqiptar".

## Literatura

### Literatura bazë:

1. Barleti, Marin *"Historia e jetës dhe veprave të Skënderbut, princi i epirotve"*, Romë, 1508- 1510
2. Frashëri, Kristo *"Gjergj Kastriot Skënderbeu, jeta dhe vepra 1405- 1468"*, Toena, 2002
3. Noli, Fan, *Historia e Skënderbeut*, Boston Mass, 1949
4. Valentini, Zef, *"Papa Kalisti III, Skënderbeu, Shqipëria dhe kryqëzata 1451- 1458"*, Tiranë, Plejad, 2009

### Literatura të tjera:

5. Bicoku, Kasëm, *"Toponimet mesjetare për studimet historike"*
6. Brackob, A. K *"Një histori e Gjergj Kastriotit dhe e rezistencës shqiptare ndaj ekspansionit islamik në Evropën e shekullit XV"*, 2018
7. Bardhi, Frang, *"Skënderbeu"*, shtëpia botuese Naim Frashëri
8. Daci, Fatos, *"Skënderbeu i vërtetë"*, mars, 2009
9. Frashëri, Naim, *"Histori e Skënderbeut", poemë*
10. Floristan, Manuel, Jose, *"Marrëdhëniet mes mbretërisë së napolit me Shqipërinë"*.
11. Godo, Sabri, *"Skënderbeu, 1975"*
12. Jeronim de Rada, *"Skënderbu i pa fan", poemë*
13. Kule, Virgjl, *Kryqtari i fundit*, Tiranë 2012
14. Nadin, Lucia, *"Shqipëria e rigjetur"*
15. Plasari, Aurel, *"Skënderbeu një histori politike"*
16. Paganel, Camille, *"Historia e Skënderbeut"*, 1855
17. Radonic, Jovan, *"Gjergj Kastriot Skënderbeu dhe Shqipëria në shekullin e XV"*
18. Schmitt, Oliver, *"Skënderbeu"*
19. Thëngjilli, Petrika, *"Skënderbeu"*
20. Vreto, Jani, *"Historia e Skënderbeut"*
21. Ilmi Veliu, *"Skënderbeu në 600 vjetorin e lindjes", (artikull)*

## **SHKENCAT INXHINIERIKE DHE MATEMATIKORE**

# Some new generalized Hermite-Hadamard inequalities via tempered fractional integrals using subadditive functions

**Rozana Liko, Elda Lamçe**

Department of Mathematics, Faculty of Technical and Natural Sciences,  
University Ismail Qemali, 9400 Vlora, Albania  
rozana.liko@univlora.edu.al  
elda.lamce@univlora.edu.al

## Abstract

In this paper, using a new identity as an auxiliary result, we deduce several generalized Hermite-Hadamard type inequalities for subadditive functions pertaining to tempered fractional integral operators. To validate the efficiency of our main results, we offer some examples for suitable choices of subadditive functions.

**Keywords:** *Hermite-Hadamard inequalities, Subadditive functions,  $\lambda$ -Incomplete gamma functions, Hölder's inequality, Power-mean inequality, Tempered fractional integral operators.*

**Mathematics subject classification (2010):** 26A51, 26A33, 26D07, 26D10, 26D15.

## Abstrakt

Në këtë punim, duke përdorur një identitet të ri si një rezultat ndihmës, jemi përpjekur të nxjerrim disa mosbarazime të përgjithësuara të tipit Hermite-Hadamard për funksionet subaditiv, që kanë të bëjnë me operatorët integral fraksional të temperuar. Për të provuar efikasitetin e rezultateve tona kryesore janë dhënë disa shembuj, për zgjedhje të përshtatshme të funksioneve subaditiv.

**Fjalëkyçe:** *mosbarazimi Hermit-Hadamard, funksionet subaditive, funksionet Gama  $\lambda$ - të paplotë, mosbarazimi i Hölder-it, mosbarazimi fuqi-mesatare, operatorët integral fraksional të temperuar.*

**MSC (2010):** 26A51, 26A33, 26D07, 26D10, 26D15.

## 1. Introduction

Additivity, subadditivity and superadditivity are important concepts both in measure theory and in several fields of mathematics and especially inequalities. There are numerous examples of additive, subadditive and superadditive functions in various areas of mathematics, particularly norms, square roots, error function, growth rates, differential equations, integral means and distributive lattice. Inequalities and especially subadditive functions theory is one of the most extensively developing fields not only in theoretical and applied mathematics but also physics and the other applied sciences, see [1, 2, 3, 4, 5, 6]. Therefore, inequalities and convexity theory play an important role in mathematics and physics. It is well known that inequalities and subadditive theory are an important aid in solving numerous problems of mathematical physics. Subadditivity occurs in the thermodynamic properties of non-ideal solutions and mixtures like the excess molar volume and heat of mixing or excess enthalpy. In addition, inequalities and subadditive functions can be seen in electrical network, quantum relative entropy, purification, ergodic theory and dynamic systems, equilibrium and perturbations of repulsive. There has been increasing interest in the analysis of inequalities and subadditive functions. There are quite substantial literatures on such subadditive functions and inequalities. Here we mention the results of [7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16] and the corresponding references cited therein.

Let us recall the following definitions that we will be used in the next section.

**Definition 1.1** A function  $f: A \subseteq \mathbb{R} \rightarrow \mathbb{R}$  is said to be convex, if

$$f(tx + (1-t)y) \leq tf(x) + (1-t)f(y)$$

for all  $x, y \in A$  and  $t \in [0,1]$ .

**Definition 1.2** [7] A function  $f: A \subseteq \mathbb{R} \rightarrow \mathbb{R}$  is said to be subadditive, if

$$f(x+y) \leq f(x) + f(y)$$

for every  $x, y \in A$ .

N.q.s.  $A$  është quajtur tehu i  $\mathcal{V}_r$ , atëherë  $\mathcal{V}_r$  është quajtur mbështetja e  $A$ -së. Meqë  $A$  ka një drejtim të përcaktuar si dhe magnitudë  $|A|$  (të përkufizuar si në [2]. ajo shoqëron një masë të orjentuar si  $\mathcal{V}_r$ . Pra, çdo teh në  $\mathcal{G}_n$  përkufizon një nënhapësirë të një mase të vetme të  $\mathcal{V}_n$ . Le të shënojmë me  $\mathcal{B}_n$  bashkësinë e të gjithë tehëve në  $\mathcal{G}_n$  duke përfshirë edhe skalarët si 0-tehësh. Kjo bashkësi është e mbyllur në produktin e brendshëm dhe të jashtëm [3]. dhe [4]. Si rrjedhim, nën këto veprime  $\mathcal{B}_n$  mund të shihet si një algjebër të nënhapësirave të  $\mathcal{V}_n$ . Theksojmë se  $\mathcal{B}_n$  nuk është e mbyllur nën veprimin e mbledhjes, ndryshe nga ndonjë nga nënbashkësitë e saj. Me anë të operatorit të mbledhjes gjithë  $\mathcal{G}_n$  mund të gjenerohen nga  $\mathcal{B}_n$ . Algjebra  $\mathcal{B}_n$  është metrike kështu që strukturat e saj varen nga nënshkrimi i  $\mathcal{V}_n$ . Gjithsesi ajo përmban një nënalgjebër jometrike e cila është e pavarur nga ky nënshkrim.

Për tehet  $A$  dhe  $B$  përkufizojmë një produkt të ri  $A \vee B$  si

$$A \vee B = \tilde{A} \cdot B.$$

Ky është produkti regresiv i Grassmanit. Me këtë përkufizim, e gjithë algjebra e zgjeruar e Grassmanit është implementuar në mënyrë perfekte në algjebërën gjeometrike. Të gjitha vetitë e produktit regresiv rrjedhin në mënyrë të menjëhershme nga vetitë e produktit të brendshëm dhe dualitetit. Mund të tregohet që për rendin e  $A + B > n$  produkti regresiv është i shoqërueshëm dhe lidhet me produktin e jashtëm me anë të rregullit "De Morgan"

$$(A \vee B)^\sim = \tilde{A} \wedge \tilde{B}.$$

Për më tepër këto përfundime janë të pavarura nga nënshkrimi, sepse efekti i dualitetit në  $\tilde{A} \cdot B$  është të ndryshojë produktin e brendshëm në një produkt të jashtëm në përputhje me (10). Ky fakt është kaq shumë i rëndësishëm sa që meriton diskutime të mëtejshme.

Tehët të cilët janë dualë të vektorëve janë quajtur kovektorë (ose pseudovektorë). Çdo kovektorë  $A$  përcakton një hiperplan në  $\mathcal{V}_n$  sipas ekuacionit (12). Megjithatë, duke futur vektorin  $a = \tilde{A}$ , ekuacioni i hiperplanit mund të jepet në formë alternative

$$a \cdot x = \tilde{A} \cdot x = (x \wedge A)I^{-1} = 0.$$

Produkti i brendshëm në anën e majtë të këtij ekuacioni sygjeron një varësi metrike, por ana e djathtë e këtij ekuacioni tregon të kundërtën. Në fakt prodhimi i brendshëm këtu luan rolin jo metrik të një zvogëlimi (tkurjeje). Vëmë re që  $\omega(x) = a \cdot x = \tilde{A} \cdot x$  është një formë lineare në  $\mathcal{V}_n$ , dhe çdo formë lineare mund të përkufizohet në këtë mënyrë. Është kthyer në një praktikë standarte së fundmi në algjebërën lineare paraqitja e kovektorëve me anë të formave lineare. Ky është hapi i pavendosur për të cilin Grassman kishte aluduar më herët. Rezultati është një humbje e qartësisë dhe fuqisë llogaritëse. Do të duhej të ishte e qartë se e gjithë teoria e formave lineare (duke përfshirë dhe format diferenciale) është automatikisht e përfshirë në algjebërën  $\mathcal{B}_n$  ([6],[5]). Ku produkti regresiv është përdorur gjithmonë në vend të produktit të brendshëm, themi se algjebra e përfutur  $\mathcal{B}'_n$  është algjebra e zgjeruar e Grassmanit. Sigurisht, produkti i brendshëm mund të rikuperohet n.q.s. dualiteti do të futej si një veprim i pavarur.

Me produktin gjeometrik, takimin dhe bashkimin, produktet e tehëve mund të përcaktojmë cili korespondon në mënyrë të vetme me nënhapësirën standarte të veprimeve takim dhe bashkim në mbështetësit e tyre.

N.q.s. hapi  $A + \text{hapi } B > n$ , takimi i  $A$  dhe  $B$  jepet si  $A \vee B$ , dhe mbështetësi i tij është nënhapësira e takimit (ose prerja) e mbështetësve të  $A$  dhe  $B$ . Në mënyrë të ngjashme, bashkimi është dhënë nga  $A \wedge B$  ku  $A \wedge B \neq 0$ . Ky përkufizim i bashkimit dhe takimit mund të shtrihet në aplikimin e gjithë rasteve [7], por nuk do të merremi me këtë.

Një diskutim i rëndësishëm për tu bërë këtu është që struktura e laticave të nënhapësirave nën veprimet e takimit dhe bashkimit është

paraqitur besnikërisht në algjebërën e Grassmanit të tehëve në  $\mathcal{B}'_n$ . Sigurisht që algjebra e tehëve është një sistem më i fuqishëm sesa nënhapësira e laticave, sepse mund të paraqesë nënhapësira të rëndësishme dhe orjentime. Megjithatë n.q.s. dëshirohet, ajo thjeshtësisht mund të reduktohet në një laticë si në mënyrën e mëposhtme.

Le të jenë tehët  $A$  dhe  $B$  të parë si projekte ekuivalente atëherë dhe vetëm atëherë kur  $A = \lambda B$ , ku  $\lambda$  është një skalar jo zero. E shprehim këtë ekuivalencë me shënimin

$$A \doteq B$$

Atëherë

$$\begin{aligned} A \wedge B &\doteq B \wedge A, \\ A \vee B &\doteq B \vee A. \end{aligned}$$

Pra, nën ekuivalencën projektive humbet gjithë informacioni mbi shenjën (përfshirë këtu orjentimet), dhe operatorët e takimit dhe bashkimit në tehe janë ndërrimtarë tamam siç janë në nënhapësira. Ky është një ushtrim i lehtë për të përcaktuar se çfarë është e domosdoshme për të reduktuar algjebërën e tehëve  $\mathcal{B}'_n$  te një laticë. Kjo stabilizon atë që është një lidhje shumë e rëndësishme midis teorisë së laticave dhe algjebërës gjeometrike.

### 3 Gjeometria Projektive

Fuqia dhe universaliteti i algjebërës gjeometrike rrjedh pjesërisht nga shumë interpretime gjeometrike të ndryshme që mund ti atribuohen algjebërës në kompleksitetin e saj apo të ndonjë nënstruktura në brendësi të saj. Përfytyrojmë një paraqitje të gjeometrisë projektive brenda algjebërës gjeometrike duke adoptuar identifikimin standart të pikave në hapësirën projektive  $\mathcal{P}_{n-1}$  me rreze në hapësirën vektoriale  $\mathcal{V}_n$ . Kështu vektorët  $a$  dhe  $b$  paraqesin të njëjtën pikë atëherë dhe vetëm atëherë kur  $a \wedge b = 0$  ose në mënyrë ekuivalente  $a \doteq b$ .

Në gjeometrinë projektive bashkimi i pikave të ndryshme  $a$  dhe  $b$  është drejtëza  $A$ , e shprehur me anë të ekuacionit

$$A = a \wedge b.$$

Në mënyrë analoge, bashkimi i tri pikave të ndryshme  $a, b, c$  është një plan

$$J = a \wedge b \wedge c.$$

Duke folur në mënyrë specifike *2-tehëshi*  $A$  është një përfaqësim i drejtëzës të përcaktuar nga  $a$  dhe  $b$  ndryshe nga vetë drejtëza e cila është një bashkësi pikash. Por, meqë  $A$  përcakton drejtëzën në mënyrë të vetme sipas (12), identifikimi i  $A$  me drejtëzën që ajo përcakton është një mënyrë e shprehur konveniente.

Dy drejtëza të dallueshme  $A$  dhe  $B$  priten në një pikë atëherë dhe vetëm atëherë  $A \wedge B = 0$ . Në hapësirën projektive  $\mathcal{P}_2$ , ekuacioni (12) aplikohet n.q.s. pika e prerjes  $d$  jepet si  $d = A \vee B$ . Prandaj, kushti që drejtëzat  $A, B$  të jenë të përputhshme me drejtëzën  $C$  është që

$$d \wedge C = (A \vee B) \wedge C = A \wedge (B \vee C) = 0.$$

Këta shembuj tregojnë se si relacionet e shumtë jo metrike të gjeometrisë projektive janë paraqitur me anë të operatorëve të takimit dhe bashkimit në algjebërën gjeometrike. Paraqitjet janë kaq të thjeshta sepse primitivët e gjeometrisë sintetike, të tillë si pika, drejtëza, plani, takimi dhe bashkimi kanë saktësisht koresponduesit e tyre në algjebër. Për të ilustruar përdorimin e algjebërës gjeometrike për të pohuar dhe demonstruar teorema në gjeometrinë projektive, konsiderojmë teoremën e famshme të Desargues, e cila tregon për konfigurimin e drejtëzave dhe pikave si në figurën e mëposhtme. Për dy trekëndëshat e dhënë si në figurë, këndet përkatëse të tyre përcaktojnë tri drejtëzat e mëposhtme


$$P = a \wedge a', \quad Q = b \wedge b', \quad R = c \wedge c',$$

ndërsa zgjatimet e brinjëve koresponduese priten në tri pikat

$$\begin{aligned} p &= (b \wedge c) \vee (b' \wedge c'), \\ q &= (c \wedge a) \vee (c' \wedge a'), \\ r &= (a \wedge b) \vee (a' \wedge b'). \end{aligned}$$

Algjebra gjeometrike mund të përdoret për të nxjerrë nga kjo atë që llogjikisht mund të quhet identiteti i Desargues [8]:

$$p \wedge q \wedge r = (JJ')^2(P \vee Q) \wedge R$$



ku  $J = a \wedge b \wedge c$  dhe  $J' = a' \wedge b' \wedge c'$ .

Teorema e Desargues thotë qartësisht se ana e majtë anulohet atëherë dhe vetëm atëherë n.q.s. edhe ana e djathtë do të anulohet; e thënë ndryshe, pikat  $p, q, r$  janë kolinearë atëherë dhe vetëm atëherë n.q.s. drejtëzat  $P, Q, R$  janë të përputhshme. Sigurisht, teorema e Desargues mund të rrithe edhe nga identiteti i varfër  $p \wedge q \wedge r \doteq (P \vee Q) \wedge R$ , meqë faktori  $(JJ')^2$  është thjesht një skalar. Identiteti kapërcen gjeometrinë projektive dhe aplikohet gjithashtu mirë në gjeometrinë metrike, pavarësisht nga nënshkrimi.

Ishte David Htenes ai që përdori algjebërën gjeometrike  $\mathcal{G}_3$  (me nënëshkrim Euklidian) për të marrë identitetin e Desargues [9], i cili përdoret shumë mirë në formulimin dhe vërtetimin e gjithë teoremave mbi planin projektiv  $\mathcal{P}_2$ . Saktësisht e njëjta algjebërë është përdorur si gjuhë për mekanikën klasike në [7]. Prandaj identiteti i Desargues mund të shprehet si identitet në algjebërën vektoriale standarte të Gibbs. Siç tregohet në [7], prodhimi kryq vektorial  $a \times b$  është duali i  $a \wedge b$  në  $\mathcal{G}_3$ . Prandaj

$$a \times b = (a \wedge b)I^{-1} = (a \wedge b)\sim = \tilde{a} \vee \tilde{b}.$$

Kjo na jep një vizion të ri të prodhimit kryq. Kjo tregon se prodhimi kryq, i cili është i rrallë në hapësirën tridimensionale, është një rast i veçantë i takimit, i cili aplikohet në hapësira të çfarëdo dimensionale. Kjo gjithashtu na jep një interpretim gjeometrik të  $a \times b$  si një prerje planesh në  $\mathcal{V}_3$  (apo drejtëzash në  $\mathcal{P}_2$ ). Faktorë të ndryshëm në identitetin e Desargues [6], kanë paraqitjen e mëposhtme në terma të produktit kryq,

$$\begin{aligned} p \wedge q \wedge r &= (p \cdot q \times r)I \\ &= [(b \times c) \times (b' \times c')] \cdot [(c \times a) \times (c' \times a')] \cdot [(a \times b) \times (a' \times b')]I, \\ (P \vee Q) \wedge R &= (a \times a') \cdot (b \times b') \times (c \times c')I, \end{aligned}$$

$$(JJ')^2 = (a \cdot b \times c)^2 (a' \cdot b' \times c')^2.$$

N.q.s. këto do të zëvendësoheshin në [8] do të merrnim një identitet shumë më të komplikuar duke konsideruar normalisht llogaritjet vektoriale. Mbretkullia është se gjeometria e thjeshtë e zbeh këtë kompleksitet. Kjo tregon rëndësinë e zhvillimit të teknikave skematike për interpretimin e relacioneve algjebrike, një argument ky pak i zhvilluar. Thëksojmë se n.q.s. vektorët në dy trekëndëshat do të ishin të gjithë vektorë njësi, atëherë [6] do të ishte një relacion mes trekëndëshave sferikë. Trigonometria sferike është zhvilluar në terma të  $\mathcal{G}_3$  në apendiksin A të [7]. Shumë teorema të tjera të gjeometrisë projektive janë transformuar në identitete algjebrike në [3], dhe teoria e poleve është transformuar në dualitetin algjebrik.

E gjithë teoria e gjeometrisë projektive është maturuar për tu ripunuar në terma të algjebërës gjeometrike duke e riintegruar plotësisht me reston e matematikës. Kjo është një detyrë e rëndësishme që dikush duhet ta marrë dhe ta zhvillojë denjësisht. Padyshim që kjo do të prodhojë intuita të reja matematike, sikundër do të rikuperohen shumë të vjetra që janë të panjohura nga pjesa më e madhe e matematikanëve të sotëm.

#### 4 Algjebra Lineare

Algjebra lineare është zhvilluar me gjeometrinë projektive. Por formulime konvencionale nuk i japin rëndësinë e duhur koncepteve thelbësore si takimi, bashkimi dhe dualiteti në gjeometrinë projektive. Ky difekt u korrigjua me futjen e algjebërës gjeometrike në themel të algjebërës lineare. Këtu vëmë re interpretimin projektiv të ideve dhe rezultateve kryesore në [5].

Idea kryesore është ajo e futjes së konceptit të outermorfizmit (të morfizmit të jashtëm) si një koncept thelbësor të algjebërës lineare. Një outermorfizëm është shtrirja natyrale e një transformimi linear  $f$  në  $\mathcal{V}_n$  te një transformim linear  $\underline{f}$  në  $\mathcal{G}_n$ , të përkufizuar si më poshtë për një  $k$ -tehësh të [4]

$$\underline{f}(a_1, a_2, \dots, a_k) = (fa_1) \wedge (fa_2) \wedge \dots \wedge (fa_k).$$

Rrjedhimisht, produkti i jashtëm i tehëve është ruajtur si shprehje nga

$$\underline{f}(A \wedge B) = (\underline{f}A) \wedge (\underline{f}B).$$

Kjo implikon gjithashtu se hapi i çdo tehu është një invariant i outermorfizmit. Sigurisht,

outermorfizmi bën më eksplisit një koncept, i cili është thelbësor në algjebërën lineare. Për shembull, koncepti i përcaktorit rrjedh nga outermorfizmi i pseudoskalarit  $I$ , të shprehur si

$$\underline{f}I = (\det f)I.$$

Transformimet lineare me përcaktorë jo nul mund të interpretohen projektikisht si kolinearizime. Outermorfizmi është saktësisht ajo që është e domosdoshme për të provuar që ato projektojnë pikat në pika, drejtëzat në drejtëza, planet në plane etj. Ky rezultat rrjedh nga fakti se forma e ekuacionit [2] është një invariant i pasqyrimin. Padyshim, (4) pasqyron tek

$$x' \wedge A' = (\underline{f}x) \wedge (\underline{f}A) = 0$$

dhe  $\det f \neq 0$  sjell që  $A' = \underline{f}A \neq 0$  kur  $A \neq 0$ .

Çdo transformim linear  $f$  ka një transformim të transpozuar  $\bar{f}$ , dhe kjo mund të shtrihet në çdo outermorfizëm të caktuar nga  $\bar{f}$  gjithashtu. Transformimi i transpozuar mund të përcaktohet në mënyrë direkte në terma të  $\underline{f}$  si

$$\langle M \bar{f} N \rangle_0 = \langle (\bar{f} N) M \rangle_0 = \langle N \underline{f} M \rangle_0,$$

duke pranuar se qëndron për çdo  $M, N$  në  $\mathcal{G}_n$ . Në këndvështrim me produktin e jashtëm, produkti i brendshëm në pergjithësi nuk është i ruajtur nga një outermorfizëm. Përkundrazi, ai i bindet ligjit themelor të transformimit

$$A = (\bar{f}B) = \bar{f}[(\underline{f}A) \cdot B],$$

i cili qëndron për  $(\text{hapi } i A) \leq \text{hapi } i B$ , dhe për shkëmbimin e  $\underline{f}$  dhe  $\bar{f}$ . Ky ligj takohet në [5] dhe ka një rëndësi dhe kuptim të madh gjeometrik. Rëndësia e tij është e qartë kur e aplikojmë në rastin e veçantë  $B = I$ , e cila prodhon në mënyrë të menjëhershme një shprehje eksplcite për outermorfizmin e anasjellë.

$$\underline{f}^{-1}A = \frac{\bar{f}(AI)I^{-1}}{\det f}.$$

Vihet re sesi ky barazim tregon qartësisht rolin esencial të të transpozuarit dhe dualitetit të dyfishtë në llogaritjen e të anasjellit të një transformimi linear.

Kuptimi i plotë arrihet kur derivojmë nga [6] ligjin e mëposhtëm të transformimit për takimin

$$(fA) \vee (fB) = (\det f) f(A \vee B).$$

Faktori  $(\det f)$  mund të ndryshohet nga përkufizimi i dualitetit në të majtë në lidhje me pseudoskalarin e transformuar  $I' = fI = (\det f)I$ . Atëherë (32) sjell që transformimi  $A' = fA$  nënkupton transformimin  $\tilde{A} = \tilde{f}\tilde{A}'$  tek duali  $\tilde{A}' = A'(I')^{-1}$ , dhe (33) mund të shkruhet në formën

$$f[\tilde{A} \cdot B] = \tilde{A}' \cdot B'.$$

Ky ligj i transformimit matematikisht është ekuivalent me [5] për  $\det f \neq 0$ , por në të kundërt kuptimi i tij gjeometrik është transparent. duhet të konsiderohet si një nga rezultatet themelore të publikuar për herë të parë në 1988 nga David Hestenes edhe pse ai supozon se një rezultat ekuivalent duhet të ndodhet i harruar në veprat e mjeshtrave antikë të gjeometrisë projektive.

### 5 Ndarja Projektive dhe Raporti Kryq

Pikat e  $n$ -hapësirës  $\mathcal{P}_n$ , mund të paraqiten si rreze në  $\mathcal{V}_{n+1}$  ose si vektorë në  $\mathcal{V}_n$ . Ndryshimi në paraqitje nga  $\mathcal{V}_n$  te  $\mathcal{V}_{n+1}$  realizohet me futjen e koordinatave homogjene. Do të tregojmë tani që algjebra gjeometrike na lejon të shprehim këtë relacion midis  $\mathcal{V}_n$  dhe  $\mathcal{V}_{n+1}$  në një formë algjebrike pa koordinata nga e cila është ngushtësisht e lidhur me strukturën formale të algjebërës gjeometrike. Le të jetë  $x$  dhe  $\mathbf{e}_0$  vektorë në  $\mathcal{V}_{n+1}$  ku  $\mathbf{e}_0^2 \neq 0$ . Për  $\mathbf{e}_0$  të fiksuar dhe variabël  $x$ , përkufizojmë  $\mathcal{V}_n$  si bashkësinë

$$\mathcal{V}_n = \{x \wedge \mathbf{e}_0\}.$$

Është lehtësisht e verifikueshme që  $\mathcal{V}_n$  është një hapësirë vektoriale nën produktin gjeometrik, dhe se algjebra  $\mathcal{G}_n = \mathcal{G}(\mathcal{V}_n)$  që ajo gjeneron është thjesht nënalgjebra çift e  $\mathcal{G}_{n+1} = \mathcal{G}(\mathcal{V}_{n+1})$ , e shprehur nga

$$\mathcal{G}_n = \mathcal{G}_{n+1}^+.$$

Nga [5] shohim që  $\mathcal{V}_n$  mund të interpretohet projektivisht si lapsi i të gjitha drejtëzave që kalojnë përmes pikës  $\mathbf{e}_0$ . Kjo na siguron interpretim gjeometrik për relacionin mes algjebërës gjeometrike dhe nënalgjebërës çift të saj.

Funksioni  $x \wedge \mathbf{e}_0$  është një pasqyrim linear i  $\mathcal{V}_{n+1}$  tek  $\mathcal{V}_n$ . Pasqyrimi projektiv që lidh çdo rreze  $\{\lambda x\}$  në  $\mathcal{V}_{n+1}$  te një vektor i vetëm  $\mathbf{x}$  në  $\mathcal{V}_n$  përcaktohet si relacioni i mëposhtëm

$$x\mathbf{e}_0 = x \cdot \mathbf{e}_0 + x \wedge \mathbf{e}_0 = x_0(1 + \mathbf{x}),$$

$$\text{ku } x_0 = x \cdot \mathbf{e}_0 \text{ pra } \mathbf{x} = x \wedge \frac{\mathbf{e}_0}{x} \cdot \mathbf{e}_0.$$

vektorët në  $\mathcal{V}_n$  janë shënuar me shkrim bold për ti dalluar nga vektorët në  $\mathcal{V}_{n+1}$ . Do ti quajmë relacionet e  $\mathcal{V}_{n+1}$  te  $\mathcal{V}_n$  të përcaktuar nga (36) një ndarje projektive e  $\mathcal{V}_n$ . I njëjti lloj relacioni haset në fizikë kur hapësirë-koha është ndarë në komponentë hapësire dhe kohe, por ai ishte formuluar së pari në formë eksplicite në [4]. Le ta quajmë atë ndarja hapësirë-kohë. Një tjetër aplikim i rëndësishëm i ndarjes projektive është te "Clifford Analysis" [12]. N.q.s.  $\mathcal{V}_{n+1}$  ka nënëshkrim Euklidian atëherë ndarja projektive sjell që  $\mathcal{V}_n$  ka një nënëshkrim jo Euklidian. Ky është saktësisht relacioni midis variablave në formulime të ndryshme në dukje të analizës së Clifford në [5] dhe [8]. Për të parë se si paraqitja e një drejtëze në  $\mathcal{P}_n$  nga një 2-tehësh  $a \wedge b$  në  $\mathcal{G}_{n+1}$  është e lidhur me paraqitjen në  $\mathcal{G}_n$ , ne përdorim ndarjet  $a\mathbf{e}_0 = a_0(1 + \mathbf{a})$  dhe  $b\mathbf{e}_0 = b_0(1 + \mathbf{b})$  për të nxjerrë (kur  $\mathbf{e}_0^2 = 1$ )

$$a \wedge b = a_0 b_0 (\mathbf{a} - \mathbf{b} + \mathbf{b} \wedge \mathbf{a}) = a_0 b_0 (\mathbf{u} + \mathbf{a} \wedge \mathbf{u}).$$

Kjo paraqet një drejtëz me drejtim  $\mathbf{u} = \mathbf{a} - \mathbf{b}$  dhe moment  $\mathbf{M} = \mathbf{a} \wedge \mathbf{u} = \mathbf{b} \wedge \mathbf{a}$  që kalon përmes pikës  $\mathbf{a}$  në  $\mathcal{V}_n$ . Ky interpretim mund të verifikohet duke zbatuar një ndarje të ngjashme në ekuacionin  $x \wedge (a \wedge b)$  për drejtëzën, me rezultat

$$x \wedge a \wedge b = x_0 a_0 b_0 [(\mathbf{a} - \mathbf{x}) \wedge \mathbf{u} + \mathbf{x} \wedge \mathbf{a} \wedge \mathbf{u}] \mathbf{e}_0$$

Atëherë në  $\mathcal{G}_n$ , ekuacioni për drejtëzën është  $(\mathbf{x} - \mathbf{a}) \wedge \mathbf{u} = 0$ , dhe  $\mathbf{x} \wedge \mathbf{a} \wedge \mathbf{u} = 0$  është automatikisht i kënaqshëm. "Koordinatat e drejtëzës Plücker"  $a \wedge b = \mathbf{u} + \mathbf{M}$  janë aplikuar në mekanikë në sec. 7-1 të [7].

Për tri pika të dallueshme  $a, b, c$  në të njëjtën drejtëz, ndarja (4) prodhon raportin e pandryshuar

$$\frac{a \wedge c}{b \wedge c} = \frac{a_0}{b_0} \left[ \frac{\mathbf{a} - \mathbf{c}}{\mathbf{b} - \mathbf{c}} \right].$$

Ky është një projektim i pandryshuar në dy kuptime: ai është i pavarur në zgjedhjen e vektorit ndarës  $\mathbf{e}_0$ , dhe ai është i pandryshuar nën kolinearitë. Raporti i brendshëm  $(\mathbf{a} - \mathbf{b})/(\mathbf{b} - \mathbf{c})$  nuk është një projektim invariant.

Gjithsesi, raporti kryq invariant për katër pika të dallueshme  $a, b, c, d$  në të njëjtën drejtëz është dhënë nga

$$\left[ \frac{a \wedge c}{b \wedge c} \right] \left[ \frac{b \wedge d}{a \wedge d} \right] = \left[ \frac{a - c}{b - c} \right] \left[ \frac{b - d}{a - d} \right].$$

Të gjitha vetitë e njohura të raportit kryq janë nxjerrë thjeshtësisht nga ky barazim. Avantazhi i të përdorurit algjebërën gjeometrike këtu duket qartë. Ai siguron për shembull që pjestimi në (40) të jetë i mirë përcaktuar pavarësisht abuzimit me simbolikën.

## 6 Ndarja Konformale dhe Grupi Konformal

Algjebrat Gjeometrike mund të faktorizohen me anë të shumëzimit sipas teoremës themelore

$$\mathcal{G}_{n+2} = \mathcal{G}_n \otimes \mathcal{G}_2.$$

Produkti i Kronecker  $\otimes$  është përdorur këtu për të nënvizuar që të gjithë elementët e  $\mathcal{G}_2$  komutojnë me të gjithë elementët  $\mathcal{G}_n$ , por produkti është në fakt produkti gjeometrik i përkufizuar për  $\mathcal{G}_{n+2}$ . Mendohet se kjo teoremë nuk është shfrytëzuar në maksimum në aplikacione të algjebërës së Clifford sepse ka munguar një interpretim gjeometrik. Fakti që ndarja projektive nga një vektor lidh  $\mathcal{G}_{n+1}$  me  $\mathcal{G}_n$  sygjeron që mund të jetë përfutur nga një ndarje e ngjashme nga një 2-tehësh dhe kështu do të merrej një interpretim gjeometrik i ngjashëm. Rrjedhimisht, për analogji me (36) zgjedhim një 2-tehësh jo të vetëm  $\mathbf{e}_0$  në  $\mathcal{G}_{n+2}$  dhe për çdo  $x$  në  $\mathcal{V}_{n+2}$  realizojmë ndarjen

$$x\mathbf{e}_0 = x\mathbf{e}_0 + x \wedge \mathbf{e}_0 = x_0 + \rho\mathbf{x}$$

dhe përcaktojmë hapësirat vektoriale

$$\mathcal{V}_2 = \{x_0 = x \cdot \mathbf{e}_0 = -\mathbf{e}_0 \cdot x\},$$

$$\mathcal{V}_n = \{\rho\mathbf{x} = x \wedge \mathbf{e}_0 = \mathbf{e}_0 \wedge x\},$$

ku  $\mathbf{x}$  në bold dallon një vektor në  $\mathcal{V}_n$  nga vektoi korespondues  $x$  në  $\mathcal{V}_{n+2}$  dhe  $\rho$  është një faktor shkalle për tu përcaktuar. Vëmë re se elementët e  $\mathcal{V}_2$  padyshim komutojnë me elementët e  $\mathcal{V}_n$ . Kështu që algjebra gjeometrike që ata gjenerojnë kënaq barazimin (41) ashtu siç dëshirojmë. Gjithashtu,  $\mathcal{V}_2$  është një nënhapësirë 2-dimensionale e  $\mathcal{V}_{n+2}$  e përcaktuar nga  $\mathbf{e}_0$ , ndërsa  $\mathcal{V}_n$  është nënhapësira e 3-tehëshave në  $\mathcal{G}_{n+2}$  me  $\mathbf{e}_0$  si një faktor i përbashkët. Projektivisht, rrezet e  $\mathcal{V}_2$  janë pikat në drejtëzën  $\mathbf{e}_0$ , ndërsa  $\mathcal{V}_n$  është lapsi i të gjithë planeve që kalojnë përmes drejtëzës  $\mathbf{e}_0$ . Kështu që kemi një interpretim gjeometrik për ndarjen. Për të pasur një relacion preciz midis pikave në  $\mathcal{V}_n$  dhe  $\mathcal{V}_{n+2}$  kemi nevojë të impostojmë shtrëngime në dy shkallët e lirisë në  $\mathcal{V}_2$ . Ekziston një mënyrë natyrale për ta bërë këtë n.q.s. nënshkrimi i  $\mathcal{V}_2$

do të pranohej si [4]. e shprehur si  $\mathcal{V}_2 = \mathcal{V}(1,1)$ . Konsideracionet tona do të qëndrojnë për çdo nënshkrim  $(r,s)$  të  $\mathcal{V}_n = \mathcal{V}(r,s)$  si dhe në rastin  $\mathcal{V}_{n+2} = \mathcal{V}(r+1, s+1)$ . Në këtë këndvështrim do të quajmë ndarjen 2-tehësh (42) një ndarje konformale, për shkak të relacionit të tij me grupin konformal në  $\mathcal{V}_n$  të dhënë më sipër.

Për shkak të nënshkrimit të tij të papërcaktuar  $\mathcal{V}_2$  ka një bazë unike  $\mathbf{e}_+, \mathbf{e}_-$  vektorësh singular.  $\mathbf{e}_+^2 = \mathbf{e}_-^2 = 0$ . Është më praktike n.q.s. do ti normalizonim ato si

$$\frac{1}{2}\mathbf{e}_+\mathbf{e}_- = 1 + \mathbf{e}_0, \quad \text{ku } \mathbf{e}_0^2 = 1.$$

Tani vlera e  $x_0 = x \cdot \mathbf{e}_0$  mund të lidhet me  $\mathbf{x}$  në (42) duke patur parasysh kushtin fillestar  $x^2 = 0$ . Si rrjedhim, (42) mund të sillet në formën

$$2x\mathbf{e}_0 = x \cdot \mathbf{e}_+(\mathbf{e}_- + \mathbf{x}^2\mathbf{e}_+ + 2\mathbf{x}).$$

Vëmë re se forma funksionale e faktorit shkallë  $\rho = x \cdot \mathbf{e}_+$  në (42) tani është e përcaktuar dhe për më tepër luan rolin e një koordinate homogjene. Atëherë, nga (46) çdo vektor  $x$  në  $\mathcal{V}_n$  korespondon me një rreze të vetme në konin nul  $x^2 = 0$  të  $\mathcal{V}_{n+2}$ . Kjo mund të jetë paraqitja ideale për një shtjellim sistematik të teorisë projektive për formën kuadratike, por kjo ngelet për tu parë.

Ekuacioni kuadratik  $x^2 = 0$  është një invariant i grupit ortogonal  $\mathbf{O}(r+1, s+1)$  në  $\mathcal{V}_{n+2}$ . Çdo transformim ortogonal mund të vendoset në formën kanonike

$$x' = Gx(G^{-1})^*,$$

ku  $G$  është një versor në  $\mathcal{G}_{n+2}$  dhe  $G^*$  është involute i  $G$ . Një versor  $G$  është një multivektor i cili mund të shprehet si produkt gjeometrik.

$$G = \pm a_1 a_2 \cdots a_k$$

vektorësh jo singularë. Themi se versori  $G$  ka barazi tek n.q.s.  $G^* = (-1)^k G = -G$  ose barazi çift n.q.s.  $G^* = G$ . Versorët formojnë grupin e shumëzimit  $\text{Pin}(r+1, s+1)$  të quajtur grupi pin i  $\mathcal{V}_{n+2}$ . Versorët e barazisë çift formojnë një nëngrup  $\text{Spin}(r+1, s+1)$  të quajtur grupi spin i  $\mathcal{V}_{n+2}$ . Transformimi është quajtur një rrotullim n.q.s.  $G$  ka barazi çift. Grupi i rrotullimeve është grupi ortogonal special  $\text{SO}(r+1, s+1)$ . [7]

Transformimi ortogonal  $x \rightarrow x'$  i indukon një transformim  $\mathbf{x} \rightarrow \mathbf{x}' = g(\mathbf{x})$  të  $\mathcal{V}_n$ . Një relacion despicit midis  $G$  dhe  $g$  është përfutur nga kombinimi i tyre.

$$G(\mathbf{e}_- + \mathbf{x}^2 \mathbf{e}_+ + 2\mathbf{x})\hat{G} = \sigma_g[\mathbf{e}_- + [g(\mathbf{x})]^2 \mathbf{e}_+ + 2g(\mathbf{x})],$$

ku  $\hat{G} = \mathbf{e}_0(G^{-1})^* \mathbf{e}_0$  dhe  $\sigma_g = \sigma_g(\mathbf{x}) = \mathbf{x}' \cdot \frac{\mathbf{e}_+}{x} \cdot \mathbf{e}_+$ . Ky ekuacion mund të zgjidhet për  $g$  si një funksion eksplisit të  $G$  n.q.s.  $G$  është shprehur në një formë e cila në mënyrë eksplícite dallon pjesët e tij në  $G_2$  dhe  $G_n$ . Forma e përgjithshme më e përshtatshme duket se është

$$G = \frac{1}{2}[A(1 + \mathbf{e}_0) + B\mathbf{e}_+ + C\mathbf{e}_- + D(1 - \mathbf{e}_0)],$$

ku  $A, B, C, D$  janë versorë në  $G_n$ , kështu që komutojnë me  $\mathbf{e}_+, \mathbf{e}_-, \mathbf{e}_0$ . Nga [5], është e qartë që  $A$  dhe  $D$  mund të kenë të njëjtën barazi n.q.s.  $C$  dhe  $D$  kanë barazi të kundërta. Për më tepër, vetia e grupit  $GG^{-1} = 1$  [3], sjell që

$$A\tilde{D} - B\tilde{C} = \pm 1$$

dhe  $\tilde{A}B, \tilde{A}C, D\tilde{B}, D\tilde{C}$  janë në  $\mathcal{V}_n$ , ku  $\tilde{A} = (A^*)^\dagger$  është i anasjelli në  $G_n$ . Zgjidhja [4], për  $g$  është më e thjeshtë dhe elegante e shprehur si një transformim homografik:

$$g(\mathbf{x}) = (A\mathbf{x} + B)(C\mathbf{x} + D)^{-1}.$$

Mund të verifikohet që  $g$  është një transformim konformal ose  $\mathcal{V}_n = \mathcal{V}(r, s)$  dhe për renditjen e koeficientëve të lejuar nga [1], jep grupin e plotë konformal  $C(r, s)$ . Kështu, kemi stabilizuar 2 në 1 homomorfizmat midis  $Pin(r + 1, s + 1)$  dhe  $C(r, s)$ . Korrespondenca midis elementëve në dy grupet është dhënë nga [7], dhe [6]. Një paraqitje për  $G$  që është më pak e fryrë në lidhje me [7], mund të përftohet nga adoptimi i një matrice  $2 \times 2$  të paraqitur për  $\mathbf{e}_\mu$  e cila vendos [8], në një formë matricore të përdorur nga Ahlfors [13]:

$$[g] = \begin{bmatrix} A & B \\ C & D \end{bmatrix}.$$

Kjo ka avantazhin që grupi kompozim mund të transmetohet me anë të shumëzimit matricor. Ai ka dizavantazhin e fshehjes së varësisë në  $\mathbf{e}_+, \mathbf{e}_-$  dhe  $\mathbf{e}_0$  së bashku me strukturën gjeometrike që nënkupton. Kjo është evidente në tabelën 1 e cila paraqet element fillestarë të grupeve nga të cilët mund të gjenerohen të gjithë elementët e tjerë. Versorët me barazi çift në Tabelën 1 gjenerojnë grupin  $Spin(r + 1, s + 1)$ . Vëmë re se  $\mathbf{e}_0$  është i vetmi nga këta elementë i cili nuk është në mënyrë të vazhdueshme i lidhur me identikun. Me  $\mathbf{e}_0$  të përjashtuar  $Spin(r + 1, s + 1)$  është një paraqitje rrotullimi i grupit special konformal  $SC(r, s)$ . Çdo element në grup mund

të paraqitet në formë kanonikale  $G = \pm K_a T_b D_\lambda R$  ku  $R = R^*$ . Kjo ka paraqitjen matricore

$$[K_a T_b D_\lambda R] = \begin{bmatrix} \lambda R & \mathbf{b}\lambda^{-1}R \\ \mathbf{a}\lambda R & (1 + \mathbf{a}\mathbf{b})\lambda^{-1}R \end{bmatrix},$$

e cila e lidh atë në mënyrë direkte me  $g$  nga (52). Në grupin pin, transversioni mund të reduktohet në një kompozim të dy të anasjellëve nga  $K_b = \mathbf{e}_1 T_b \mathbf{e}_1$ . Matematikanët kanë konsideruar paraqitjen pin dhe spin të grupit konformal më parë me një sërë qasjesh të ndryshme ([1],[4],[5]). Mendoj se qasja e tanishme ka avantazhin e një qartësie më të madhe gjeometrike, që bashkon avantazhet e qasjeve të mëparshme, duke treguar se si ato janë të ndërlidhura [10]. Paraqitjet spin të grupit konformal për hapësirën kohë ka qënë i konsideruar nga fizikanët në disa artikuj (për shembull, [6]).

**Tabela 1.** Korespondenca midis elementëve të gjeneruar të  $Pin(r + 1, s + 1)$  dhe grupit të plotë konformal  $C(r, s)$ .

| Tipi        | Grup element                                                                                           |                                                                               |
|-------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------|
| konformal   | $g(\mathbf{x})$                                                                                        | $\Leftrightarrow \pm G$                                                       |
| ortogonal   | $R\mathbf{x}R^{-1}$                                                                                    | $R = \mathbf{a}_1 \mathbf{a}_2 \cdots \mathbf{a}_k$                           |
| zhvendosja  | $\mathbf{x} + \mathbf{a}$                                                                              | $T_a = 1 + \frac{1}{2}\mathbf{a}\mathbf{e}_+$                                 |
| zgjerim     | $\lambda^2 \mathbf{x}$                                                                                 | $D_\lambda = \mathbf{e}^{\varphi \mathbf{e}_0}, \lambda = \mathbf{e}^\varphi$ |
| tërthortë   | $\frac{\mathbf{x} + \mathbf{b}\mathbf{x}^2}{1 + \mathbf{b}\cdot\mathbf{x} + \mathbf{b}^2\mathbf{x}^2}$ | $K_b = 1 + \frac{1}{2}\mathbf{b}\mathbf{e}_-$                                 |
| i anasjelli | $\mathbf{x}^{-1}$                                                                                      | $\mathbf{e}_1 = \frac{1}{2}(\mathbf{e}_+ + \mathbf{e}_-)$                     |
| i kundërti  | $-\mathbf{x}$                                                                                          | $\mathbf{e}_0$                                                                |

## Përfundime

Shumica e njerëzve që punojnë në grafikë kompjuterike janë të njohur me koordinatat homogjene katërdimensionale, dhe algjebra projektive Grassmann e zgjeron këtë koncept në një strukturë më të madhe algjebrike nën të cilën kryhen manipulime gjeometrike të pikave, vijave dhe planeve.

Algjebra gjeometrike na njeh me dy koncepte të reja. Së pari ajo pranon se një vector është një nënhapësirë 1-dimensionale dhe për rrjedhojë do të ketë pa dyshim nënhapësira të tilla edhe të rendeve më të larta.

**Bibliografi:**

- [1] R. Abłamowicz. Clifford algebra computations with maple.
- [2] R. Abłamowicz and B. Fauser. The CLIFFORD home page. 2002.
- [3] D. Hestenes and R. Ziegler, *Projective Geometry with Cli@ord Algebra*, (submitted).
- [4] A. N. Whitehead, *A Treatise on Universal Algebra with Applications*.
- [5] J. Browne. The grassmannalgebra book home page. HTML document, 2002.
- [6] William K. Clifford. On the classification of geometric algebras.
- [7] D. Hestenes and G. Sobczyk, *Cli@ord Algebra to Geometric Calculus*,
- [8] L. Dorst, C. Doran, and J. Lasenby, editors. *Applications of Geometric Algebra in Computer Science and Engineering*. Birkh 2002.

# Rendesia e Algoritmit Gjenetik në zgjidhjen e sistemeve të ekuacioneve lineare

**Studente Sabrina Habibi**

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë  
Fakulteti i Shkencav Teknike , Departamenti i Matematikes  
sabrina.habibi@univlora.edu.al

## Abstrakt

Algoritmet Gjenetike (GA) janë një klasë e algoritmeve të optimizimit. Algoritmet Gjenetike "perpiqen" për zgjidhjen e problemeve nepermjet modelimit të një versioni të thjeshtuar të procesit gjenetik. Ekzistojnë probleme të ndryshme në matematikë ku një qasje e Algoritmit Gjenetike është tepër e dobishme. Ky artikull propozon zgjidhjen e sistemeve të ekuacioneve lineare duke i transformuar ato në problem optimizimi. Algoritmet Gjenetike janë të shkelqyera për të gjitha detyrat që kërkojnë optimizimin dhe shume efektive në cdo situatë.

## Abstract

Genetic Algorithms (GA's) are a class of optimization algorithms. Genetic Algorithms (GA's) attempt to solve problems through modeling a simplified version of genetic process. There are many problems for which a GA approach is useful. This paper proposes to solve linear systems of equations by transforming the linear system of equations into an optimization problem. Genetic Algorithms (GA's) are excellent for all tasks requiring optimization and highly effective in any situations.

**Fjalët kyçe:** *Sisteme të ekuacioneve lineare, Algoritmi Gjenetik, optimizim*

## 1. Hyrje

Sisteme të ekuacioneve lineare është një i dytë ose më shumë ekuacioneve lineare. Këto sisteme luajnë një rol të rëndësishëm në pothuajse të gjitha fushat e inxhinierisë si dhe fusha e shkencave. Disa shembuj të problemeve në shkencë dhe inxhinieri ku kërkojnë zgjidhje sistemet e ekuacioneve lineare janë: robotika, projektimi strukturor, përpunimi i sinjalit, etj.,. Gjatë zgjidhjes së sistemeve të ekuacioneve lineare kërkohet gjetja e zgjidhjes optimale. Për zgjidhjen e sistemeve të ekuacioneve lineare ekzistojnë disa teknika të njohura si p.sh: zgjidhja grafike, metoda e zëvendësimit, metoda e eliminimit, zgjidhja duke përdorur Gauss, zgjidhja duke përdorur Gauss – Jordani, rregulli i Carmer, etj.,. Këto metoda numerike nuk janë universale të zbatueshme dhe mbi të gjitha nuk mund të garantojnë një zgjidhje korrekte të këtyre sistemeve. Ndaj propozohet një strukturë e thjeshtë e cila bazohet mbi algoritmin gjenetik. Algoritmet Gjenetike janë të shkelqyera për të gjitha detyrat që kërkojnë optimizimin. Për gjetjen e zgjidhjes me të mirë si dhe me të saktë, është e nevojshme kryerja e disa operacioneve mbi cdo zgjidhje optimale.

## 2. Algoritmi Gjenetik

Termat kryesorë mbi Algoritmin Gjenetik dhe shpjegimi i secilit prej tyre:

- a) **Gjen** – nje kodim i nje pjese se hapësirës se zgjidhjes kandidate.
- b) **Kromozom** – nje varg gjenesh qe përfaqësojnë një zgjidhje.
- c) **Popullsia** – numri i kromozomeve te disponueshme për testim .
- d) **Pershtatja** – llogaritjet per cdo individ , ndihmon ne ruajtjen e diversitetit ndërmjet individëve të ngjashëm, normalion shkalëzimin linear , redukton aftësinë për individët që janë të ngjashëm me individët e tjerë në popullatë.
- e) **Zgjedhja** – përcakton mënyrën e zgjedhjes së individëve bazuar ne rezultatet e tyre te *fitness*.

Ne Algoritmin Gjenetik procesi është si në paraqitjen e mëposhtme:

**Hapi 1 :** Përcakton numrin e kromozomeve dhe gjeneve.

**Hapi 2 :** Gjeneron numrin kromozom dhe inicializon vlerat.

**Hapi 3 :** Përpunin hapat 4 - 7 deri sa të plotësohet numri i gjeneve .

**Hapi 4 :** Vlerësimi i vlerës së përshtatshmërisë së kromozomeve .

**Hapi 5 :** Zgjedhja e kromozomeve .

**Hapi 6 :** Mutacioni

**Hapi 7 :** Pasardhësit

**Hapi 8 .** Zgjidhja.

### 2.1 Kodi i Algoritmit gjenetik.

Me poshte paraqitet nje kod i cili përcakton menyren e punimit te nje Algoritmi Gjenetik duke filluar qe nga përcaktimi i popullsisë deri te zgjidhja:

begin

$t=0$

initialize  $P_t$

evaluate  $P_t$

while do

begin

$t=t + 1$

select  $P_t$  from  $P_{t-1}$

mutate  $P_t$


evaluate  $P_t$

end

end

### 2.2 Bllok –Skema perkatese e Algoritmit Gjenetik:

Me poshte jepet paraqitja vizuale e kodit i cili përcakton menyren e punimit te nje Algoritmi Gjenetik:



### 3. Sistemet e ekuacioneve lineare.

Nje ekuacion linear me ndryshore  $(x_1, x_2, \dots, x_n)$  ka formen e paraqitur me poshte:

$$a_1x_1 + a_2x_2 + ..... + a_nx_n = d$$

ku numrat :  $a_1, a_2, a_n \in R$  jane koeficientet e ekuacionit dhe  $d \in R$  është një konstante . n- elementet e rradhitur  $(s_1, s_2, ..., s_n) \in R^n$  jane zgjidhje e ekuacionit ne qofte se duke zevendesuar numrat  $s_1, s_2, ..., s_n$  ne vend te ndryshoreve , atëhere ai kthehet ne nje barazim numerik te vertete :  $a_1s_1 + a_2s_2 + ..... + a_ns_n = d$ .

Bashkësia e dy ose me shume ekuacioneve lineare formon sistemin e ekuacioneve lineare. N je sistem linear ekuacionesh

$$\begin{cases} a_{1,1}x_1 + a_{1,2}x_2 + ..... + a_{1,n}x_n = b_1 \\ a_{2,1}x_1 + a_{2,2}x_2 + ..... + a_{2,n}x_n = b_2 \\ a_{m,1}x_1 + a_{m,2}x_2 + ..... + a_{m,n}x_n = b_m \end{cases}$$

ka zgjidhje  $(s_1, s_2, ..., s_n)$  në qoftë se n-elementët e radhitur janë zgjidhje e të gjithë ekuacioneve te sistemit .

Le te jetë dhënë një sistem linear me m ekuacione dhe n te panjohura si me sipër Per zgjidhjen e nje sistemin linear te tille duhet ta shkruajme kete sisem ne formen e matricës së meposhtme :

$$Ax=b$$

$$\text{ku } A = \begin{bmatrix} a_{1,1} & a_{1,2} & \dots & a_{1,n} \\ a_{2,1} & a_{2,2} & \dots & a_{2,n} \\ \vdots & \vdots & \ddots & \vdots \\ a_{m,1} & a_{m,2} & \dots & a_{m,n} \end{bmatrix}, x = \begin{bmatrix} x_1 \\ x_2 \\ \vdots \\ x_m \end{bmatrix},$$

$$b = \begin{bmatrix} b_1 \\ b_2 \\ \vdots \\ b_m \end{bmatrix}$$

#### 4. Algoritmet Gjenetike per zgjidhjen e sistemeve lineare te ekuacioneve .

Algoritmet Gjenetike kerkojne ne nje popullsi zgjidhjesh , perdorin funksionet *fitness (fitness function)* dhe perdorin rregullat tranzicion.




Fig.1 Struktura e rrjetit nervor e cila perdor Algoritmin Gjenetik per rikuperimin e inputeve .

Le te jene  $P(t)$  dhe  $C(t)$  prindër dhe pasardhës në një gjenerim aktual t . Struktura e përgjithshme e gjenetikës algoritmike pershkruhet si me poshte :

#### begin

Initialize  $P(t)$  ;

evaluate  $P(t)$  ;

#### while do

recombine  $P(t)$  to yield  $C(t)$  ;

evaluate  $C(t)$  ;

select  $P(t+1)$  from  $P(t)$  and  $C(t)$  ;

$t = t + 1$

#### end

#### end

#### 5. Eksperimenti

Zgjidhja e nje ekuacioni linear duke perdorur Algoritmin Gjenetik :

Ekuacioni :  $2a + b + 3c = 13$ . Perdorim Algoritmin Gjenetik per zgjidhjen e ketij ekuacioni , pra per gjetjen e vlerave a , b , c te cilat kenaqin kete ekuacion. Fillimisht per zgjidhjen e ketij sistemi se pari duhet te formojme funksionin objektiv. Per kete probleem objektivi kryesor eshte minimizimi i vleres se funksionit  $f(x)$  ku  $f(x) = ((2a + b + 3c) - 13)$ . Per shpejtim te procesit te punes , mund te kufizojme intervalin e vlerave te variablave a , b , c . Variablat a , b , c , jane numra te plote midis 0 – 10.

Fillojme me procesin e zgjidhjes se problemit hap pas hapi :

**Hapi 1.** Percaktojmë numrin e kromosomeve në popullatë të cilat është 6 dhe gjenerojmë vlera të rastësishme të gjeneve a, b, c, për 6 kromosome.

Kromozomi [1] = [a;b;c] = [9;0;3]

Kromozomi [2] = [a;b;c] = [3;1;3]

Kromozomi [3] = [a;b;c] = [4;1;3]

Kromozomi [4] = [a;b;c] = [5;2;3]

Kromozomi [5] = [a;b;c] = [1;4;9]

Kromozomi [6] = [a;b;c] = [2;1;6]

**Hapi 2 :** Llogaritja e vlerës së funksionit objektiv për çdo kromozom :

$$\begin{aligned} F_{\text{obj}}[1] &= \text{Abs}((2*9 + 1*0 + 3*3) - 13) \\ &= \text{Abs}((18 + 0 + 9) - 13) \end{aligned}$$

$$= \text{Abs}((27) - 13) = 14$$

$$\begin{aligned} F_{\text{obj}}[2] &= \text{Abs}((2*3 + 1*1 + 3*3) - 13) \\ &= \text{Abs}((6 + 1 + 9) - 13) \\ &= \text{Abs}((16) - 13) = 3 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned} F_{\text{obj}}[3] &= \text{Abs}((2*4 + 1*1 + 3*3) - 13) \\ &= \text{Abs}((8 + 1 + 9) - 13) \\ &= \text{Abs}((18) - 13) = 5 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned} F_{\text{obj}}[4] &= \text{Abs}((2*5 + 1*2 + 3*3) - 13) \\ &= \text{Abs}((10 + 2 + 9) - 13) \\ &= \text{Abs}((21) - 13) = 8 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned} F_{\text{obj}}[5] &= \text{Abs}((2*1 + 1*4 + 3*9) - 13) \\ &= \text{Abs}((2 + 4 + 27) - 13) \\ &= \text{Abs}((33) - 13) = 20 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned} F_{\text{obj}}[6] &= \text{Abs}((2*2 + 1*1 + 3*6) - 13) \\ &= \text{Abs}((4 + 1 + 18) - 13) \\ &= \text{Abs}((23) - 13) = 10 \end{aligned}$$

**Hapi 3 :** Përzgjedhja . Kromozomet me të forta kanë probabilitet me të lartë për t'u përzgjedhur ,

ndaj duhet të llogarisim përshtatshërinë e secilit kromozom për llogaritjen e probabiliteteve .

$$\text{Fitness}[1] = 1 / (1 + F_{\text{obj}}[1]) = 1/15 = 0.06$$

$$\text{Fitness}[2] = 1 / (1 + F_{\text{obj}}[2]) = 1/4 = 0.19$$

$$\text{Fitness}[3] = 1 / (1 + F_{\text{obj}}[3]) = 1/6 = 0.16$$

$$\text{Fitness}[4] = 1 / (1 + F_{\text{obj}}[4]) = 1/9 = 0.1$$

$$\text{Fitness}[5] = 1 / (1 + F_{\text{obj}}[5]) = 1/21 = 0.042$$

$$\text{Fitness}[6] = 1 / (1 + F_{\text{obj}}[6]) = 1/11 = 0.07$$

$$\text{Total} : 0.06 + 0.19 + 0.16 + 0.1 + 0.042 + 0.07 = 0.89$$

Llogaris probabilitetin për çdo kromozom :

$$P[i] = \text{Fitness}[i] / \text{Total}$$

$$P[1] = \text{Fitness}[1] / 0.89 = 0.06$$

$$P[2] = \text{Fitness}[2] / 0.89 = 0.21$$

$$P[3] = \text{Fitness}[3] / 0.89 = 0.18$$

$$P[4] = \text{Fitness}[4] / 0.89 = 0.11$$

$$P[5] = \text{Fitness}[5] / 0.89 = 0.39$$

$$P[6] = \text{Fitness}[6] / 0.89 = 0.07$$

Nga probabilitetet e përlogaritura me sipër arrijmë në konkluzionin se Kromozomi [ 5] ka përshtatshmerinë me të lartë . Për vazhdimin e procesit të përzgjedhjes na duhet të llogarisim probabilitetin grumbullues të vlerave si e poshtë :

$$C[1] = 0.06$$

$$C[2] = 0.06 + 0.21 = 0.27$$

$$C[3] = 0.27 + 0.18 = 0.45$$

$$C[4] = 0.11 + 0.45 = 0.56$$

$$C[5] = 0.39 + 0.56 = 0.95$$

$$C[6] = 0.07 + 0.95 = 1.0$$

Pasi kemi llogaritur probabilitetin grumbullues të vlerave të kromosomeve , procesi gjeneron vlerën R si më poshtë :

R[1] = 0.201

end;

R[2] = 0.284

end;

R[2] = 0.0999

Kromozomi k do te perzgjidhet si "prind" nese  $R[k] < pc$ . Fillimisht vendosim per shkallen e kryqezimit per vlerën 25%. Atëhere numri i kromozomit k do te zgjidhet per kryqëzim nese vlera e krijuar per kromozomin k eshte nën 25%. Procesi vijon si më poshtë :

R[4] = 0.822

R[5] = 0.398

R[6] = 0.501

Nese numri R[1] eshte me i madh se C[1] dhe me i vogel se C[2] atehere zgjedhim Kromozomin [2] si nje kromozom ne popullaten e re .

R[1] = 0.06

R[2] = 0.145

R[3] = 0.672

R[4] = 0.874

R[5] = 0.032

R[6] = 0.575

Kromozomi i ri [1] = Kromozomin[2]

Kromozomi i ri [2] = Kromozomin[3]

Kromozomi i ri [3] = Kromozomin[1]

Kromozomi i ri [4] = Kromozomin[6]

Kromozomi i ri [5] = Kromozomin[3]

Kromozomi i ri [6] = Kromozomin[4]

Nga numri R i llogaritur me sipër arrijmë në konkluzionin se "prinderit" e përzgjedhur për kryqëzim janë : Kromozomi [1] , Kromozomi [2] dhe Kromozomi [5] .

Kromozomi [1] = [a;b;c] = [3;1;3]

Pas procesit te përzgjedhjes së kromozomeve , procesi tjetër është percaktimi i pozicionit të pikës së kryqezimit . Kjo behet duke gjeneruar numra të rastësishëm.

Kromozomi [2] = [a;b;c] = [4;1;3]

Në programet e edukimit të mësuesve, mikromësimdhënia në veçanti, është bërë një strategji e zakonshme mësimore. Mund të bëhet një mjet i dobishëm për mësuesit për të përmirësuar teknikat e tyre mësimore nëse përdoret në mënyrë efektive, korrekte dhe me vizion. Është e rëndësishme që t'u ofrohet si opsion mësuesve të ardhshëm për të krijuar besim dhe një përvojë "praktike". Mikromësimdhënia është një metodë e shkëlqyer për të arritur këtë objektivi. Është një metodë e përgatitjes së mësuesve të ardhshëm që u mundëson të vënë në praktikë aftësitë e mësimdhënies dhe t'i zhvillojnë ato në një mjedis të sigurt dhe të simuluar siç është klasa. Përpara se të vënë në praktikë metodat e reja të sapomësuar teorike të mësimdhënies në klasë, mësuesit e ardhshëm mund t'i përsosin ato përmes këtyre sesioneve praktike. Gjithashtu, duke marrë pjesë në sesionet e mikromësimdhënies, studentët mësues mund të përgatiten për një sërë situatash, duke përfshirë punën me nxënës me nivele aftësish dhe prejardhesh kulturore të ndryshme, krijimin e planeve mësimore, korrigjimin e gabimeve, trajtimin e çështjeve të sjelljes, të kuptuarit e kompetencave dixhitale, etj. Ky studim vendos theksin te mënyra sesi funksionon mikromësimdhënia në klasat e gjuhës së huaj, si ofron mundësi të dobishme për 'peer' vlerësimin dhe vetëvlerësim dhe se si u jep studentëve

mësues një shans për të zotëruar secilën teknikë duke planifikuar dhe zhvilluar të njëjtën orë mësimi disa herë dhe duke bërë rregullime e ndryshime, në sajë të 'feedback'-ut të kolegëve dhe tutorëve. Përvoja e diskutuar në këtë punim është pjesë e seminareve të përditshme në klasat e Masterit, në kurset e trajnimit të mësuesve të ardhshëm në Universitetin e Vlorës.

**Fjalët çelës/ kyçe:** *mikromësimdhënia, vetëvlerësim, feedback, skenarë klasash, mësuesit e ardhshëm*

**Micro-teaching**<sup>1</sup> is a teacher training and faculty development technique whereby the teacher reviews a recording of a teaching session, in order to get constructive feedback from peers and/or students about what has worked and what improvements can be made to their teaching technique. Dwight W. Allen created micro-teaching at Stanford University in 1963, and it has since been applied to train teachers across many subject areas.

### 1. History and Literature Review

Researchers from throughout the world have spent years studying the role of microteaching in programs for teacher preparation. (Fernandez, 2010; Lu, 2010; Seferoglu, 2006; Akalin, 2005; Higgins and Nicholl, 2003; Wilkinson, 1996). Microteaching was first implemented in a teacher education program at Stanford University in the 1960s to help students be ready for their clinical experiences (Cruickshank et al., 1996). The practice of microteaching has quickly spread to other teacher education programs since it was first introduced in the 1960s.

Recently, the microteaching component has been included to many pre-service teacher education programs in order to orient future educators and give them hands-on teaching practice (Fernandez, 2010; Bell, 2007; Amobi, 2005). (In the original procedure, a teacher was asked to prepare a brief lecture (about 20 minutes) for a group of students who might not have been his or her own pupils. Then a video of this was taken. Following the lesson, the teacher, teaching assistants, a master teacher, and the students all watched the footage together and made comments on what they saw, citing the teacher's learning objectives. Teachers typically get an acute "under the microscope" view of their teaching after watching the film and receiving feedback from peers and students.)

Microteaching uses actual classroom situations to assist students learn new abilities and gain a

deeper understanding of the teaching craft. This Stanford method involved the steps of "plan, teach, observe, re-plan, re-teach, and re-observe," and it has become the core element in 91% of teaching development programs due to the significant reduction in the complexity of teaching with respect to:

- the size of the class (referring to the number of students in a class)
- the range of the material (range of its curriculum)
- the period of time

### 2. Microteaching has several advantages over traditional teaching methods:

- Trainers can develop their organizational and planning skills
- Teachers can concentrate on particular techniques and skills
- Microteaching offers the chance for quick feedback. One's teaching abilities can be greatly enhanced by receiving feedback from peers or mentors.
- Teachers get the chance to try out novel teaching techniques and ideas when they use microteaching. They can use experimentation to discover new teaching strategies that are more efficient than their current ones.
- Teachers can record lessons during microteaching sessions and review them later to see areas that need improvement.
- Microteaching boosts self-assurance by progressively raising the bar. In a low-pressure environment, instructors can experiment with new information or concepts. This can help when introducing a new topic to students because it lowers anxiety and boosts confidence.

### 2. Microteaching Disadvantages

#### Microteaching also has some disadvantages:

- Trainers can develop their organizational and planning skills
- Teachers can concentrate on particular techniques and skills
- Microteaching offers the chance for quick feedback. One's teaching abilities can be greatly enhanced by receiving feedback from peers or mentors.
- Teachers get the chance to try out novel teaching techniques and ideas when they use microteaching. They can use

<sup>1</sup> <https://en.wikipedia.org/wiki/Microteaching>

experimentation to discover new teaching strategies that are more efficient than their current ones.

- Teachers can record lessons during microteaching sessions and review them later to see areas that need improvement.
- Microteaching boosts self-assurance by progressively raising the bar. In a low-pressure environment, instructors can experiment with new information or concepts. This can help when introducing a new topic to students because it lowers anxiety and boosts confidence.

### 3. Microteaching Disadvantages

**Microteaching also has some disadvantages:**

- Setting up and running a microteaching session can take some time; that means, time-consuming
- Microteaching might be difficult if the subject matter is complex or if there are a lot of students in the classroom. In these situations, it could be challenging to cover the subject adequately in the brief time given for the microteaching lesson.
- Both teachers and students may find the microteaching approach to be monotonous and repetitious.
- Developing realistic instructional scenarios might be challenging. In a traditional classroom context, it can be challenging to recreate microteaching. This is due to the fact that microteaching frequently takes place in a structured setting with few interruptions. There are a lot more factors that can affect a lesson's performance in a typical classroom. What's effective in a microteaching environment might not always be effective in a typical classroom setting.
- Receiving valid feedback from microteaching students can be difficult

### 4. Micro-teaching cycle:



### Classroom Instruction

First, through lectures, textbooks, and demonstrations, student instructors gain an understanding of the fundamentals of a single lesson (via an instructor or video lessons). Communication, explanation, lecturing, and student engagement are among the skills learned. They might also involve planning, giving examples to illustrate teaching sessions and responding questions from students.

### Lesson Planning

The student teacher then, designs a brief lesson that will give them the opportunity to put these new abilities in use in a simulated classroom setting. Although the classroom setting is simulated, student teachers should treat their presentation as a genuine lesson and deliver it in a way that is interesting, logical, and easy to grasp.

### Teaching and Feedback

The lesson is delivered by the student teacher in front of their instructor and peers. The session is taped so the student teacher can revisit it at a later time and evaluate themselves. The student teacher gets feedback from their mentor and peers right away after the microteaching session.


Peer criticism should be constructive, explicit, and balanced (i.e., it should note both the student teacher's strengths and flaws). Peers find it useful when they use "I" statements to concentrate on their own experiences and to give detailed comments.

### Re-plan and Re teach

The student teacher organizes and delivers the same lesson a second time based on feedback from peers and on their self- assessment of the performance. In order to perfect the skill being practiced, it is important to take into consideration, comments from the initial microteaching session . There is also a recording of the second class. Following the session, the student teacher can watch the recording for self-evaluation and receive feedback from the instructor and peers.

### Microteaching Topics in practice:

Microteaching has become a very popular instructional method despite these disadvantages, particularly in teacher education programs. How to start with micro-teaching? Our advice here, is to set some ideas and topics. What to be included in micro-teaching? So the first step is finding a topic. For example, while handling lectures on Methodology of language teaching, students enter deeply into each method, through 'hands on experience', by having microteaching sessions for each method. Here it's the way we organize it:



### Microteaching Examples:

**Lecture 5 The Direct Method**

Veseranda Hajrulla - Dec 6

The Direct Method PowerPoint

Direct Method for Language... YouTube video 3 minutes

Class comments

Assignment nr 3: Prepare a 15 minute Micro teaching session, on using CALL in the language classroom.

0 Turned in 17 Assigned

All

Albjon Papos Assigned

Amshela Alushaj Assigned

Arti Abazaj Assigned

Denelita Allog Assigned

Elena Musaku Assigned

Elvira Zaho Assigned

Endri Tehraj Assigned

luglen carriot Assigned

Prepare a 15 minute presentation of yours, on Teaching Listening / Grammar

2 Turned in 14 Assigned

All

luglen carriot Turned in

Pranvora Rrokaj Turned in

Albjon Papos No attachments Missing

Amshela Alushaj No attachments Missing

Arti Abazaj

Elena Musaku

Elvira Zaho

Endri Tehraj

### From these experiences we came to understand that:

- microteaching provides ongoing training for our student teachers
- retraining for classroom teachers in a simulated environment.
- these practice sessions enable student teachers to perfect their teaching techniques before applying them in the real classroom.
- allow student teachers to prepare for a variety of classroom scenarios, including working with students of different skill levels and backgrounds.
- microteaching provides valuable opportunities for self-evaluation and peer feedback.

### Conclusion

From our yearly experience, with MA students, we come to the conclusion that microteaching results in better-prepared, more confident teachers with strong working & understanding of the skills they need in the classroom.

Microteaching encourages 'hands-on' teaching experiences thanks to its track record of success with inexperienced teachers. The fundamentals of microteaching, such as presentation and reinforcement techniques, lessen and diminish inexperienced teachers' uneasiness and embarrassment thorough acquisition of the craft of instruction.

### References:

- Akalin, S. (2005). Comparison between traditional teaching and microteaching during school experience of student teacher. *Euroasian Journal of Educational Research*, 20, 1-13.
- Amobi, F. A. (2005). Pre-service teachers' reflectivity on the sequence and consequences of teaching actions in a microteaching experience. *Teacher Education Quarterly*, 32(1), 115-128.
- Amobi, F. A., and Irwin, L. (2009). Implementing on-campus microteaching to elicit pre-service teachers' reflection on teaching actions: Fresh perspective on an established practice. *Journal of the Scholarship of Teaching and Learning*, 9(1), 27- 34.
- Benton-Kupper, J. (2001). The microteaching experience: Student perspectives. *Education*, 121(4), 830-835.
- Britton, L. R., and Anderson, K. A. (2010). Peer coaching and pre-service teachers: Examining an underutilized concept. *Teaching and Teacher Education*, 26(2), 306-314.
- Butler, A. (2001). Pre-service music teachers' conceptions of teaching effectiveness, microteaching experiences and teaching performance. *Journal of Research in Music Education*, 49(3), 258-272.
- Cruickshank, D. R., et al. (1996). *Preparing America's Teachers*. Bloomington, IN: Phi Delta Kappa.
- Feiman-Nemser, S. (2001). From preparation to practice: designing a continuum to strengthen and sustain teaching. *Teachers College Record*, 103(6), 1013-1055.
- Fernandez, M. L., and Robinson, M. (2007). Prospective teachers' perspectives on microteaching lesson study. *Education*, 127(2), 203-215.
- Fry, J. M., and Hin, M. K. T. (2006). Peer coaching with interactive wireless technology between student teachers: Satisfaction with role and communication. *Interactive Learning Environments*, 14(3), 193-204.

11. Higgins, A., and Nicholl, H. (2003). The experiences of lecturers and students in the use of microteaching as a teaching strategy. *Nurse Education in Practice*, 3( 4), 220-227.
12. Karckay, A. T., and Sanli, S. (2009). The effect of microteaching application on the pre-service teachers" teacher competency levels. *Procedia Social and Behavioral Sciences*, 1(1), 844-847.
13. Kubukcu, F. (2010). Congruence and dissonance between micro-teaching and macro- teaching. *Procedia Social and Behavioral Sciences* 2(2), 326-329.
14. McNamara, O., Roberts, L., Basit, T., and Brown, T. (2002). Rites of passage in initial teacher training: Ritual performance, ordeal and numeracy skills test. *British Educational Research Journal*, 28(6), 863-878.

# Sfidat e përkthimit të humorit në përkthimet audio-vizive

## Dr. Anila Hima

Departamenti i Gjuhëve të Huaja  
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë  
anila.hima@univlora.edu.al

## Dr. Bukuroshe Isufaj

Departamenti i Gjuhëve të Huaja  
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë  
bukuroshe.isufaj@univlora.edu.al

### Abstrakt

Humori është një fenomen relativ, idiosinkretik dhe kompleks, i cili ndryshon sipas kulturës dhe kohës. Në dekadat e fundit, në studimet e përkthimit janë bërë kërkime të shumta mbi përkthimin audioviziv të humorit. Sfondi kulturor, shoqëror dhe fetar ndikon në mënyrën se si njerëzit e kuptojnë humorin. Humori ka shumë dimensionë kulturore dhe shoqërore që i bëjnë njerëzit t'i përgjigjen shakasë dhe ta konsiderojnë atë për të qeshur. Prandaj, ajo që të bën për të qeshur në një kulturë jo patjetër të bën për të qeshur edhe në kulturat e tjera, gjë që e bën sfidues përkthimin e humorit. Ky punim paraqet një përmbledhje teorike të kërkimit mbi përkthimin audioviziv në përgjithësi dhe përkthimin e humorit në tekstet audiovizive në veçanti, përshkruan llojet e tij si dhe strategjitë e zbatuara të përkthimit dhe kufizimet e shkaktuara nga veçoritë teknike dhe gjuhësore të teksteve audiovizive me të cilat përballen përkthyesit gjatë përkthimit. Ky punim synon të japë ndihmesën e vetë në kërkimin e humorit në përkthimin audioviziv, duke u përqendruar veçanërisht në elemente specifike për gjuhën dhe kulturën, si loja e fjalëve, lojërat aludive të fjalëve, ndër të tjera, që paraqesin probleme madhore në përkthim.

**Fjalë kyç:** humor, përkthim, audioviziv, dallime kulturore, problematika të përkthimit

### Abstract

Humor is a relative, idiosyncratic and complex phenomenon, which varies according to culture and time. In the last decades, in Translation Studies, it has been produced a fair amount of research on the audiovisual translation of humour. The cultural, religious, and social background affects the way people comprehend jokes. Jokes bear many cultural and societal dimensions that make people respond to the joke and consider it funny. Hence, what sounds funny in a culture does not necessarily sound that funny in the other cultures, which makes the translation of jokes challenging. This paper presents a theoretical overview of the vast research on audiovisual translation and humour translation in particular, and its main characteristics, describes its types as well as translation strategies applied and constraints caused by technical and linguistic peculiarities of audiovisual products which translators face while translating. This paper aims at contributing to the ongoing research in the audiovisual translation of humour, focusing in particular on the language and culture-specific features like punning, wordplay, allusive wordplay, among others, that pose significant problems in translation.

**Keywords:** humour, translation, audiovisual, cultural differences, translation problems

## Hyrje

Fusha e studimeve të përkthimit, e cila përfshin teorinë dhe zbatimin e përkthimit dhe interpretimit, ka pësuar transformim ndër vite, falë formave të reja të ndërlidhjeve sociale dhe kulturore. Kultura luan një rol themelor në këtë fushë, duke qenë e lidhur ngushtë me gjuhën. Si gjuha ashtu edhe kultura janë dy elemente në vazhdimësi evolucioni, të cilat për këtë arsye kërkojnë përditësime të vazhdueshme dhe studime të thelluara. Në pesëdhjetë vitet e fundit, është shfaqur një fushë e re e veçantë e studimeve të përkthimit, një fushë që ka tërhequr interesin e studiuesve të ndryshëm. Me rritjen e teksteve multimediale dhe të komunikimit masiv, tekstet audiovizive kanë parë një rritje të ndjeshme që nga vitet 1990.

Përkthimi audioviziv i referohet transferimit të gjuhës nga një gjuhë e parë<sup>1</sup> në një gjuhë të dytë<sup>2</sup> në produkte të tilla si programe televizive, filma, faqe interneti. Ky lloj përkthimi zë një vend të veçantë në studimet e përkthimit.

## Përkthimi audioviziv

Importi gjithmonë e më i madh i materialeve audiovizive në Evropë, kryesisht nga Shtetet e Bashkuara, ka rritur kërkesën për përkthim dhe përshtatje në gjuhën e dytë. (1) Prandaj edhe procesi i përkthimit është bërë qendra e interesit për një numër të madh studiuesish në studimet e përkthimit. Për shkak të zhvillimit të tij të vazhdueshëm ka shumë përkufizime për përkthimin audioviziv. Luyken et al. (2) sugjerojnë termin 'transferimi i gjuhës' për t'iu referuar llojeve të ndryshme të strategjive të përkthimit të zbatuara në tekstet audiovizive, të cilat mund të përfshijnë titrat, zërin, komente ose dublime. Studiues të tjerë si Heiss (3) dhe Ulych (4) përqendrohen në llojin e tekstit për tu përkthyer. Ata përdorin 'përkthim multimedial' si një term gjithëpërfshirës për të përshkruar përkthimin e të gjitha atyre teksteve të krijuara përmes një kanali multi-semiotik, qofshin ata filma, programe televizive apo drama për teatër. Ndër llojet e shumta të përkthimit audioviziv (siç janë titrimi ndër-gjuhësor, dublimi, përkthimi me zë,<sup>3</sup> interpretimi) mënyrat më të njohura të transferimit të teksteve audiovizive nga gjuha e parë në gjuhën e dytë janë dublimi dhe titrimi. Në përgjithësi, përzgjedhja e një mënyre mbi të tjerat varet nga shumë faktorë, ndër të cilët janë kostoja e prodhimit, tradita e zhvilluar në vend dhe rëndësia e tekstit burimor në kulturën marrëse.

Luyken et al. (2) analizojnë përzgjedhjen e një mënyre të caktuar përkthimi në varësi të disa karakteristikave specifike të audiencës në gjuhën e dytë, sic është mosha, arsimi, kompetenca në gjuhën e huaj. Studimi i tyre zbulon se preferenca për dublimin rritet me moshën pasi aftësitë e të lexuarit dhe të dëgjuarit ulen.

Përkthimi audioviziv mbart edhe një sërë problematikash. Siç e shpjegon La Polla (5), përkthimi audioviziv gjithmonë nënkupton një zhvendosje kulturore, jo vetëm në aspektin gjuhësor, por edhe në aspektin e konotacioneve që mund të përcjellë gjuha e parë me anë të shprehjeve idiomatike, metaforës ose regjistrin individual të një personazhi. Edhe pse përkthyesit mund të gjejnë gjegjësit e duhur në kulturën e gjuhës së dytë, ata nuk do të mundin ta ruajnë në tërësinë e tij konotacionin kulturor origjinal. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se transferimi gjuhësor shpesh mund të vuajë nga ndikimi i gjuhës së parë mbi gjuhën e dytë. Luyken et al. (2) japin shembuj të anglicizmave që gjenden në versionet e dubluara gjermane të programeve të famshme televizive si telenovela amerikane Dinastia. Përveç kësaj, Luyken et al. (17) theksojnë se përkthimi audioviziv ndikohet nga faktori njerëzor. Sipas mendimit të tyre, ndryshore të tilla si njohuritë e përkthyesit për kulturën dhe gjuhën burimore dhe presioni i kohës në të cilin duhet të punojë përkthyesi mund të luajnë një rol të rëndësishëm në lidhje me saktësinë e përkthimit.

## Humori

Fokusi i këtij punimi është humori në përkthimet audiovizive. Vështirësia që lind me çdo përpjekje për ta përkufizuar humorin me terma të përgjithshëm vjen me faktin se humori në vetvete është një koncept relativ, idiosinkretik që ndryshon sipas kulturës dhe kohës. Në fakt, individët e çdo grupi shoqëror apo kulturor e përdorin gjerësisht humorin në jetën dhe bisedat e tyre të përditshme. Prandaj edhe studimet e humorit është një fushë ndërdisiplinore me kërkime të shumta nga antropologjia, psikologjia, filozofia dhe gjuhësia (6). Studiuesit e humorit janë përpjekur të shpjegojnë thelbin, mekanizmat dhe ndikimet e tij në shoqëri me anë të qasjeve të ndryshme dhe nga këndvështrime të ndryshme.

## Humori në bashkëbisedim

Rëndësia e kontekstit në të kuptuarit e humorit është thelbësore. Studiues të ndryshëm janë

<sup>1</sup> ang. *source language (SL)*, gjuha e burimit

<sup>2</sup> ang. *target language (TL)*, gjuha e synuar

<sup>3</sup> ang. *voice-over*

përqendruar në analizën e humorit në lidhje me kontekstin. Sipas Attardo-s, në studimet mbi humorin, ekziston një dallim mes shakave të menduara e të përlogaritura dhe atyre bisedore apo të çastit (7). Shakatë e menduara përkufizohen si shaka që janë përdorur më parë nga folës të tjerë në situata të ndryshme dhe gjenden, për shembull, në libra për humorin. Ndërsa shakatë e çastit mund të ndodhin spontanisht në bisedë në një situatë të caktuar.

### Funksionet e humorit në bisedë

Në lidhje me funksionet e humorit të çastit që ndodh spontanisht në bisedë, Norrick thekson se (8):

"Humori na lejon të manipulojmë bisedat dhe pjesëmarrësit në mënyra të ndryshme, duke prezantuar veten, duke kërkuar informacion rreth qëndrimeve të bashkëbiseduesve tanë, duke e pozicionuar veten në lidhje me ta dhe, sigurisht, duke qetësuar situata të tensionuara si edhe duke nxitur një komunikim miqësor".

Të gjitha këto funksione janë analizuar në studimet mbi humorin. Për shembull, Tannen analizon humorin dhe ironinë në një darkë të Ditës së Falënderimeve dhe vëren se ata që përdorin humorin në bisedë lënë te të tjerët një përshtypje më mbresëlënëse për veten. (9) Për më tepër, Tannen thekson faktin se njerëzit shfaqin mënyra të veçanta të të bërit humor, të cilin ajo e përkufizon si "markën" apo stilin e tyre personal të humorit. Për shembull, disa njerëz mund të kapen me shqiptimin e të tjerëve dhe të bëjnë humor me të, por pa shkaktuar ofendim. Edhe Antonopoulou dhe Sifianou studiojnë rastet e humorit që nuk kanë si synim ofendimin. (10) Ata analizojnë biseda telefonike humoristike ndërmjet bashkëmoshatarësh dhe tregojnë se si bashkëbiseduesit përdorin lojëra fjalësh fyese. Megjithatë, ata tregojnë edhe se në këtë lloj ndërveprimi shoqëror përdorimi i humorit agresiv nuk perceptohet si i dëmshëm sepse nuk është paramenduar si i tillë. Ndodh që personi të cilit i drejtohet një lojë fjalësh agresive mund të përgjigjet me një tjetër shaka agresive. Megjithatë, konteksti miqësor brenda të cilit zhvillohen këto shkëmbime nuk e prishin rrjedhën normale të bisedës, duke vërtetuar kështu fleksibilitetin e krijimit dhe të perceptimit të humorit. Norrick (6) pretendon se humor i çastit mes miqsh zakonisht synon të zbavisë dhe të krijojë një lidhje brenda grupit, më tepër sesa të shprehë epërsinë e folësit.

<sup>4</sup> ang. *wordplay*

<sup>5</sup> Një shaka që shfrytëzon shumëkuptimësinë e një fjale apo shqiptimin e njëjtë por me kuptime të ndryshme të dy fjalëve

Siç shihet, analiza e humorit në bisedat e natyrshme mund të zbulojë të dhëna të rëndësishme për njerëzit e përfshirë në to. Për shembull, mund të tregojë zgjuarsinë (apo mungesën e saj) e shakabërësit dhe (pa)aftësinë e bashkëbiseduesve për ta kuptuar humorin. Më e rëndësishmja, ajo mund të nxjerrë në pah se si normat e vendosura në një mjedis të caktuar socio-kulturor mund të përcaktojnë (pa)përshtatshmërinë e humorit (7).

Duke cituar Zabalbeascoa, logjika dhe praktika na tregojnë se përkthimi ka të bëjë me të qenurit besnik ndaj fjalëve, kuptimit, përmbajtjes, qëllimit, efektit të një teksti. Pra, rregulli i përgjithshëm kur bëhet fjalë për përkthimin e humorit, mund të përmbledhet si "përktheni fjalët dhe/ose përmbajtjen dhe më pas kryqëzoni gishtat dhe shpresoni që humor i të dalë disi me pjesën tjetër". (11)

### Loja e fjalëve<sup>4</sup>

Delabastita e përkufizon në përgjithësi lojën e fjalëve si më poshtë:

"Loja e fjalëve është termi i përgjithshëm i përdorur për dukuritë e ndryshme të tekstit në të cilat veçoritë strukturore të gjuhëve të përdorura shfrytëzohen për të sjellë një përballje të rëndësishme komunikuese të dy (ose më shumë) strukturave gjuhësore me forma pak a shumë të ngjashme dhe me kuptime pak a shumë të ndryshme". (12) Siç shihet, në këtë përkufizim loja e fjalëve konsiderohet si një term i përgjithshëm për të përfshirë të gjitha ato dukuri që përfshijnë shfrytëzimin e strukturave gjuhësore që ndryshojnë në kuptim, por kanë disa ngjashmëri formale (fonologjike, grafologjike).

Loja e fjalëve përfshin nënkategori të tilla si: *puns*<sup>5</sup>, lojëra fjalësh të bazuara në shprehje dhe idioma të ngulitura, përdorimi me humor i elementeve vizuale dhe verbale dhe lojëra fjalësh të bazuara në rimë.

Në literaturë, loja e fjalëve dallon nga format e ndryshme të paqëllimshme të dykuptimësisë gjuhësore (si p.sh. rrëshqitjet e gjuhës (kur thuhet diçka gabimisht) malapropizmat<sup>6</sup>) sepse konsiderohet të jetë shfrytëzim i vetëdijshëm i gjuhës. (12)

Le të shohim disa shembuj më poshtë, ku luhet me dykuptimësinë e një fjale apo me dy fjalë të ndryshme në kuptim por me tingëllim a drejtshkrim të njëjtë. Për shembull, vini re

<sup>6</sup> Keqpërdorimi i një fjale që ka të njëjtin tingëllim me një fjalë tjetër

dykuptimësinë e fjalës *interes*, që në këtë rast përkon edhe me gjuhën shqipe:

- *I used to be a banker, but I lost interest.*
- *Kam qenë bankier, por e humba interesin.*

Loja e fjalëve me fjalë që shkruhen në të njëjtën mënyrë, por kanë kuptim të ndryshëm quhet lojë fjalësh homografike. Për shkak se këto lojëra fjalësh mbështeten në drejtshkrim, ato janë vizuale dhe duhen lexuar për t'u kuptuar. Këtu është një shembull i një loje fjalësh homografike me dykuptimësinë e fjalës "*flies*", që përdoret si folje *fluturoj* dhe si emër *mizat*, si edhe të fjalës "*like*", e cila përdoret si përemër *si* dhe si folje *pëlqej*, gjë e cila nuk arrin të transmetohet në gjuhën e dytë:

- *Time flies like an arrow; fruit flies like a banana.*
- *Koha fluturon si shigjetë; mizat e frutave i pëlqejnë bananet.*

Në romanin e tij më të njohur "Liza në botën e çudirave", Lewis Carroll përdor në një pasazh një lojë fjalësh me "*përralla*" dhe "*bishta*"<sup>7</sup>. Këtu janë disa rreshta të shkëputura nga ky pasazh:

*"Përralla ime është e gjatë dhe e trishtë!" - tha Miu, duke u kthyer nga Liza e duke psherëtirë. "Me siguri është një bisht i gjatë," - tha Liza, duke parë me habi bishtin e Miut, - 'por përse e quan të trishtë?' Dhe ajo vazhdonte të vriste mendjen për këtë teksta Miu fliste.*

Loja e fjalëve në këtë rast humbet plotësisht, pasi nuk mund të përcillet në gjuhën e dytë për mospërshtatje të strukturës gjuhësore.

Një tjetër shembull të vështirësisë së përcjelljes së lojës së fjalëve për shkak edhe të informacionit që është specifik për kulturën e gjuhës së parë e sjellim më poshtë:

- *May the Fourth be with you!*
- *4 maji qoftë me ju!*

Ky përkthim kërkon nga ana e dëgjuesit njohje të filmave Star Wars dhe të shprehjes "May the force be with you" "Forca qoftë me ju" si dhe të faktit që 4 maj është dita e Star Wars.

## Puns

Ky lloj humorit ka zgjuar një interes të madh, veçanërisht te studiuesit e gjuhësisë dhe të psikolinguistikës. (7) Edhe studiuesit e studimeve të përkthimit kanë analizuar mekanizmat që përdor ky fenomen, kryesisht duke u përqendruar në vështirësitë që lidhen me transferimin e tij në gjuhë të tjera. Ky lloj humorit (*puns*) bazohet në përgjithësi në një mekanizëm që shfrytëzon paqartësinë e fjalëve apo të strukturave gjuhësore, të cilat mundësojnë dykuptimësinë në të njëjtën shprehje.

Hempelmann thekson se loja e fjalëve nuk përmban humor në vetvete. (13) Sipas tij, loja e fjalëve është thjesht një lojë me ngjashmërinë tingullore të fjalëve, e cila bëhet humoristike vetëm nëse përfshin në lojë edhe kuptimin. Edhe Delabastita (12) arrin në të njëjtin konkluzion, që loja e fjalëve nuk rezulton patjetër në humor. Megjithatë, ai vëren gjithashtu se *puns* mund të evokojnë njëkohësisht dy ose më shumë kuptime të kundërta që mund të kenë një ose më shumë fjalë, kështu duke bërë të domosdoshëm një "lexim të dytë".

## Kategorizimi i *puns*-ave

Delabastita ofron një taksonomi që dallon katër lloje të ndryshme të lojës së fjalëve, në varësi të karakteristikave të tyre: (12)

1. homonimia, kur fjalët kanë "tinguj dhe drejtshkrim të njëjtë";
2. homofonia, kur fjalët kanë "tinguj të njëjtë, por drejtshkrime të ndryshme";
3. homografia, kur fjalët kanë "tinguj të ndryshëm, por drejtshkrim të njëjtë";
4. paronimia, kur "ka dallime të vogla si në tingull ashtu edhe në drejtshkrim".

## Përkthimi i *puns*-ave

Studiues të ndryshëm të studimeve të përkthimit kanë diskutuar mbi karakteristikat specifike të *puns*-ave si edhe vështirësitë që lindin me përkthimin e një fenomeni gjuhësor dhe njohës kaq kompleks.

Më poshtë le t'i referohemi tipologjisë së tetë strategjive të përkthimit të Delabastitës (12), tipologji e cila është në dispozicion të përkthyesve për t'i ndihmuar ata të merren me lojën e fjalëve. Siç e thekson edhe vetë Delabastita, mund të përdoren dy ose më shumë strategji të kombinuara me njëra tjetrën.

### 1. Pun → pun

Loja e fjalëve (*pun-i*) përkthehet në gjuhën e dytë përsëri me një lojë fjalësh, por me rregullime të vogla në aspektin semantik apo të strukturës së formës.

### 2. Pun → jo-pun

Loja e fjalëve përkthehet me një shprehje që nuk përmban lojë fjalësh, e cila synon të ruajë një ose të dyja kuptimet origjinale.

### 3. Pun → mjet retorik

Loja e fjalëve zëvendësohet me një mjet retorik (p.sh. aludim, parodi, rimë, paradoks) për të ruajtur një pjesë të efektit origjinal.

### 4. Pun → zero pun

Loja e fjalëve hiqet fare në përkthim.

### 5. Pun = pun

<sup>7</sup> *Përralla* në anglisht *tales*, *bishta* në anglisht *tails*

Loja e fjalëve përdoret e papërkthyer në tekstin e gjuhës së dytë.

#### 6. Jo-pun → pun

Një lojë fjalësh krejtësisht e re shtohet në tekstin e gjuhës së dytë kur në tekstin burimor nuk ka asnjë, për të kompensuar për ndonjë humbje lojë fjalësh të mëparshme ose për arsye të tjera.

#### 7. Zero → pun

Në tekstin e gjuhës së dytë shtohet material teksti plotësisht i ri dhe që përmban lojë fjalësh.

#### 8. Teknika editoriale

Shtohen mjete editoriale si p.sh. shënimet në fund të faqes *footnote*, shënimet në fund të tekstit *endnote* në tekstin e gjuhës së dytë për të shpjeguar lojën e fjalëve në tekstin origjinal.

### Aludimet specifike për një kulturë të caktuar

Dallimet mes kulturave sjellin për përkthyesin problematika shumë më të mëdha sesa dallimet mes strukturave gjuhësore. (14) Një tjetër mekanizëm për të krijuar humor janë aludimet që janë specifike për një kulturë të caktuar. Ashtu si dukuritë e tjera gjuhësore specifike për kulturën, edhe aludimet nuk përmbajnë humor në vetvete. Megjithatë, ato shfrytëzohen për të përcjellë humor. Ndryshe nga aludimet 'ndërkulturore' (burimi dhe kuptimi i të cilave mund të jetë i njohur si nga kultura burimore ashtu edhe nga kultura e synuar), aludimet që janë specifike për kulturën e sfidojnë përkthyesin sepse referenca e tyre mund të kuptohet vetëm nga ata njerëz të cilët kanë njohuri të mjaftueshme të kulturës burimore në fjalë. (15) Për këtë arsye, paraqesin probleme gjatë transferimit në një gjuhë dhe kulturë tjetër. Përkthyesi është ndërmjetësi mes gjuhës dhe kulturës burimore dhe asaj të synuar dhe supozohet të zotërojë njohuri të mjaftueshme për kulturën burimore për të qenë në gjendje të njohë aludimet specifike për kulturën në tekstin burimor dhe, në të njëjtën kohë, të jetë i ndjeshëm ndaj problemeve specifike që ato paraqesin.

Leppihalme e përdor "aludimin" si një term ombrellë që përfshin "një shumëllojshmëri përdorimesh të materialit gjuhësor në formën e tij origjinale ose të modifikuar dhe të emrave të përveçëm, për të përcjellë shpesh kuptim të

nënkuptuar". (15) Sipas Leppihalme, aludimet mund të kategorizohen në katër grupe. (15)

#### 1. Aludimet e mirëfillta

Këtu hyjnë:

(a) aludimet që përmbajnë një emër të përveçëm, si për shembull:

- I think I've become a *Raffles* in my old age.<sup>8</sup>

- Mendoj se jam bërë një *Raffles* në pleqërinë time.

(b) aludimet që përmbajnë një shprehje kyç, si për shembull:

- Apparently taxis all turn into pumpkins at midnight.<sup>9</sup>

- Me sa duket të gjitha taksitë kthehen në kunguj në mesnatë.

#### 2. Aludimet stereotipike

Aludimet e përdorura shpesh që e kanë humbur freskinë dhe burimi i të cilave vështirë se mund të gjendet, si për shembull klishe, fjalët e urta:

- We were ships that pass in the night<sup>10</sup>.

- Ishim anije që ndesheshim nëpër natë.

#### 3. Krahase gjysmë-aludive

Janë krahasime sipërfaqësore, si për shembull:

- Like the land of Oz, technology has good and bad witches.<sup>11</sup>

- Ashtu si toka e Ozit, teknologjia ka magjistarët e mirë dhe ata të këqinj.

#### 4. Mbiemrat eponimë

Janë mbiemra që vijnë nga emra të përveçëm, si për shembull:

- Orwellian images<sup>12</sup>

- Imazhe orvelliane

### Strategjitë e përkthimit për emrat e përveçëm aludiv

Strategjitë e përkthimit të sugjeruara nga Leppihalme për emrat e përveçëm përfshijnë: (15)

(1) Ruajtjen e emrit të përveçëm (qoftë i pandryshuar, qoftë në formën konvencionale në gjuhën e synuar) me tre nënkategoritë:

(1a) ruhet emri;

(1b) përdoret emri duke shtuar apo bërë ndryshime të vogla që synojnë të japin njohuri për nënkuptimin e aludimit;

(1c) përdoret emri duke shtuar një shpjegim të detajuar, për shembull një shënim në fund të faqes.

<sup>8</sup> *Raffles* i referohet *Raffles Hotels*, hotele luksoze në Singapor

<sup>9</sup> I referohet përrallës së Hirushes ku në mesnatë gjithcka kthehet në gjendjen e saj normale, duke përfshirë edhe karrocën që kthehet në kungull, duke nënkuptuar mungesën e taksive në mesnatë.

<sup>10</sup> I referohet një poeme të H. W. Longfellow, e që nënkupton që dy njerëz shihen rrallë edhe pse jetojnë pranë njëri-tjetrit.

<sup>11</sup> I referohet një vendi magjik nga romani për fëmijë *The wonderful Wizard of Oz* i autorit L. F. Baum.

<sup>12</sup> I referohet autorit George Orwell dhe veprës së tij *Nineteen Eighty-Four*.

(2) Zëvendësimin e emrit të përveçëm me një tjetër me dy nënkategoritë:

(2a) zëvendësohet emri me një emër tjetër nga gjuha burimore;

(2b) zëvendësohet emri me një emër tjetër nga gjuha e synuar.

(3) Eliminimin e emrit të përveçëm, me dy nënkategoritë:

(3a) eliminohet emri, por transferohet kuptimi me mjete të tjera, për shembull me një emër të përgjithshëm;

(3b) eliminohet plotësisht emri dhe aludimi.

### Përfundimet

Në këtë punim u paraqit një përmbledhje teorike e kërkimit mbi përkthimin audioviziv në përgjithësi dhe përkthimin e humorit në veçanti. U përshkruan llojet e tij si dhe strategjitë e zbatuara të përkthimit dhe kufizimet e shkaktuara nga veçoritë teknike dhe gjuhësore të teksteve audiovizive me të cilat përballen përkthyesit gjatë përkthimit. U përqendruam veçanërisht te elementet specifike për gjuhën dhe kulturën, si loja e fjalëve, llojet dhe kategorizimi i tyre, tetë strategjitë e përkthimit të lojës së fjalëve, llojet e aludimeve me aludimet e mirëfillta, aludimet stereotipike, krahasimet gjysmë-aludive dhe mbiemrat eponimë. Të gjitha këto paraqesin probleme madhore në përkthim, pasi gjatë procesit të përkthimit ndodh zhvendosje jo vetëm në aspektin gjuhësor nga një gjuhë në një tjetër, por edhe në aspektin kulturor e konotacioneve që mund të përcjellë gjuha e parë. Dallimet mes kulturave sjellin problematika shumë më të mëdha për përkthyesin sesa dallimet mes strukturave gjuhësore, sepse kërkojnë jo vetëm nga përkthyesi të zotërojë njohuri të mjaftueshme për kulturën burimore për të qenë në gjendje të njohë aludimet specifike për kulturën në tekstin burimor dhe, në të njëjtën kohë, të jetë i ndjeshëm ndaj problemeve specifike që ato paraqesin, por kërkon edhe nga dëgjuesi/lexuesi të ketë njohuri të mjaftueshme të kulturës e gjuhës që po përkthehet.

### Literatura

1. Paolinelli, M. (2004) 'Nodes and Boundaries of Global Communications: Notes on the Translation and Dubbing of Audiovisuals', *Meta*, 49(1): 172-181.

2. Luyken, G. M., Herbst, T., Langham-Brown, J., Reid, H. and Spinhof, H. (1991) *Overcoming language barriers in television*, Manchester: The European Institute for the Media.

3. Heiss, C. (1996) 'Il testo in un contesto multimediale', in Heiss, C. and Bollettieri Bosinelli, R. M. (eds.) *Traduzione multimediale per il cinema la televisione e la scena*, Bologna: CLUEB, 13-25.

4. Ulrych, M. (2000) 'Locating universal features of translation behaviour through multimedia translation studies', in Bollettieri Bosinelli, R. M., Heiss, C., Soffritti, M. and Bernardini, S. (eds.) *La traduzione multimediale: Quale traduzione per quale testo?*, Bologna: CLUEB, 407-427.

5. La Polla, F. (1994) 'Quel che si fa dopo mangiato: doppiaggio e contesto culturale', in Baccoli, R., Bollettieri Bosinelli, R. M. and Davoli, L. (eds.) *Il doppiaggio. Trasposizioni linguistiche e culturali*, Bologna: CLUEB, 51-60.

6. Palmer, J. (1994) *Taking Humour Seriously*, London and New York: Routledge.

7. Attardo, S. (1994) *Linguistic Theories of Humour*, Berlin: Mouton de Gruyter.

8. Norrick, N. R. (1993), *Conversational Joking: Humor in Everyday Talk*. Bloomington: Indiana University Press.

9. Tannen, D. (1984) *Conversational Style: Analyzing Talk Among Friends*, Norwood, NJ: Ablex.

10. Antonopoulou, E. and Sifianou, M. (2003) 'Conversational dynamics of humour: the telephone game in Greek', *Journal of Pragmatics* 35: 741-769.

11. Zabalbeascoa, P. (2005) Humor and translation: an interdisciplinary. *International Journal of Humor Research*, 18(2): 185-208.

12. Delabastita, D. (1996) 'Introduction', *The Translator* 2(2): 127-139.

13. Hempelmann, C. F. (2004) 'Script opposition and logical mechanism in punning', *Humor: International Journal of Humor Research* 17 (4): 381-392.

14. Nida, E. (1964) *Towards a Science of Translating: With Special Reference to Principles and Procedure Involved*, Leiden: J. Brill.

15. Leppihalme, R. (1997) *Culture Bumps. An Empirical Approach to the Translation of Allusions*, Clevedon: Multilingual Matters